



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Bashkinë Mirditë**

**RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT**  
**MBI**  
**AUDITIMIN FINANCIAR**  
**TË USHTRUAR NË BASHKINË MIRDITË**

**Tiranë, maj 2022**



## KONTROLI I LARTË I SHTETIT

### Raport auditimi mbi auditimin e ushtruar në Bashkinë Mirditë me objekt “Auditim financiar”

#### PËRMBAJTJA

<b>I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....</b>	<b>4</b>
1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit.....	4
2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve.....	4
3. Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit .....	8
<b>II. HYRJA .....</b>	<b>10</b>
1. Objektivat dhe qëllimi i auditimit.....	11
2. Identifikimi i çështjes.....	11
3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.....	12
4. Përgjegjësitë e audituesve .....	12
5. Kriteret e vlerësimit .....	14
6. Standardet e auditimit .....	15
7. Metodologjia e auditimit .....	16
8. Dokumentimi i auditimit.....	17
<b>III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT .....</b>	<b>17</b>
1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim.....	17
2. Përshkrimi rezultateve sipas drejtimeve të auditimit.....	19
2.1 Menaxhimi financiar dhe kontrolli brendshëm .....	19
2.2 Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit, bazuar në ligjin organik të buxhetit të shtetit, nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, ligjet vjetore “Për buxhetin e shtetit” të vitit 2020, si dhe aktet nënligjore mbi planifikimin, monitorimin dhe zbatimin e buxhetit .....	33
2.3 Vlerësimi Raportimit Financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitin 2020, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi dhe konkretisht, ligjin nr. 24/2018, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” si dhe udhëzimi MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njëjësive të Qeverisjes së Përgjithshme”.....	68
2.4 Të ndryshme të dala gjatë auditimit.....	89



## KONTROLLI I LARTË I SHETIT

### Raport auditimi mbi auditimin e ushtruar në Bashkinë Mirditë me objekt “Auditim financiar”

#### Lista e shkurtimeve

KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
NA	Nëpunës Autorizues
NZ	Nëpunës Zbatues
GMS	Grupi i Menaxhimit Strategjik
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
AB	Auditi i Brendshëm
MAB	Manuali i Auditimit të Brendshëm
FZHR	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak
ALUIZNI	Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave të Ndërtimeve Informale
ASHK	Agjencia Shtetërore e Kadastrës
NJA	Njësi Administrative
SHA	Shoqëri Anonime
BOE	Bashkim i Operatorëve Ekonomikë
OE	Operator Ekonomik
KVO	Komisioni i Vlerësimit të Ofertave
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
IFAC	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
IPSAS	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik
DFB	Drejtoria e Financës dhe Buxhetit
DTTV	Drejtoria e Tarifave dhe Taksave Vendore



## KONTROLLI I LARTË I SHTESTIT

### Raport auditimi mbi auditimin e ushtruar në Bashkinë Mirditë me objekt “Auditim financiar”

#### I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

##### 1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, dhe në zbatim të Programit të Auditimit nr. 52/1 prot., datë 18.01.2022, miratuar nga Kryetari i KLSH-së, nga data 19.01.2022 deri në datë 25.02.2022, në subjektin Bashkia Mirditë u krye auditimi Financiar për periudhën 01.01.2019 deri 31.12.2021.

Auditimi mbuloi çështjet kryesore të veprimtarisë së Bashkisë Mirditë si: planifikimi dhe zbatimi i buxhetit, vlerësimi i pasqyrave financiare, shpërndarja e fondeve të rindërtimit, të ardhurat, si dhe zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

Për analizimin dhe vlerësimin e aktivitetit të subjektit sipas pikave të planifikuara në programin e auditimit, grupi i auditimit vlerësoi sistemet e kontrollit të brendshëm dhe analizoi të gjitha evidencat e grumbulluara gjatë kryerjes së auditimit në terren sipas çështjeve përkatëse.

Në përfundim të punës audituese në terren, grupi i auditimit ka mbajtur dhe protokolluar në Bashkinë Mirditë 9 akt konstatime. Mbi akt konstatimet e mbajtura nga grupi i auditimit, Bashkia Mirditë ka dërguar konfirmimin e marrjes dhe njohjes me përmbajtjen e tyre protokolluar në KLSH me nr.52/2 prot., datë 15.03.2022 ku janë paraqitur observacione përkatëse të cilat janë reflektuar në Projekt Raport. Mbi projekt raportin e auditimit, Bashkia Mirditë ka dërguar konfirmimin e njohjes me përmbajtjen e tij protokolluar në KLSH me nr. 54/4 prot. Datë 29.04.2022 ku janë paraqitur observacione, të cilat janë reflektuar në hartimin dhe përgatitjen e raportit përfundimtar të auditimit sipas çështjeve përkatëse.

##### 2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Faqe	Rekomandimi
1	Nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Mirditë, nuk është aplikuar dhe arkëtuar tarifa e pastrimit, ndriçimit dhe gjelbërimit për subjektet e ndërtimit të cilat kanë kryer punime ndërtimi dhe janë shpallur fitues në procedurat e prokurimit publik, për periudhën e auditimit 2019-2021, në kundërshtim me parashikimet e bëra në paketën fiskale të Bashkisë Mirditë për periudhën e auditimit. Kjo anomali është konstatuar për 11 subjekte, sipas listës në aneksin nr.2.2/6/2 bashkangjitur raportit të auditimit, duke shkaktuar të ardhura të munguara në vlerën totale 1,677,000 lekë. Subjektet nuk janë pajisur me nipte sekondare për punimet e ndërtimit në kundërshtim të ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008 për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë i ndryshuar, neni 43 pika 1/1 dhe Udhëzimit nr. 24, datë 02.09.2008 i ndryshuar, neni 43/1/1.	E lartë	59-61	Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Mirditë, të marri masa të menjëhershme për arkëtimin e vlerës 1,677,000 lekë, nga subjektet të cilat kanë zhvilluar aktivitet dhe kanë lidhur kontratë me Bashkinë Mirditë, për arsye të shpalljes fitues në procedurat e prokurimit publik, sipa aneksit nr.2.2/6/2 bashkangjitur raportit të auditimit
2	Në 11 kontrata të lidhura ndërmjet operatorë të ndryshëm me bashkinë Mirditë, sipas aneksit nr. II/2/6/1 bashkangjitur raportit përfundimtar të auditimit, nuk janë arkëtuar detyrimet e subjekteve sipas afateve të përcaktuara. Drejtoria e Taksave të të	E lartë	61-64	Drejtoria e Taksave të të Ardhurave Vendore dhe Agjencia e Shërbimeve Pyjore Bashkia Mirditë të bashkërendojnë dhe të marri të gjitha masat (administrative dhe gjyqësore),



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport auditimi mbi auditimin e ushtruar në Bashkinë Mirditë me objekt “Auditim financiar”

	<p>Ardhurave Vendore dhe Agjencia e Shërbimeve Pyjore Bashkia Mirditë nuk kanë bashkërenduar për të marrë të gjitha masat (administrative dhe gjyqësore), për të arkëtuar vlerën vjetore të kontratave të qirave në vit, si dhe nuk ka ushtruar të drejtën dhe detyrimet e qiradhënësit për zgjidhjen e njëanshme kur qiramarrësi nuk ka shlyer detyrimet dhe kamatë vonesë prej 0.1% për çdo ditë vonesë, por jo më shumë se 10% e vlerës totale të vlerës së pagesës përkatëse dhe e sanksionuar në kontratë, për periudhën e auditimit 2019-2021, veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 për disa ndryshime të vendimit nr. 391, datë 21.06.2006 të Këshillit të Ministrave ðPër përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave të ndryshuar, gjë që ka sjellë dëm ekonomik në vlerën 14,997,426 lekë.</p>			<p>për arkëtimin e vlerës 14,997,426 lekë e 11 kontratave të qirave të operatorëve sipas aneksit nr. II/2/6/1 bashkangjitur raportit përfundimtar të auditimit, gjë që ka sjellë dëm ekonomik.</p>
3	<p>Nga puna e pa mjaftueshme e Drejtorisë së Planifikimit të të Ardhurave Vendore në Bashkinë Mirditë, janë krijuar debitorë, të cilët në datën 31.12.2021 kanë vlerën progresive 38,852,309 lekë, e ardhur e munguar për buxhetin e njësisë vendore, nga të cilat;</p> <ul style="list-style-type: none"><li>--të trashëguara nga vitet 2010-2019 14,838,512 lekë</li><li>-subjekti ðSh.ð 2020 10,569,197 lekë</li><li>-Subjekte biznesi 2021 8,599,825 lekë</li><li>-1463 familje debitorë për taksën e tokës bujqësore në vlerën 188,474 lekë</li><li>-1374 familje debitorë për tarifatat vendore në vlerën 1,557,400 lekë</li><li>-1463 subjekte familjare për taksën e ndërtesës në vlerën 3,098,901 lekë</li></ul> <p>Vlera e borxhit e vitit 2021 është në vlerën 13,444,600 lekë nga të cilat</p> <ul style="list-style-type: none"><li>-129 subjekte të biznesit të madh dhe të vogël në vlerën 8,599,825 lekë</li><li>-1463 familje debitorë për taksën e tokës bujqësore në vlerën 188,474 lekë</li><li>-1374 familje debitorë për tarifatat vendore në vlerën 1,557,400 lekë</li><li>-1463 subjekte familjare për taksën e ndërtesës në vlerën 3,098,901 lekë</li></ul> <p>Mos arkëtimi i plotë i detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore, përveçse është mos përmbushje e detyrimeve ligjore, sipas detyrës funksionale të punonjësve të kësaj strukture, krijon mungesa financiare në buxhet dhe për pasojë ulë nivelin e investimeve dhe të shpenzimeve të tjera që njësi vendore ka parashikuar në favor të komunitetit.</p>	E lartë	64-67	<p>Drejtoria e Planifikimit të të Ardhurave Vendore të marrë masa për arkëtimin e detyrimeve në mënyrë progresive në vlerën 38,852,309 lekë. Për këtë, bazuar në nenin 70 pika 3 ðE drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimorë, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 ðPër Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, për të gjitha subjektet e private të nxjerrë njoftim vlerësimit tatimore dhe në vazhdim të marren masat për arkëtimin e këtij detyrimi, duke ndjekur rrugët e mëposhtme:</p> <p>a- Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit (ASHK) dhe Zyrën Vendore të e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZRVP), kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në (për pasuritë e paluajtshme), bazuar në nenin 91, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 ðPër Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë.</p> <p>b- Për subjektet të cilët nuk kanë paguar detyrimet tatimore në afat, ndaj tyre të aplikohet Neni 93 të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 ðPër Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë. Sekuestrimi dhe konfiskimi i pasurisë</p> <p>1. Nëse tatimpaguesi nuk paguan detyrimin tatimor në datën e caktuar, në përputhje me nenin 89 të këtij ligji, për njoftimin dhe kërkesën për pagesë, administrata tatimore mund ta mbledhë</p>



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport auditimi mbi auditimin e ushtruar në Bashkinë Mirditë me objekt “Auditim financiar”

	<p>Mungesa e të ardhurave është ndikim i drejtpërdrejtë në mosrealizimin e buxhetit në zërin e shpenzimeve për periudhën 2019-2021.</p> <p>Nga Bashkia Mirditë nuk janë ndjekur të gjithë procedurat e nevojshme ligjore në rend shteruese, për arkëtimin e debitorëve, veprim në kundërshtim me nenin 4, 26, 32, 34, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 për sistemin e taksave vendore, nenet 89, 90, 91, 93 të ligjit nr. 9920 për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë dhe i ndryshuar, dhe nenin 12 të Udhëzimit të Ministrisë Financave nr. 24, datë 02.09.2008, Kreu i XI-Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore.</p> <p>- Drejtorja e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, nuk janë marrë plotësisht masa me arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për objektet ndërtimore që legalizohen nga ALUIZNI-Drejtorja Rajonale Lezhë për vlerën debitorë 1,071,877 lekë në kundërshtim të Ligjit nr. 9482 datë 03.04.2016, për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa lejeë i ndryshuar, neni 23, dhe Vendimin e Këshillit të Bashkisë VKB-në paketës fiskale me vendim nr. 135 datë 30.11.2018, vendimi nr. 40 datë 26.11.2019 dhe vendimi nr. 110 datë 20.11.2020 për Miratimin e Paketës Fiskale Vendoreë.</p>			<p>detyrimin tatimor të papaguar nëpërmjet sekuestrimit, e më pas konfiskimit, të pasurisë së siguar në favor të administratës tatimore, në pronësi të tatimpaguesit.</p> <p>c- Në rast se bizneset private edhe pas njoftimeve zyrtare dhe dërgimit të urdhër bllokimeve në bankë nuk kryejnë pagesën e detyrimeve, pasi të merren masat administrative apo sekuestro, të bëhet kallëzim penal, bazuar në Kodin Penal i Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 me ndryshimet e mëvonshme, neni 181 të Mospagimi i taksave dhe tatimeveë.</p> <p>d- Për debitorët familjar, në zbatim të udhëzimit plotësues të Ministrisë së Financave nr. 01, datë 17.01.2019 për zbatimin e buxhetit të vitit 2019ë, pika 98, të njoftojë nëpërmjet postës familjarët të cilët nuk kanë paguar detyrimet për taksën e tokës, të ndërtesave dhe tarifave familjare dhe të realizojë arkëtimin e detyrimit të miratuar nga Këshilli Bashkiak.</p> <p>-Drejtorja e Planifikimit, Zhvillimit dhe Kontrollit të Territorit në bashkëpunim me Drejtorinë e të Ardhurave Vendore dhe Policinë Bashkiake të marrë plotësisht masa me arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për objektet ndërtimore që legalizohen nga ALUIZNI-Drejtorja Rajonale Lezhë për vlerën debitorë 1,071,877 lekë në mbështetje të Ligjit nr. 9482 datë 03.04.2016, për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa lejeë i ndryshuar, neni 23, dhe Vendimin e Këshillit të Bashkisë me vendim nr. 135 datë 30.11.2018, vendimi nr. 40 datë 26.11.2019 dhe vendimi nr. 110 datë 20.11.2020 për Miratimin e Paketës Fiskale Vendoreë.</p>
4	<p>Nga auditimi i kryer për arkëtimin e vlerës së taksës për lëshimin e Autorizimeve / Licencave për subjektet e tregimit me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë, u konstatua se 13 subjekte që ushtrojnë këtë aktivitet në Bashkinë Mirditë, janë</p>	E lartë	56-58	<p>Drejtorja e Taksave dhe Tarifave Vendore e Bashkisë Mirditë, të marrë masa për arkëtimin e vlerës debitorë prej 10,000,000 lekë krijuar nga 13 subjektet (sipas listës në aneksin nr.2.2/6/2, bashkangjitur raportit të auditimit) për mospagimin e taksës për</p>



## KONTROLLI I LARTË I SHETIT

### Raport auditimi mbi auditimin e ushtruar në Bashkinë Mirditë me objekt “Auditim financiar”

	<p>debitor për taksën e licencës në vlerën totale 10,000,000 lekë, e cila konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e njësisë vendore. Lista e subjekteve debitor dhe vlera përkatëse për secilin paraqitet në aneksin nr.2.2/6/2, bashkangjitur raportit të auditimit.</p> <p>Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kërkesat e paketës fiskale të miratuar nga këshilli bashkiak, me VKM nr. 970, datë 2.12.2015 për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënie licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të sajë i ndryshuar me VKM nr. 344, datë 19.04.2017, kapitulli II, pika 1; germa öbö dhe pika 9 të Bashkisë Mirditë, për periudhën 2019-2021.</p>			licencën e tregtimit të naftës bruto dhe nënprodukteve të sajë.
5	<p>Sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Bashkisë Mirditë, në fund të vitit 2020 llogaria 466 öKreditorë për mjete nën ruajtjeö paraqitet në vlerën 23,568,322 lekë dhe përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masën 5%. Nga analiza e kësaj llogarie rezultoi se vlera në fund të vitit 2020, ka pasur në përbërje të llogarisë detyrime për garanci punimesh të bashkisë ndaj subjekteve privatë, garanci këto të cilave u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratat përkatëse të investimit dhe përsëri janë akoma gjendje në llogarinë 466 si shkak i ish komunave dhe mungesës së informacionit. Në këtë rast garanci të cilave u ka kaluar afati sipas kontratës së lidhur, janë në vlerën 1,169,275 lekë. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshmeö seksioni öFunksionimi kontabël i llogarive të tjera të klasës 4., Llogaria 466 ö Kreditorë për mjete në ruajtjeö.</p>	E lartë	84-85	Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të kryejë njoftimin e subjekteve sipas kontratave përkatëse të investimeve për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për kryerjen e veprimeve të likuidimit të garancisë së punimeve në masën 5% me një vlerë totale 1,169,275 lekë dhe të kryejë sistemimet përkatëse në llogarinë 466 öKreditorë për mjete nën ruajtjeö.
6	<p>Llogaria 215 öMjete transportiö në datën 31.12.2019 ka vlerën 15,748,042 lekë, ndërsa më 31.12.2020 vlera e kësaj llogarie është 8,528,894 lekë. Ndryshime prej 7,219,148 lekë vjen si rezultat i paksimit të kësaj llogarie prej amortizimit të mjeteve, por vlera e amortizimit llogaritur nga struktura e financës nuk është e saktë. Referuar normës së amortizimit kjo vlerë duhet të jetë 1,613,817 lekë dhe si rezultat vlera e Llogarisë 215 öMjete transportiö më 31.12.2020 në pasqyrat financiare duhet të jetë 14,134,225 lekë. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me UMF nr. 8 datë 9.03.2018 për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshmeö, pika 36, ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 për menaxhimin financiar dhe kontrollinö neni 6, udhëzimi nr. 30 datë 27.12.2011 për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit</p>	E lartë	80-81	Nëpunësi zbatues, të marrë masa për sistemimin e llogarisë 215 öMjete transportiö, për vlerën 6,915,077 lekë duke korrigjuar normën e amortizimit të llogaritur gabim në pasqyrat financiarë të vitit 2020.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport auditimi mbi auditimin e ushtruar në Bashkinë Mirditë me objekt “Auditim financiar”

	publiko pikat nga 26-30, 74, 96-101, 102 dhe 103.			
7	Kapitalit me 100% aksione në pjesëmarrje të Bashkisë Mirditë në ÷Ujësjetllës Kanalizime Mirditë Sh.a përbën investim me vlerë kontabël (kosto) 70,867,000.00 lekë dhe investori është Bashkia Mirditë, për të cilën nuk janë reflektuar në gjendjen e llogarisë 26 fitim humbjet nga pjesa e aksioneve për vitet 2016-2020. Kjo procedurë mospasqyrimi në Aktivitet Afatgjatë Financiare të Bilancit Kontabël të vlerës së aksioneve të cilat janë investime në pjesëmarrje me vlerë kontabël 70,867,000.00 lekë përbën shtrembërim të informacionit financiar. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me UMF nr. 8 datë 9.03.2018 ÷Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme ÷pika 2.1.	E lartë	77-78	Nëpunësi Zbatues, Drejtorja e Financës dhe Buxhetit të marrë masa për të bërë sistemimet në kontabilitet dhe regjistrimin e pjesëmarrjes 100% në kapitalin aksionar të ÷Ujësjetllës Kanalizime Mirditë Sh.a me vlerë kontabël 70,867,000.00 lekë në debi të llogarisë 26 ÷Pjesëmarrje në kapitalin e vetë dhe kredi të llogarive financiare të klasës 5, për pjesëmarrjen me kapitalin e vet.
8	Llogaria 520 ÷Disponibiliteti në thesarë nuk paraqet gjendjen e saktë në bilanc. Kjo llogari duhet të sistemohet në vlerën 25,996,510 lekë për shtesën 997,500 lekë. Llogaritë e klasës 5, nuk kanë funksionuar duke u debituar për shtesat në kredi të llogarive përkatëse për të ardhurat dhe grante të ndryshme, si dhe duke u kredituar për pakësimet në debi të llogarive përkatëse të klasës 4. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimi nr.8, datë 09.03.2018 ÷Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të PF vjetore në NJQP ÷ pika 46/a , 49, 50.	E lartë	71	Nëpunësi Zbatues, Drejtorja e Financës dhe Buxhetit të marrë masa për sistemimin e llogarisë 520 ÷Disponibiliteti në thesarë për shtesën 997,500 lekë.

### 3. Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit

#### Konkluzion i përgjithshëm<sup>1</sup>:

Në përfundim të auditimit financiar të ushtruar në Bashkinë Mirditë, për periudhën e veprimtarisë nga 01.01.2019 deri në 31.12.2021, në zbatim të Programit të Auditimit nr. 52/1, datë 18.01.2022, nga Kryetari i KLSH-së, Grupi i auditimit ka arritur në konkluzionin se subjekti i audituar në përgjithësi ka vepruar në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore, të cilat kanë shërbyer si kritere vlerësimi, por ka konstatuar edhe disa anomali të rëndësishme por jo të përhapura të cilat janë trajtuar gjerësisht në këtë raport përfunditar auditimi

- Nga auditimi dhe vlerësimi mbi funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm konkludojmë se përgjithësisht ka funksionuar sistemi i kontrollit të brendshëm, ka përmirësime në krahasim me periudhën e mëparshme të audituar nga KLSH, në lidhje me mjedisin e kontrollit ku ushtron veprimtarinë subjekti, si dhe ka kryer aktivitete kontrolli, për minimizimin e risqeve veçanërisht në menaxhimin e aktiveve. Ka nevojë për të evidentuar, monitoruar risqet e auditimit si dhe për të rritur nivelin e transparencës;

<sup>1</sup> Manuali i Auditimit të Përrputshmërisë, Kapitulli VII, pika 7.3.1 Angazhimet e Raportimit të Drejtpërdrejtë/ [me siguri të arsyeshme]





## KONTROLLI I LARTË I SHETIT

### Raport auditimi mbi auditimin e ushtruar në Bashkinë Mirditë me objekt “Auditim financiar”

- Nga auditimi dhe vlerësimi, mbi zbatimin e rregullave për menaxhimin e fondeve të alokuara për rikuperimin e pasojave të tërmetit të vitit 2019 konkludojmë se, përgjithësisht janë zbatuar kriteret e vlerësimit, mangësitë e evidentuara rezultojnë të jenë materiale për nga konteksti cilësor. Mangësitë u evidentuan më së shumti në rregullshmërinë dhe saktësinë e dokumentacionit, që duhej të plotësohëj nga aplikantët, përfitues nga fondet e rindërtimit;

## OPINIONI I AUDITIMIT

### **Opinion i auditimit mbi pasqyrat financiare:**

KLSH auditori veprimtarinë e Bashkisë Mirditë për vitin ushtrimor 2020, për sa i takon shkallës së zbatueshmërisë të rregullave, ligjeve, termave dhe kushteve mbi të cilat është rënë dakord (kriteret e auditimit financiar), në mbështetje të ligjit nr. 154/2014, miratuar në datën 27.11.2014 për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe (ISSAI 4100) Rregulloren e Procedurave të Auditimit të KLSH dhe në Manualin e Auditimit.

Auditimi ka përfshirë ekzaminimin e pasqyrave financiare, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në to, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të tyre.

### **Opinion i modifikuar,**

Sipas mendimit tonë, pasi kemi marrë evidenca të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të besueshme të auditimit, mbështetur në standardet ISSAI 1700, ISSAI 1705 dhe ISSAI 1200, shprehim një opinion të modifikuar (kualifikuar) për llogaritë vjetore të vitit ushtrimor 2020 të Bashkisë Mirditë, duke arritur në përfundimin se anomalitë e konstatuara apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale por jo të përhapura.

### **Baza për opinionin e modifikuar:**

Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAIs). Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin ÷Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare, pjesë e raportit tonë përfundimtar. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10- Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etik, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin e pasqyrave financiare të një institucioni ndërkombëtar, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 5000- Auditimi i Institucioneve Ndërkombëtare- Udhëzues për SAI-n. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të auditimit. Opinionin e modifikuar është dhënë mbështetur në krahasimin e vlerës së anomalive të konstatuara me vlerën e materialitetit e cila është: 1,856,085 lekë

Rastet e mospërputhshmërisë në pasqyrat financiare të mbyllura në 31 Dhjetor 2020 paraqitet në si më poshtë:

Janë regjistruar në librat e kontabilitetit pa krijuar regjistrin e saktë të aktiveve të njësisë, si dhe pa u mbështetur në dokumentacion justifikues si ai i titullit të pronësisë këto llogari :

-Llogaria 520 ÷Disponibiliteti në thesarë është në vlerën 24,999,010 lekë, por në fakt duhet të jetë në vlerën 25,996,510 lekë, pra 997,500 lekë më shumë.

-Llogaria 211 ÷Pyje, Plantacione paraqitet e pandryshuar prej 119,419,757,580 lekë dhe në 2020 njëjloj si vitet e mëparshme, për të cilën nuk ka inventar kontabël, dhe as inventar fizik.

-Llogaria 215 ÷Mjete transporti për vitin 2020 në vlerën 14,134,225 lekë.



## KONTROLLI I LARTË I SHETIT

### Raport auditimi mbi auditimin e ushtruar në Bashkinë Mirditë me objekt “Auditim financiar”

-Llogarisë 26 ÷Pjesëmarrje në kapitalin e vetë për vlerën 70,867,000.lekë  
Mbvlerësim i llogarisë 466 ÷Kreditore për mjete nën ruajtje’ për vlerën 1,169,275 lekë.  
Nënvlerësim i llogarisë 85 ÷Rezultati i ushtrimito për vlerën 25,996,510 lekë;  
U evidentuan mangësi në identifikimin dhe monitorimin e risqeve, në hartimin strategjisë së riskut dhe regjistrin të risqeve, si dhe në hartimin e gjurmës së auditimit/hartës së proceseve, për aktivitetet kryesore të Bashkisë.

#### **Përgjegjësitë e Drejtuesve të Bashkisë Mirditë:**

Strukturat drejtuese të Bashkisë Mirditë, janë përgjegjëse për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara (kriteret e vlerësimit). Ato janë përgjegjëse për zbatimin e gjithë kuadrit rregullativ në menaxhimin e fondeve të alokuara për rikuperimin e pasojave të tërmetit të 26 Nëntorit, 2019. Gjithashtu, strukturat drejtuese të Bashkisë Mirditë janë përgjegjëse funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, hartimin e procedurave, aktiviteteve të kontrollit, gjurmës së auditimit dhe hartës së proceseve.

#### **Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH mbi Auditimin:**

Objektivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme<sup>2</sup>, nëse veprimtaria e subjektit të audituar është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin e tij profesional në punën audituese.

Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me zbatueshmërinë e kriterëve të vlerësimit, kuadrin ligjor dhe rregullator nga ana e subjektit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

## II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin 154/2014, datë 27.11.2014 ÷Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSHö, në zbatim të Programit të Auditimit nr. 52/1, datë 18.01.2022, miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 19.01.2022 deri në datë 25.02.2022, në subjektin Bashkia Mirditë, u krye auditimi financiar, i cili mbuloi periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2019 deri në datën 31.12.2021.

Auditimi u krye nga grupi i auditimit me përbërje:

1. M. B., Përgjegjës grupi;
2. A. Gj., Anëtar;
3. K. P., Anëtare.

**Titulli:** Auditim Financiar

**Marrësi:** Bashkia Mirditë

<sup>2</sup>ISA 200-ISSAI 2200 Objektivi i audituesit është të ofrojë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat si një e tërë nuk përmbajnë anomali materiale, raste mashtrimi ose gabime, si edhe të raportojë mbi këto pasqyra përsa i takon gjetjeve të tij/saj.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport auditimi mbi auditimin e ushtruar në Bashkinë Mirditë me objekt “Auditim financiar”

#### 1. Objektivat dhe qëllimi i auditimit

Auditimi financiar<sup>3</sup> është një vlerësim i pavarur i pasqyrave financiare, ku audituesi **shpreh një opinion** mesiguri të arsyeshme (siguri të lartë, por jo siguri absolute), mbi vërtetësinë e pasqyrave financiare, referuar ISA 200 si më poshtë:

- Objektivi i auditimit të pasqyrave financiare është të mundësojë audituesit që të shprehë një opinion nëse pasqyrat janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kuadrin raportues financiar në fuqi.
- Objektivi i audituesit është të ofrojë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si një e tërë nuk pëmbajnë anomali materiale, raste mashtrimi ose gabime, si edhe të raportojë mbi këto pasqyra për sa i takon gjetjeve të auditimit.

Ky projekt auditimi shtrihet për periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2019 deri në datë 31.12.2021, si dhe ka si fushë auditimi, planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit; auditimin e pasqyrave dhe transaksioneve financiare, si dhe procedurat e ndjekura nga subjekti i auditur mbi menaxhimin dhe administrimin e fondeve të alokuara, për rikuperimin e pasojave të tërmetit të 26 Nëntorit 2019.

#### 2. Identifikimi i çështjes

Referuar analizës së riskut, në fazën e planifikimit dhe auditimit në terren, u identifikuan fushat me risk më të lartë. Gjithashtu, pas rivlerësimit të risqve të identifikuar në fazën e planifikimit, në fazën e auditimit në terren u vlerësua si fushë me risk, menaxhimi dhe administrimi i fondeve buxhetore, të alokuara për rikuperimin e pasojave të tërmetit të 26 Nëntorit 2019, gjë e cila u reflektua me ndryshimin në Programin e Auditimit nr. 52/1, datë 18.01.2022.

Sa më sipër, fushat me risk të lartë u përcaktuan si drejtimet e auditimit të miratuara me Programin e Auditimit nr. 52/1, datë 18.01.2022 si më poshtë:

##### 1. Menaxhimi financiar dhe kontrolli brendshëm.

1.1 Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit (Mjedisi i kontrollit, Menaxhimi i riskut, Veprimtaritë e kontrollit, Informimi dhe komunikimi, si dhe Monitorimi);

1.2 Saktësia e deklaratës vjetore dhe raporti përkatës, për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm;

1.3 Organizimi dhe funksionimi i Njesisë së Auditit të Brendshëm Publik. Planifikimi dhe miratimi i programeve vjetore dhe strategjike të auditimeve, realizimi i programit vjetor të auditimit, dhe analiza sipas llojeve dhe gjetjeve të auditimit;

1.4 Ndjekja e zbatimit të masave të rekomanduara nga Njësia e Auditit të Brendshëm Publik të Bashkisë.

**2. Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit, bazuar në ligjin organik të buxhetit të shtetit, nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, ligjet vjetore “Për buxhetin e shtetit” të vitit 2020, si dhe aktet nënligjore mbi planifikimin, monitorimin dhe zbatimin e buxhetit.**

2.1. Programimi PBA dhe programimi i buxhetit vjetor për vitin 2019-2020-2021;

<sup>3</sup>ISSAI/IFPP-200-299 òParimet e auditimit financiarò



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport auditimi mbi auditimin e ushtruar në Bashkinë Mirditë me objekt “Auditim financiar”

2.2. Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas akteve normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fonde të çelura;

2.3. Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit.

Fondet e shpenzuara nga njësi vendore për shkak të situatës COVID -19, miratimi i këtyre fondeve sipas kuadrit rregullator në fuqi.

2.4. Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikujduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve; (Faturat e palikujduara të shoqërohen me listë analitike, të detajuara me numër fature dhe datë krijimi etj, sipas raportimit në MF, ku të evidentohen detyrimet nga mungesa e burimeve të veta dhe detyrimet nga mungesa e alokimit të granteve si FZHR, Ministritë e linjës etj.).

2.5. Çelja dhe ekzekutimi i fondeve të përfituara përmes FZHR, saktësia e raportimit buxhetor të tyre;

2.6. Niveli i realizimit të të ardhurave dhe mënyra e përdorimit të tyre. Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore dhe borxhi tatimor.

**3. Vlerësimi Raportimit Financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitin 2020, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi dhe konkretisht, ligjin nr. 24/2018, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” si dhe udhëzimi MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisë të Qeverisjes së Përgjithshme”.**

3.1. Plotësia dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike.

3.2. Plotësia e shënimeve në pasqyrat financiare për të dhënë një pamje të përgjithshme të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë të njësisë.

3.3. Opinioni mbi pasqyrat financiare.

#### **4. Të ndryshme të dala gjatë auditimit.**

### **3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese**

Strukturat drejtuese të Bashkisë Mirditë, janë përgjegjëse për përgatitjen dhe prezantimin e saktë të pasqyrave financiare në përputhje me kërkesat e ligjit për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare dhe kërkesat e tjera në kuadrin e raportimit financiar në fuqi, si dhe funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, që ka rezultuar i nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare, për të shmangur gabimet apo mashtrimet. Stafit drejtues është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikën, ligjet dhe rregulloret e aplikuara (kriteret e vlerësimit). Personat përgjegjës për drejtimin janë përgjegjës për kontrollin e procesit të raportimit financiar.

### **4. Përgjegjësitë e audituesve**

#### *a. Për auditimin financiar<sup>4</sup>:*

- Objektivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme, nëse pasqyrat financiare në tërësi, nuk paraqesin anomali materiale, kështu si pasaktësi apo

<sup>4</sup> SNA 240-IFPP 2240, Përgjegjësitë e audituesit lidhur me mashtrimin në një auditim të pasqyrave financiare



## KONTROLLI I LARTË I SHETIT

### Raport auditimi mbi auditimin e ushtruar në Bashkinë Mirditë me objekt “Auditim financiar”

gabime që mund të kenë ekzistuar, nëse veprimtaria e subjektit të audituar është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin e tij profesional në punën audituese.

- Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale duke i përshkruar në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

*Ne shprehemi në lidhje me:*

- Vlerësimi i ekzistencës, a është dokumentuar ekzistenca e ndodhjes së veprimeve dhe ngjarjeve ekonomike.
- Vlerësimi i plotësisë, dokumentacioni financiar dhe regjistrimi i tyre, a është kryer i plotë dhe në periudhat përkatëse ushtrimore, sipas parimit të të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara;
- Vlerësimi i saktësisë, a është dokumentuar pasi të gjitha veprimet e kryera janë regjistruar në Ditarin e bankës si dhe librat e tjera të kontabilitetit, si Ditarin e pagesave, Ditar magazinash, Ditari i arkës, etj. sipas shumave të urdhër shpenzimeve përkatëse;
- Vlerësimi i korrektesisë të klasifikimit, është kryer klasifikimi i saktë dhe janë prekur llogaritë e duhura, për çdo urdhër shpenzimi veprimet e kryera janë klasifikuar në llogaritë e duhura, sipas natyrës së shpenzimit (600, 601, 602, 23 etj.)
- Vlerësimi i afateve kohore, të gjitha transaksionet janë regjistruar në kohë dhe në mënyrë kronologjike janë regjistruar në ditarin e bankës. Janë regjistruar të gjitha detyrimet në kohën kur janë krijuar. Gjithashtu, nuk kanë rezultuar fatura të pa regjistruara në periudhat ushtrimore përkatëse.
- Vlerësimi i përputhshmërisë, veprimet mbi përlllogaritjen e shpenzimeve janë kryer në përputhje me rregullat dhe ligjet, kriteret e vlerësimit.
- ISSAI 4000 përcakton se, audituesit publikë duhet të përgatisin raportin e auditimit bazuar në parimet e plotësisë, objektivitetit, afatit, saktësisë dhe kundërshtimit. Më konkretisht:
  - Parimi i Plotësisë*, kërkon që audituesi të marrë parasysh të gjitha dëshmitë e provat përkatëse të auditimit si dhe të trajtojë të gjithë informatat dhe evidencat e duhura e të mjaftueshme para se të lëshojë raportin e angazhimit;
  - Parimi i Objektivitetit*, kërkon që audituesi të zbatojë gjykimin dhe skepticizmin profesional për të siguruar që raporti është faktikisht i saktë, dhe se gjetjet e konkluzionet janë të paraqitura në mënyrën e duhur, të drejtë dhe të ekuilibruar;
  - Parimi i Afatit* nënkupton përgatitjen e raportit në kohën e duhur, pasi vetëm në këtë mënyrë ai është i rëndësishëm për përdoruesit e synuar;
  - Parimi i Kundërshtimit ose Kontradiksionit*, nënkupton përfshirjen e komenteve nga subjekti përgjegjës në formën e përshtatshme, duke u përgjigjur dhe vlerësuar për këto reagime dhe komente.



## KONTROLLI I LARTË I SHETIT

### Raport auditimi mbi auditimin e ushtruar në Bashkinë Mirditë me objekt "Auditim financiar"

#### 5. Kriteret e vlerësimit

##### ▪ Standardet e Auditimit:

- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit;
- Manuali i Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të Audituesve (ECA);
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur, (IFAC);
- Manuali i Auditimit Financiar, KLSH;
- Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë, KLSH;

##### ▪ Akte ligjore:

- Ligji nr.154/2014, datë 27.11.2014 ÷Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit;
- Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 ÷Për menaxhimin financiar dhe kontrollin;
- Ligji nr. 139/2015 ÷Për vetëqeverisjen vendore;
- Ligji nr.10405, datë 24.03.2011 ÷Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve, me ndryshime;
- Ligji nr. 68/2017 ÷Për financat e vetëqeverisjes vendore;
- Ligj nr. 20/2020 ÷Për Përfundimin e Proceseve Kalimtare të Pronësisë në Republikën e Shqipërisë

##### ▪ Akte nënligjore

- VKM nr.1174, datë 24.12.2020 ÷Për Procedurat e Regjistrimit të AMTP-ve, Saktësimin e Kufijve e Sipërfaqeve, si dhe Normat për Sipërfaqet Shtetërore Shtesë e Pronat Shërbyese, etj;
- VKM nr. 904, datë 24.12.2019 ÷Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit;
- VKM nr. 329, datë 16.05.2012 ÷Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimet njerëzore;
- VKM nr. 5, datë 06.01.2020 ÷Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet modelë, me ndryshime;
- VKM nr. 401, datë 19.05.2020 ÷Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet modelë, etj.

##### ▪ Udhëzime, Urdhra dhe Rregullore:

- Udhëzimi MF nr.8, datë 09.03.2018 ÷Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësisve të Qeverisjes së Përgjithshme;
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2012 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik";
- Rregullore e Brendshme ÷Mbi organizimin dhe funksionimin administrativ KLSH<sup>së</sup>, miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH<sup>së</sup> nr.85, datë 30.06.2015 e ndryshuar;
- Rregullore e brendshme ÷Mbi Procedurat e auditimit në KLSH<sup>o</sup>, miratuar me vendimin nr. 107, datë 08.08.2017 të Kryetarit të KLSH<sup>së</sup> e ndryshuar;
- Rregullore mbi organizimin dhe funksionimin e Bashkisë Mirditë, etj;



## KONTROLI I LARTË I SHTETIT

### Raport auditimi mbi auditimin e ushtruar në Bashkinë Mirditë me objekt “Auditim financiar”

- Vendime të Këshillit Bashkiak, Bashkia Mirditë

#### 6. Standardet e auditimit

Auditimi është kryer, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të INTOSAI-t (ISSAI/IFPP), përkatësisht në: Nivelin e parë të Parimet INTOSAI-të ku përfshihet: ISSAI-P-1 të Deklarata e Limësë , ISSAI-P-10 të Deklarata e Meksikosë; Nivelin e dytë të Standardet e INTOSAI-të ku përfshihen: ISSAI 100 - Parimet bazë në auditimin e sektorit publik; ISSAI 200-299 të Parimet bazë të auditimit financiarë, ISSAI 400-499 të Parimet bazë të auditimit të përputhshmërisë.

Gjithashtu janë zbatuar dhe aplikuar standardet si më poshtë:

#### ISSAI-140 “Sigurimin e cilësisë”

Gjatë auditimit, ka funksionuar sistemi i mbikëqyrjes dhe sigurimit të cilësisë, për të marrë siguri të arsyeshme, për dhënien e opinionit:

- Grupi i auditimit, ka vepruar në përputhje me standardet profesionale dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore;
- Grupi i auditimit, në mënyrë individuale dhe kolektive ka patur kompetencën e nevojshme profesionale për të kryer auditimin;
- Grupi i punës, është mbikëqyrur nga Përgjegjësi i Grupit, Kryeaudituesi dhe Drejtori i Departamentit, për të siguruar që auditimi është kryer në përputhje me standardet përkatëse profesionale.

#### ISSA 130 “Kodin Etik”

Grupi i auditimit, gjatë punës audituese në terren vepruar në përputhje me Kodin Etik, duke reflektuar:

- Integritet.
- Pavarësi, objektivitet, paanshmëri.
- Ruajtjen e sekretit profesional.
- Kompetencat dhe kujdesin e duhur.
- Sjelljen profesional.

#### ISSAI 2315 “Risku”<sup>5</sup>

Gjatë fazës së planifikimit dhe auditimit në terren, është kryer vlerësimi i riskut, si dhe u identifikuan fushat më risk më të lartë, mbi të cilat u fokusua auditimi. Nga Grupi i auditimit u vlerësua RA ( $RA=RB \cdot RKB \cdot RMZ$ ), ku u vlerësua:

- Kuptimi i subjektit dhe mjedisit i tij;
- U identifikua dhe vlerësua risku i brendshëm;
- U vlerësua funksionimi i sistemit të kontrollit të brendshëm;
- U përcaktua rreziku i mos zbulimit;
- U aplikua modeli i sigurisë, (Më hollësisht të trajtuara në Letrat e punës).

#### ISSAI 2320<sup>6</sup> “Materialiteti”-2450<sup>7</sup> “Vlerësimi i anomalive”

<sup>5</sup>SNA 315 (i rishikuar)-IFPP 2315, Identifikimi dhe vlerësimi i rreziqeve të anomalive materiale, nëpërmjet njohjes së entitetit dhe mjedisit të tij

<sup>6</sup>SNA 320-IFPP 2320, Materialiteti në planifikimin dhe në kryerjen e një auditimi

<sup>7</sup>SNA 450-IFPP 2450, Vlerësimi i anomalive të identifikuar gjatë auditimit



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport auditimi mbi auditimin e ushtruar në Bashkinë Mirditë me objekt “Auditim financiar”

Nga Grupi i auditimit është përcaktuar sipas zonave të llogarisë niveli i materialitetit, i cili ka rezultuar si sasior, po ashtu edhe cilësor (kryesisht në auditimin e përputhshmërisë);

#### ISSAI 2500 “Dokumentimi”<sup>8</sup>

Nga Grupi i auditimit është siguruar dokumentimi i gjetjeve të auditimit, duke u bazuar kryesisht në një evidencë të plotë, të saktë, të besuar, të mjaftueshme, duke marrë në konsideratë kriteret e mëposhtme:

- Mjaftueshmërinë e evidencës së auditimit
- Rëndësia e evidencës së auditimit
- Burimet e evidencës së auditimit
- Llojet e evidencës së auditimit, etj.

## 7. Metodologjia e auditimit

Përzgjedhja e metodave të përdorura, u mbështetet në vlerësimin e riskut, materialitetit, kostos dhe efikasitetit të auditimit, duke patur në fokus përmbushjen e qëllimit të procedurës së auditimit. Duke qenë se thelbi i MFK-së ka të bëjë me menaxhimin dhe kontrollin e të ardhurave, shpenzimeve, aktiveve, detyrimeve, si dhe mënyrës së funksionimit të njësisë, së pari u vlerësua niveli i zbatimit të këtij ligji si dhe funksionimi i 5 komponentëve të kontrollit të brendshëm nga njësia e audituar, si një prej elementëve kryesorë të vlerësimit të Riskut të Auditimit (RA).

Përsa i përket funksionimit të sistemit të kontrollit të brendshëm, zbatueshmërisë nga ana e subjektit të audituar të MFK-së, Grupi i auditimit ka kryer intervista me shkrim dhe verbale, ka kryer teste kontrolli, të cilat në mënyrë analitike janë të përshkuara në Letrat e punës. Nga vlerësimi i riskut në fazën e planifikimit dhe në fazën e auditimit në terren, ka rezultuar se sistemi i kontrollit të brendshëm, konkretisht 5 komponentët përbërës si: Mjedisi i kontrollit, Menaxhimi i riskut, Aktivitetet e kontrollit, Informimi/komunikimi, si dhe Monitorimi, ka paraqitur përmirësime në raport me periudhën e mëparshme të vlerësuar nga KLSH.

- Për dhënien e një vlerësimi sa më objektiv, profesional e të pavarur, të saktë, të plotë e të qartë për zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë (përputhshmërisë) nga ana e subjektit të audituar, në lidhje me procedurat e ndjekura gjatë procesit: a) të regjistrimit, b) dokumentimit, c) miratimit dhe d) ekzekutimit të masës së përfitimit, nga fondi i rindërtimit të tërmetit të 26 Nëntorit-2019, u gjykua që të kryhen teste thelbësore (të detajeve) për 108 praktika, ose në masën 33 % të tyre, bazuar në disa kriteret e riskut. Meqenëse RA u vlerësua i mesëm (subjekti ka përmirësime në krahasim me periudhën e mëparshme të vlerësuar), numri i transaksioneve ishte i lartë për periudhën objekt auditimit (350 transaksione), u gjykua që mbulimi me auditim të jetë në masën 30 %. Kjo mbështetur në Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, pika 5.7 ÷ Marrja e kampioneve dhe mjete të tjera që përdoren për të përzgjedhur elementet/artikujt që do të testohen, ku cilësohet se: *“Përzgjedhja e 100% të artikujve është e përshtatshme në ato raste kur, ka numër të vogël artikujsh në vlerë të madhe dhe kur risku është i lartë. Kjo metodë është më e përshtatshme në rastet e përzgjedhjes së testeve thelbësore (të detajeve) se sa në testet e kontrolleve”*.
- Për të ardhurat, janë përdorur teste thelbësore (substanciale), (trajtuar më hollësisht te letrat e punës).

<sup>8</sup>SNA 500-IFPP 2500, Evidenca e auditimit





## KONTROLLI I LARTË I SHETIT

### Raport auditimi mbi auditimin e ushtruar në Bashkinë Mirditë me objekt “Auditim financiar”

Testet e Kontrollit, të cilat janë përdorur nga Grupi i Auditimit, janë të mbështetura tek niveli i materialitetit dhe vlerësimit të riskut, shkalla e sigurisë që përfitohet nga kryerja e testeve të kontrollit, teknikat e kampionimit dhe zgjedhjes rastësore.

Testet e detajeve, të cilat janë përdorur nga Grupi i Auditimit, për të marrë evidencë auditimi për pohimet (ekzistenca e një ngjarje ekonomike, ligjshmëria dhe vlerësimi i saj).

Për pasqyrat në gjykimin profesional të audituesit, është përcaktuar pragu i materialitetit, bazuar në Manualin e auditimit financiar, me metodën e përqindjes mbi shpenzimet korente dhe kapitale, dhe përkatësisht në vlerën 1,856,085 lekë. Përsa i përket, rregullshmërisë dhe ligjshmërisë së shpenzimeve dhe transaksioneve të kryera, bazuar në analizën e RA, i cili është konsideruar i lartë, për zonën e llogarive 23, është kryer auditim i plotë, për shkak të vlerës së lartë që përbëhet nga një numër i kufizuar transaksionesh dhe transaksionve të kufizuara. Ndërkohë u audituan me zgjedhje, veprimtaritë dhe ngjarjet e tjera ekonomike, të cilat sipas gjykimit profesional të audituesit rezultojnë me risk më të ulët

#### 8. Dokumentimi i auditimit

është mbështetur në kërkesat e manualeve të auditimit, në Manualin e Auditimit Financiar, Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, Rregulloren e Procedurave të Auditimit, si edhe në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Grupi i auditimit ka dokumentuar punën audituese në të gjitha fazat e ezauruara (planifikim dhe auditim në terren). Nga Grupi i auditimit janë plotësuar të gjitha dokumentet standarde të auditimit, si dhe është lënë gjurmë auditimi për të gjitha procedurat e kryera nga Grupi i auditimit.

### III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

#### 1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim

##### Të dhëna të përgjithshme dhe pozicioni gjeografik

Mirdita kufizohet në veri me Bashkitë e Fushë Arrësit dhe Pukës, në perëndim me të Lezhës dhe në lindje me Bashkinë e Kukësit. Në jug-lindje me bashkinë Dibër, në jug me Bashkinë Mat ndërsa në jugperëndim me bashkinë Kurbin. Qendra e kësaj bashkie është qyteti i Rrëshenit. Sipas Censurit të vitit 2011, Mirdita ka 22,103 banorë. Ndërkohë që sipas Regjistrit Civil kjo bashki numëron 37,384 banorë. Me një sipërfaqe prej 869.71 km<sup>2</sup>, bashkia e re ka një densitet prej 42.98 banorë/km<sup>2</sup> sipas Regjistrit Civil dhe 24.64 banorë/km<sup>2</sup> sipas Censurit 2011.

Emri i Njësisë	Qytetet dhe fshatrat në përbërje të tyre
<b>Rrëshen</b>	<b>Qyteti:</b> Rrëshen <b>Fshatrat:</b> Ndërfushas ,Ndërfan, Gëziq, Tarazh, Jezull, Kodër Rrëshen, Sheshaj, Fushë-Lumth, Malaj, Malaj Epërm, Tenë, Lurth, Bukmirë, Kulmë
<b>Rubik</b>	<b>Fshatrat:</b> Fierzë, Bulshizë, Fang, Rasfik, Katund i Vjetër, Munaz, Rreja e Zezë, Rreja e Veles, Vau Shkezë, Rrethi i Sipërm, Livadhëz, Bulger.
<b>Selitë (Kurbnesh)</b>	<b>Fshatrat:</b> Lufaj, Bardhaj, Lëkundë, Zajs, Kthellë e Sipërme, Kurbnesh-fshat, Mërkurth, Kumbull.
<b>Kthellë</b>	<b>Fshatrat:</b> Perlat Qendër, Perlat i Sipërm, Shebe, Tharr, Trojë, Prosek, Rrushkull, Ujë, Shtrezë



## KONTROLI I LARTË I SHTETIT

### Raport auditimi mbi auditimin e ushtruar në Bashkinë Mirditë me objekt “Auditim financiar”

<b>Fan</b>	<b>Fshatrat:</b> Klos, Shtrungaj, Bisakë, Fan, Zall-Xhuxhë, Katundi i Ri, Konaj, Shëngjin, Petoq, Xhuxhë, Dardhëz, Thirrë, Sang, Hebe, Domgjon, Gjakëz, Munellë
<b>Orosh (Reps)</b>	<b>Fshatrat:</b> Kullaxhi, Blinisht, Pshqesh, Mashtërkor, Shëmri, Grykë Orosh, Lgjin, Bulshar, Planet, Ndërshen, Nënshajt, Kodër-Spaç, Gurth-Spaç, Lajthizë
<b>Kaçinar</b>	<b>Fshatrat:</b> Kaçinar, Arrëz, Kuzhnen, Simon, Shëngjergj, Shtuf, Shpërdhezë

#### Të dhëna të tjera

Bashkia e re e Mirditës shtrihet në një territor me trashëgimi të larmishme kulturore dhe etnografike, ndërkohë që nëntoka e saj është gjithashtu e pasur me minerale. Mirdita mori rëndësi si rrugë kalimi dhe si porta natyrore hyrëse për në Kosovë, pas ndërtimit të autostradës A1. Rruga e Kombit përfundoi së ndërtuari në vitin 2009, megjithatë nuk dha efektet e pritshme për banorët e Mirditës. Përveç cilësisë së udhëtimit, kjo rrugë solli një impakt modest për zhvillimin social-ekonomik të zonës.

Sipërfaqja e pyjeve në bashkinë e Mirditës është 10 herë më e madhe se fondi i tokës bujqësore. Për këtë arsye, problemet ekologjike të zonës, të tilla si përpunimi i drurit, ai i frutave të pyllit, prodhimi i lëngjeve vitaminore dhe zhvillimi i gjuetisë sportive janë të lidhura me pyjet. Një nga fushat më interesante është edhe shfrytëzimi i kapaciteteve hidro ó energjetike të lumenjve të Fanit të madh dhe Fanit të vogël, Urakës, Zallit të Dodajve, dhe përrenjve të tjerë malorë, ku vlerësohet se mund të sigurohen kapacitete prodhuese energjetike deri në 60 M /H. Pasuritë e mëdha nëntokësore të Mirditës kanë bërë që në territorin e kësaj krahine të krijohen katër qytete, të cilat janë të lidhura me industrinë minerare. Pjesa më e madhe e kësaj industrie është e mbyllur tashmë. Krahina e Mirditës shënoi një ndër nivelet më të larta të migrimit të brendshëm përgjatë 25 viteve të fundit si dhe të emigrimit.

Veprimtaria e saj bazohet në Ligjin nr. 139/2015 òPër vetëqeverisjen vendore, Ligjin nr. 68/2017 òPër financat e vetëqeverisjes vendore; Ligjin nr. 115/2014 òPër ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë, etj.

Vendimet merren nga Këshilli Bashkiak i përbërë nga 15 anëtarë;

Drejtimi i Bashkisë kryhet nga Kryetari i Bashkisë;

Njësitë Administrative drejtohen nga Administratorët e Njësive Administrative;

#### **Detyrat dhe kompetencat e Bashkisë Mirditë fokusohen kryesisht në:**

- Shërbimin publik;
- Shërbimin social;
- Shërbimin kulturor dhe sportet;
- Biznesin.

Misioni për njësinëqëauditohet është: Kryerja e funksioneve të veta, të përbashkëta dhe të deleguara në interes të komunitetit, duke përdorur në mënyrë efikase dhe të qëndrueshme burimet natyrore dhe financiare (të ardhurat e veta, grandin dhe fondet e dhëna nga buxheti i shtetit me synim krijimin e kushteve të sigurisë dhe mirëqenies për komunitetin).

Objektivat burojnë nga ligji òPër vetëqeverisjen vendore.

Ndërsa administrata (aparati) i këtij institucioni ka si qëllim: përmirësimin e kushteve të punës, rritjen e nivelit të drejtimit dhe rishikimin funksional të Bashkisë, zhvillimin e politikave dhe strategjive, identifikimin, koordinimin dhe monitorimin e programeve, rritjen e efektivitetit të përdorimit të burimeve.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport auditimi mbi auditimin e ushtruar në Bashkinë Mirditë me objekt “Auditim financiar”

Bashkia siguron qeverisjen në një nivel sa më afër shtetasve nëpërmjet: njohjes së ekzistencës së identiteteve dhe vlerave të ndryshme të bashkësisë; respektimit i të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve të sanksionuara në Kushtetutë ose në ligje të tjera; zgjedhjes së llojeve të ndryshme të shërbimeve dhe lehtësirave të tjera publike vendore në dobi të bashkësisë; ushtrimit efektiv të funksioneve, kompetencave dhe realizimit të detyrave nga Bashkia; realizimit të shërbimeve në forma të përshtatshme dhe nxitjes efektive të pjesëmarrjes së bashkësisë në qeverisjen vendore.

## 2. Përshkrimi rezultateve sipas drejtimeve të auditimit

### 2.1 Menaxhimi financiar dhe kontrolli brendshëm

2.2.1.1. Mbi vlerësimin e mjedisit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm.

Në zbatim të pikës 1 të programit të auditimit nr. 52/1 datë 18/01/2022, u shqyrtuan dokumentacioni si më poshtë:

- Raportet vjetore për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm;
- Plani Vjetor i Punës
- Harta e proceseve të punës;
- Strategjia e Riskut për periudhën 2019-2021;
- Deklarata e cilësisë së sistemit të kontrollit të brendshëm;
- Pyetësorët e vetëvlerësimit të Bashkisë Mirditë;
- Plani i Kontrollit të Brendshëm;
- Plani i Veprimit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin;
- Vendime të Këshillit të Bashkisë;
- Regjistri i riskut për periudhën 2019-2021;
- Urdhër të brendshëm për krijimin e grupeve të GSM;
- Urdhër të Grupit të Menaxhimit Strategjik (G.M.S.) etj.

Bashkia Mirditë funksionon bazuar në Rregulloren e Brendshme të Bashkisë Mirditë, nr. 946 prot., datë 05.03.2018. Referuar formatit të Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, përvoja e përkjet pjesës për Rregulloren e Brendshme të Njësisë Publike, vihet re se është hartuar bazuar në këtë manual, duke përmbajtur disa elemente thelbësore që çdo rregullore duhet të ketë. Bashkia Mirditë për vitin 2019 nuk ka pasur një Kod Etike, pasi ka funksionuar vetëm me Rregulloren e Brendshme. Kodi i Etikës është hartuar në vitin 2020, shkresa nr.502/1 prot., 06.02.2020, në bazë të Urdhrit të Kryetarit të Bashkisë Mirditë, Urdhër Nr. 28, datë 06.02.2020, nr. 502 prot., bazuar në legjislacionin përkatës, ku mbështetet Njësia Publike për hartimin dhe përpilimin e tij. Rezulton se si grup pune, për hartimin e Kodit të Etikës Profesionale për nivelin menaxhues dhe për punonjësit e tjerë të njësisë, Kryetari i Bashkisë ka ngarkuar Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Marrëdhënieve me Publikun; dhe Drejtorinë Juridike dhe Prokurimeve.

- Mbi rekrutimin e punonjësve në marrëdhëniet e punës

Për vitin 2019, numri i punonjësve në administratën e Bashkisë Mirditë, referuar Strukturës së Detajuar për vitin 2019, Nr.207. prot., datë 17.01.2019, të miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak Nr. 115, datë 26.12.2017, është gjithsej 359 punonjës, përfshirë këtu edhe punonjësit e institucioneve (agjencive) në varësi të Bashkisë edhe ata të Njësive Administrative. Nga të cilët në pozicione pune, trajtuar sipas ligjit nr. 152/2013 òPër nëpunësin Civilò, në muajin janar 2019 janë 38 punonjës me status, 298 punonjës me kontratë pune dhe 23 vakanca. Ndërsa në dhjetor 2019 janë, 37 punonjës me status, 297 punonjës me kontratë pune dhe 25 vakanca.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport auditimi mbi auditimin e ushtruar në Bashkinë Mirditë me objekt “Auditim financiar”

Për vitin 2020, numri i punonjësve në administratën e Bashkisë Mirditë, referuar Strukturës së Detajuar për vitin 2020, Nr.625/1. prot., datë 17.02.2020, është gjithsej 357 punonjës, përfshirë këtu edhe punonjësit e institucioneve (agjencive) në varësi të Bashkisë edhe ata të Njësive Administrative. Nga të cilët në pozicione pune, trajtuar sipas ligjit nr. 152/2013 òPër nëpunësin Civilò, në muajin janar 2020 janë, 38 punonjës me status, 297 punonjës me kontratë pune dhe 22 vakanca. Ndërsa në dhjetor 2020 janë 41 punonjës me status, 296 punonjës me kontratë pune dhe 20 vakanca.

Për vitin 2021, numri i punonjësve në administratën e Bashkisë Mirditë, referuar Strukturës së Detajuar për vitin 2021, Nr.389/1. prot., datë 25.01.2021, është gjithsej 380 punonjës, përfshirë këtu edhe punonjësit e Institucioneve (agjencive) në varësi të Bashkisë edhe ata të Njësive Administrative. Nga të cilët në pozicione pune, trajtuar sipas ligjit nr. 152/2013 òPër nëpunësin Civilò, në muajin janar 2021 janë, 42 punonjës me status, 297 punonjës me kontratë pune dhe 41 vakanca. Ndërsa në dhjetor 2021 janë, 45 punonjës me status, 286 punonjës me kontratë pune dhe 49 vakanca. Ky informacion i referohet shkresës nr. 691 prot., datë 09.02.2022 nga zyra e Burimeve Njerëzore.

#### - Menaxhimi i riskut:

Regjistri i Riskut në Bashkinë Mirditë, për vitin 2019, nr. 5632 prot., datë 20.12.2018; Regjistri i Riskut për vitin 2020 nr. 5354 prot., datë 30.12.2019; Regjistri i Riskut për vitin 2021 nr. 5270 prot., datë 29.12.2020, është hartuar sipas formatit që përcaktohet në Manualin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit. Në përgjithësi, është i plotësuar për të gjitha kategoritë që përmban një regjistër risku.

#### - Mbi veprimtaritë e kontrollit

Referuar shkresës, Urdhër Nr. 348, datë 28.12.2017, òPër ngritjen e grupit të Menaxhimit Strategjikò për hartimin e buxhetit të Bashkisë Mirditë, përbëhet nga 19 anëtarë. Referuar shkresës, Urdhër Nr. 271, datë 19.09.2019, nr. 3752 prot., 19.09.2019, òPër ngritjen e Ekipeve të Menaxhimit të Programeveò, për përgatitjen e Buxhetit 2020 dhe PBA 2021-2023.

Referuar shkresës, Urdhër Nr. 272, datë 19.09.2019, nr. 3754 prot., 19.09.2019, òPër ngritjen e grupit të Menaxhimit Strategjikò, të përbërë nga 18 anëtarë, për përgatitjen e Buxhetit 2020 dhe PBA 2021-2023. Referuar shkresës, Urdhër Nr. 114, datë 9.6.2020, nr. 1627 prot., datë 9.6.2020, Për disa ndryshime në urdhrat Nr. 271 dhe Nr. 272, datë 19.09.2020, janë bërë ndryshime dhe zëvendësime të 4 anëtarëve. Referuar shkresës, Urdhër Nr. 242, datë 27.09.2021, nr. 3681 prot., òPër ngritjen e grupit të Menaxhimit Strategjikò, të përbërë nga 20 anëtarë, për përgatitjen e Buxhetit 2022 dhe PBA 2023-2025 të Bashkisë Mirditë. Koordinatori i riskut për vitet 2019, 2020 dhe koordinatori për 2021, janë të emëruar bazuar në urdhrat më lart.

Deklarata e Cilësisë për vitin 2019 me shkresën nr. 807/1 prot., datë 28.02.2020; Deklarata e Cilësisë për vitin 2020 me shkresën nr. 891/1 prot., datë 26.02.2021; Deklarata e Cilësisë për vitin 2021 me shkresën nr. 544/1 prot., datë 01.02.2022, në Bashkinë Mirditë është hartuar dhe dërguar në Drejtorinë e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit në MFE

Pyetësori i Vetëvlerësimit për funksionimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit Për vitin 2019, shkresa nr. 807 prot., datë 28.02.2020; për vitin 2020, shkresa nr. 891 prot., datë 26.02.2021; për vitin 2021 shkresa nr. 544 prot., datë 01.02.2022.

Përgjithësisht pyetësori në Bashkinë Mirditë është realizuar duke u mbështetur në manualin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit dhe ligjin Nr.10 296, datë 8.7.2010, òPër menaxhimin



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport auditimi mbi auditimin e ushtruar në Bashkinë Mirditë me objekt “Auditim financiar”

financiar dhe kontrollinö. Vlerësimi i riskut është bërë sipas katër seksioneve, mjedisi i kontrollit, menaxhimi i riskut, veprimtaritë e kontrollit, informacioni dhe komunikimi, monitorimi.

- Raporti vjetor për funksionimin e sistemi të kontrollit të brendshëm

Për vitet 2019 ó 2021 është hartuar dhë përpiluar sipas manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollit, bazuar në Neni 18, Ligji Nr.10 296, datë 8.7.2010, óPër Menaxhimin Financiar dhe Kontrollinö. Duke përmbajtur të gjitha rubrikat kryesore si përmbledhja ekzekutive, vlerësimi i sistemit të MFK-së, gjetjet dhe rekomandimet e auditit të brendshëm dhe të jashtëm, masat e marra gjatë vitit për përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësi dhe plan veprimi për të ardhmen.

Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në Bashkinë Mirditë, për periudhën objekt auditimi 2019 - 2021, funksionon me hartën e proceseve të punës të miratuar nga Kryetari i Bashkisë Mirditë, që nga viti 2018 e në vazhdim. Kjo drejtori është e ndarë në Sektorin e Buxhetit dhe Sektorin e Financës. Ky dokument është hartuar sipas formatit të Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin duke iu referuar gjithashtu edhe bazës ligjore përkatëse. Nëpërmjet hartës së proceseve të punës, garantohet uniformiteti në kryerjen e proceseve të punës, identifikohen aktivitetet e kryera, përgjegjësitë për kryerjen e një aktiviteti, si dhe afatet brenda të cilave këto aktivitete duhet të kryhen, së bashku me një pamje të përgjithshme të veprimtarive të kontrollit, që identifikohen brenda një procesi dhe që garantojnë përmbushjen e objektivave të tij.

Janë përgatitur formatet e hartave të proceseve për vitin 2019, 2020 dhe 2021, që paraqesin nën procese si, ekzekutimi i transaksioneve të ndryshme financiare dhe kontabilizimi i tyre; përgatitja dhe saktësimi i projekt ó buxhetit vjetor të Bashkisë; përgatitja dhe saktësimi i PBA-ve të Bashkisë; Përgatitja e tabelave të monitorimit të buxhetit në çdo 4-mujor; rakordimi mujor me degën e thesarit për shpenzimet; përgatitja e bilancit vjetor; evidentimi në Këshillin Bashkiak të të gjitha ngjarjeve ekonomiko ó financiare. Te kategoria afati, specifikohet se pagesat financiare ekzekutohen sipas nevojës, ndërsa për përgatitjen e buxhetit të PBA dhe të gjithë dokumentat financiare kalojnë nëpër afatet e paracaktuara, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Datat e hartave të procesit të punës janë 08.01.2019; 20.01.2020; dhe 15.01.2021.

- Plani i Veprimit për Kontrollin e Brendshëm

Si një instrument për përshkrimin dhe organizimin e aktiviteteve të kontrollit me qëllim menaxhimin e risqeve kryesore dhe dhënien e sigurisë së arsyeshme se objektivat dhe qëllimet do të arrihen për periudhën objekt auditimi. Plani i Veprimit për Kontrollin e Brendshëm është i hartuar nga njësi e menaxhimit financiar dhe miratuar nga Kryetari i Bashkisë, për periudhën 2019 ó 2020 me shkresë nr. 922/3 prot., datë 28.02.2019 dhe për vitin 2021, me shkresë nr. 920 prot., datë 01.03.2021, sipas formatit standard, që ka manuali i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit pika 3.3 e tij, duke përfshirë një pjesë të konsiderueshme të aktiviteteve të planifikuara për periudhën e përmendur më lart.

Për periudhën objekt auditimi Plani i Veprimit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin është i hartuar dhe miratuar për periudhën 2019 ó 2020 me shkresën nr. 922/2 prot., datë 28.02.2019 dhe për vitin 2021, me nr. 919 prot., datë 01.03.2021. Është hartuar sipas formatit që ka manuali i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, kapitulli IV i tij, duke përfshirë një pjesë të konsiderueshme të aktiviteteve të planifikuara për periudhën e përmendur më lart.

Plani i Veprimit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin dhe miratuar nga Kryetari i Bashkisë, sipas formatit standard që ka manuali i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, kapitulli IV i tij,



## **KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**

### **Raport auditimi mbi auditimin e ushtruar në Bashkinë Mirditë me objekt “Auditim financiar”**

duke përfshirë një pjesë të konsiderueshme të aktiviteteve të planifikuara për periudhën e përmendur më lart.

Në Bashkinë Mirditë, bazuar në Urdhër Nr. 38, datë 22.02.2018, nr. 821 prot., òPër miratimin e dokumentave të gjurmës së auditit sipas manualit të MFKò, janë hartuar gjurmët e auditit për gjithë aktivitetin ekonomik o financiar, duke marrë në konsideratë ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 òPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, si më poshtë:

Gjurma e Auditit në përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm PBA (2019 e në vazhdim)

Referuar Urdhër Nr. 38, datë 22.02.2018, nr. 821 prot., òPër miratimin e dokumentave të gjurmës së auditit sipas manualit të MFKò, gjurma e auditit për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm PBA është e miratuar nga Kryetari i Bashkisë dhe hartimi i saj është për periudhën nga viti 2019 dhe me të njëjtën gjurmë funksionon edhe vitet në vazhdim. Ky dokument është mbështetur në bazën ligjore specifike dhe në të përshkruhen si vijon, përgatitja e kërkesave buxhetore; kërkesa shtesë për shpenzime në programin buxhetor afatmesëm; raportimi i kërkesave buxhetore. Gjithashtu janë paraqitur të gjitha proceset e kategorive të sipërpërmendura, duke adresuar edhe strukturat përgjegjëse që angazhohen me secilin nga proceset. Gjithashtu ka edhe procesverbal për përfundimin e hartimit të PBA për vitin 2021 o 2023, nr. 5454, datë 31.12.2021, mbi Menaxhimin e Riskut në Bashkinë Mirditë.

Gjurma e Auditit e zbatimit të Buxhetit (viti 2019 e në vazhdim)

Referuar Urdhër Nr. 38, datë 22.02.2018, nr. 821 prot., òPër miratimin e dokumenteve të gjurmës së auditit sipas manualit të MFKò, gjurma e auditit për zbatimin e buxhetit është e miratuar nga Kryetari i Bashkisë dhe hartimi i saj është për periudhën nga viti 2019 dhe me të njëjtën gjurmë funksionon edhe vitet në vazhdim. Ky dokument është mbështetur në bazën ligjore specifike dhe në të përshkruhen si vijon, procedurat standarde të shpërndarjes së fondeve të buxhetit vjetor (rishpërndarja e fondeve buxhetore, numri i punonjësve buxhetorë); procedurat për kryerjen e shpenzimeve publike; marrja e angazhimit dhe kryerja e shpenzimeve publike; rakordimi mujor i shpenzimeve; titulli për arkëtim dhe paraqitja e tij në bankat e nivelit të dytë; rakordimi mujor i të ardhurave; raportet e monitorimit. Gjithashtu janë paraqitur proceset e kategorive të sipërpërmendura, duke adresuar edhe strukturat përgjegjëse që angazhohen me secilin nga proceset. Bashkangjitur me gjurmën e auditit për programin buxhetor afatmesëm PBA, është hartuar edhe përshkrimi i punës, për detyrat specifike, që kryhen në Drejtorinë e Financave dhe Buxhetit.

Gjurma e Auditit për prokurimet me vlerë mbi 800.000 lekë pa TVSH

Referuar Urdhrit Nr. 38, datë 22.02.2018, nr. 821 prot., òPër miratimin e dokumentave të gjurmës së auditit sipas manualit të MFKò, gjurma e auditit për prokurimet me vlerë mbi 800.000 lekë pa TVSH është e miratuar nga Kryetari i Bashkisë Mirditë dhe hartimi i dokumentit është kryer nga Drejtoria Jurdike dhe Prokurimeve Publike. Ky dokument është mbështetur në bazën ligjore specifike dhe në të përshkruhen si vijon, organizimi i prokurimit publik; zhvillimi i procedurës; lidhja e kontratës; zbatimi i kontratës; dhe dokumentet për pagesë në thesar.

Gjurma e Auditit për prokurimet me vlerë nën 800.000 lekë pa TVSH

Referuar Urdhrit Nr. 38, datë 22.02.2018, nr. 821 prot., òPër miratimin e dokumenteve të gjurmës së auditit sipas manualit të MFKò, gjurma e auditit për prokurimet me vlerë nën 800.000 lekë pa TVSH është e miratuar nga Kryetari i Bashkisë Mirditë dhe hartimi i dokumentit është kryer nga Drejtoria Jurdike dhe Prokurimeve Publike. Ky dokument është mbështetur në bazën ligjore specifike dhe në të përshkruhen si vijon, organizimi i prokurimit publik; zhvillimi i



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport auditimi mbi auditimin e ushtruar në Bashkinë Mirditë me objekt “Auditim financiar”

procedurës; lidhja e kontratës; zbatimi i kontratës; dhe dokumentet që duhet të dorëzohen në thesar.

#### Gjurma e Auditit për përgatitjen e Paketës Fiskale

Referuar Urdhrit Nr. 38, datë 22.02.2018, nr. 821 prot., òPër miratimin e dokumenteve të gjurmës së auditit sipas manualit të MFKò, gjurma e auditit për përgatitjen e paketës fiskale është e miratuar nga Kryetari i Bashkisë Mirditë dhe hartimi i dokumentit është kryer nga Drejtoria e të ardhurave, taksave, tregut, transportit dhe aseteve. Ky dokument është mbështetur në bazën ligjore specifike dhe në të përshkruhen si vijon, Faza përgatitore për përgatitjen e PF; hartimi i ftesave për dëgjesa publike; procesi i dëgjesave publike; përfundimi i dëgjesave dhe përgatitja e paketës së re fiskale; dërgimi i PF në komisionin e këshillit; dhe dërgimi në Këshillin Bashkiak për miratimin e PF.

#### Gjurma e Auditit për Borxhin Tatimor

Referuar Urdhrit Nr. 38, datë 22.02.2018, nr. 821 prot., òPër miratimin e dokumentave të gjurmës së auditit sipas manualit të MFKò, gjurma e auditit për borxhin tatimor është e miratuar nga Kryetari i Bashkisë Mirditë dhe hartimi i dokumentit është kryer nga Drejtoria e të ardhurave, taksave, tregut, transportit dhe aseteve. Në këtë dokument përshkruhen si vijon, ekstrakti i regjistrit për të dhënat e subjektit shpk; njoftimi i detyrimit të vitit; fatura për arkëtim; refuzimi ose ankimimi; letër kujtese; njoftim dhe kërkesë për tu paguar; urdhër bllokimi të llogarive bankare për subjektin; urdhër ekzekutimi detyrimi; urdhër për zhbllokim të llogarive bankare; vendosje barre hipotekore; masa e sigurimit detyrimi tatimor; sekuestrimi i pasurive; transferimi i detyrimit tatimor palës së tretë; e drejta për të kërkuar detyrimet nga pala e tretë; dhe përgjegjësia e administratorit.

#### Gjurma e Auditit për Paketën Fiskale

Referuar Urdhrit Nr. 38, datë 22.02.2018, nr. 821 prot., òPër miratimin e dokumentave të gjurmës së auditit sipas manualit të MFKò, gjurma e auditit për paketën fiskale është e miratuar nga Kryetari i Bashkisë Mirditë dhe hartimi i dokumentit është kryer nga Drejtoria e të ardhurave, taksave, tregut, transportit dhe aseteve. Në këtë dokument përmenden pikat si vijon, kërkesa për shqyrtim dhe miratim projekt vendimi; projekt vendim për miratimin e treguesve fiskalë; ftesë për dëgjesë publike; informacione nga ASHSAK Mirditë; informacion për tarifën e shërbimeve publike; informacion nga drejtoria e pyjeve në email; vendimi i Këshillit të Bashkisë Mirditë për Miratimin e treguesve fiskalë; urdhër për krijim komisioni; komisioni ekonomik i këshillit; informacione nga të gjitha drejtoritë; dhe organizimi i dëgjesave dhe protokollimi i tyre.

#### Gjurma e Auditit për dhënie licence karburante

Referuar Urdhrit Nr. 38, datë 22.02.2018, nr. 821 prot., òPër miratimin e dokumentave të gjurmës së auditit sipas manualit të MFKò, gjurma e auditit për dhënien e licencës për karburante është e miratuar nga Kryetari i Bashkisë Mirditë dhe hartimi i dokumentit është kryer nga Drejtoria e të ardhurave, taksave, tregut, transportit dhe aseteve. Në këtë dokument përmenden pikat si vijon, kërkesa për marrje licence; ekstrakti i regjistrit tregtar për të dhënat e subjektit shpk; licencë për veprimtari që kanë ndikim në mjedis; certifikatë pronësie; kontratë shit-blerje; vendim për miratim të deklaratës për kryerje punimesh; leje mjedisore e tipit C; leje ndërtime; harta treguese; dhe miratim autorizimi.

#### Gjurma e Auditit për leje transporti

Referuar Urdhrit Nr. 38, datë 22.02.2018, nr. 821 prot., òPër miratimin e dokumentave të gjurmës së auditit sipas manualit të MFKò, gjurma e auditit për leje transporti është e miratuar



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport auditimi mbi auditimin e ushtruar në Bashkinë Mirditë me objekt “Auditim financiar”

nga Kryetari i Bashkisë Mirditë dhe hartimi i dokumentit është kryer nga Drejtoria e të ardhurave, taksave, tregut, transportit dhe asetëve. Në këtë dokument përmenden pikat si vijon, kërkesë për aplikim; leja e qarkullimit; ekstrakti i QKB; vërtetim për shlyerje të detyrimeve tatimore nga DRT Lezhë; vërtetim për shlyerje taksash lokale; dokumenti që vërteton pagesën; dhe miratimi i lejes së transportit.

Plani i punës, për vitin 2019, nr. 171 prot., datë 15.01.2019; për vitin 2020, nr. 330 prot., datë 27.01.2020; për vitin 2021, nr. 707 prot., datë 14.01.2021, miratuar nga Kryetari i Bashkisë Mirditë, përgjithësisht paraqet disa nga detyrat kryesore që parashikon të kryejë Drejtoria e Financës brenda këtij viti. Plani është i hartuar në mënyrë të tillë që, paraqet edhe një afat brenda të cilit duhet të realizohen këto detyra, duke u mbështetur edhe në bazën ligjore përkatëse.

Strategjia e Menaxhimit të Riskut për vitet 2019 ó 2021 është hartuar për një periudhë tre-vjeçare duke filluar nga viti 2019 deri në vitin 2021. Është e mbështetur në bazën ligjore specifike dhe është miratuar nga Kryetari i Bashkisë. Në përmbajtje të saj përshkruhen pikat kryesore mbi të cilat është menduar të organizohet i gjithë procesi i menaxhimit të riskut.

Informacioni dhe komunikimi: (Në zbatim të kërkesave të nenin 23, ligji nr. 10296, datë 8.07.2010) Informimi dhe komunikimi, realizohet sipas shkallës së strukturave, bazuar në rregulloren e funksionimit të brendshëm dhe kodin e etikës.

Bazuar në pikën 12.3 të Rregullores së Brendshme, komunikimi i brendshëm në Bashkinë e Mirditës realizohet në mënyrë shkresore, verbale dhe nëpërmjet rrjetit të brendshëm elektronik (internetit). Komunikimi dhe shkëmbimi elektronik i dokumenteve zyrtare brenda Bashkisë apo jashtë saj nga nëpunësit dhe punonjësit e saj bëhet gjithmonë duke përdorur postën elektronike (e-mail).

Në zbatim të kërkesave të nenin 24, ligji nr. 10296, datë 8.07.2010 monitorimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit në përgjithësi, realizohet nëpërmjet organizimit të grupeve të punës ose komisionet përkatëse. Një formë e monitorimit, është deklarata e vetëvlerësimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm.

#### **2.2.1.Vlerësimi i auditimit të brendshëm.**

Në zbatim të pikës 1 të programit të auditimit nr. 52/1 datë 18/01/2022, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Plani Strategjik i vitit 2019 ó 2021, etj, dhe pasqyrat shoqëruese;
- Planifikimi vjetor për vitin 2019, 2020 dhe 2021 dhe pasqyrat shoqëruese;
- Programimi i auditimeve të brendshme për vitin 2019, 2020 dhe 2021;
- Raportimi vjetor në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditit të Brendshëm për vitin 2019, 2020 dhe 2021 së bashku me pasqyrat shoqëruese;
- Dosjet e auditimit të njësive publike, (koherente);
- Dosjet e përhershme të subjekteve të audituar;
- Projekt - raportet dhe raportet përfundimtare të auditimit të brendshëm të njësive publike; për vitin, 2019, 2020 dhe 2021;
- Raport mbi zbatimin e masave të rekomanduara nga Njësia e Auditit të Brendshëm;
- Programi për Sigurimin e Cilësisë;
- Pyetëtori bashkëlidhur.





## KONTROLLI I LARTË I SHETIT

### Raport auditimi mbi auditimin e ushtruar në Bashkinë Mirditë me objekt “Auditim financiar”

Bashkia Mirditë ka parashikuar në strukturën e saj shërbimin e Auditit të Brendshëm. Për vitin 2019 është miratuar me Urdhër Nr. 14, datë 16.01.2019, nr. 174 prot., datë 16.01.2019, për vitin 2020 është miratuar me Urdhër Nr. 38, datë 17.02.2020, nr. 625 prot., datë 17.02.2020, për vitin 2021 është miratuar me Urdhër Nr. 20, datë 25.01.2021, nr. 389 prot., datë 25.01.2021. Detyra e kësaj strukture është të programojë, organizojë dhe kryejë auditime të brendshme me miratim të Kryetarit të Bashkisë në strukturat e varësisë së drejtpërdrejtë të Bashkisë Mirditë, për të konstatuar dhe evidentuar shkallën e zbatimit të dispozitave ligjore në fuqi, bazuar në Manualin e Procedurave të Auditimit të Brendshëm Publik.

Në bazë të VKM nr.83, datë 03.02.2016 òPër miratimin e kriterëve të krijimit të Njësive të Auditit të Brendshëm në Sektorin Publikò, është krijuar njësia e auditimit të brendshëm, e cila është e organizuar në nivelin e Sektorit të Auditimit të Brendshëm duke përmbushur detyrimin ligjor të pavarësisë, i parashikuar nga Standardi Atributiv nr.1100, i Institutit Ndërkombëtar të Auditëve të Brendshëm.

Kapaciteti auditues i strukturës së Njesisë së Auditit të Brendshëm të Bashkisë Mirditë, është në bazë të VKM nr.83, datë 03.02.2016 òPër miratimin e kriterëve të krijimit të Njësive të Auditit të Brendshëm në Sektorin Publikò, i ndryshuar.

Njësia e Auditit të Brendshëm që nga periudha 2019 ka funksionuar me 1 (një) Përgjegjës njësie dhe 2 (dy) Specialistë, sipas strukturës organizative të miratuar nga Kryetari i Bashkisë Mirditë. Po kështu ka qenë struktura edhe për vitet 2020 dhe 2021. Ku përgjegjës i NJAB është emëruar Znj. V. Gj., e cila ka qenë në këtë pozicion nga data 25.04.2017 deri në datë 30.06.2021 dhe 2 (dy) specialistët janë, z.G. M. dhe znj. A. M.

Pas datës 30.06.2021, të largimit znj. V. Gj., e cila deri në këtë datë ka qenë në pozicionin e përgjegjesit të Njesisë së Auditimit të Brendshëm, NJAB funksionon me Përgjegjës të komanduar, me Urdhër nr.4909 prot., datë 26.11.2021 z. G. M.

Përbërja e sektorit NJAB, për vitet objekt auditimi paraqitet si më poshtë:

#### Viti 2019

Nr.	Nga data e krijimit më 03.04.2017. deri më 31.12.2019	Funksioni	Arsimimi	Vjetërsia në punë	Vjetërsia në auditim	Certifikimi	Trajnime të vijueshme	Shënime
1	V. Gj. 25.04.2017	Përgjegjëse	I lartë ekonomik	21	2vite 8 muaj	06.07.2018	40 orë cdo vit	
2	L. Ll. 18.04.2017	specialiste	I lartë ekonomik	25	2vite 8 muaj	Qershor 2008	40 orë cdo vit	Larguar me 31.12.2018
3	A. M. 12.04.2017	specialist	I lartë ekonomik	6	2vite 7 muaj	05.07.2019	40 orë cdo vit	

#### Viti 2020



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport auditimi mbi auditimin e ushtruar në Bashkinë Mirditë me objekt “Auditim financiar”

Nr.	Nga 01.01.2020 deri më 31.12.2020	Funksioni	Arsimimi	Vjetërsia në punë	Vjetërsia në auditim	Certifikimi	Trajnime të vijueshme	Shënime
1	V. Gj.	Përgjegjëse	I lartë ekonomik	22	3 vite 8 muaj	06.07.2018	40 orë çdo vit	
2	A.M.	specialiste	I lartë ekonomik	7	3 vite 8 muaj	06.07.2018	40 orë çdo vit	
3	G.M.	specialist	I lartë ekonomik	8	3 vite 4 muaj	05.07.2019	40 orë çdo vit	

### Viti 2021

Nr.	Nga data 01.01.2021 deri 31.12.2021	Funksioni	Arsimimi	Vjetërsia në punë	Vjetërsia në auditim	Certifikimi	Trajnime të vijueshme	Shënime
1	V.Gj.	Përgjegjëse Larguar më.30.06.2021	I lartë ekonomik	23	4 vite 3 muaj	06.07.2018	40 orë çdo vit	Larguar më.30.06.2021 Zv/kryetare
2	A.M.	specialiste	I lartë ekonomik	8	4 vite 8 muaj	06.07.2018	40 orë çdo vit	
3	G.M.	specialist	I lartë juridik	9	4 vite 4 muaj	05.07.2019	40 orë çdo vit	
4	Gj.N.	Specialist	I lartë ekonomik	25	-----		-----	24.11.2021 fillon specialist

**Karta e Auditimit** është përgatitur nga Drejtuesi i njësisë së Auditit të Brendshëm dhe miratuar tek titullari i Bashkisë Mirditë, me shkresën nr.4191 prot., datë 20.09.2017, dërguar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me shkresë përcjellëse nr.4515 prot., datë 11.10.2017, ndryshuar me shkresën nr.1848 prot., datë 23.06.2020, bazuar në Urdhër Nr. 4, datë 10.01.2020, për disa shtesa dhe ndryshime në përputhje me MAB.

**Plani Strategjik dhe vjetor për vitin 2019** është përgatitur dhe dërguar 2 (dy) ditë pas afatit të përcaktuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm për vitet 2019 ó 2021, me shkresën nr. 4610 prot., datë 22.10.2018, përpiluar në përputhje me standardin e përcaktuar në Manualin e Auditimit të Brendshëm, Kapitulli III, pika 3.1.6 dhe pika 3.3.

Bazuar në pasqyrën nr.2, për vitin 2019 janë planifikuar 9 (nëntë) angazhime auditimi, nga të cilat 6 (gjashtë) përputhshmërie dhe 3 (tre) të kombinuara. Por bazuar në Urdhër Nr. 244, datë 26.08.2019, Nr. 3397 prot., datë 26.08.2019, për ndryshime të Programit Vjetor të Angazhimeve të Auditimit të Brendshëm për vitin 2019, ku te ky i fundit është përcaktuar që do kryehen gjithsej 7 (shtatë) auditime, nga të cilat 4 (katër) përputhshmërie dhe 3 (tre) të kombinuara.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport auditimi mbi auditimin e ushtruar në Bashkinë Mirditë me objekt “Auditim financiar”

Plani Vjetor i dërguar brenda afatit në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm, në përputhje me standardin e përcaktuar në Manualin e Auditimit të Brendshëm, Kapitulli III, pika 3.2. Shkresa nr. 3398 prot., datë 26.8.2019, Dërgesë e Planit Vjetor të Auditimit për vitin 2019, të ndryshuar. Arsyet e ndryshimit për Planin Vjetor të Angazhimeve të Auditimit të Brendshëm për vitin 2019, i referohen urdhrin të dhënë nga Kryetari i Bashkisë Mirditë, për auditime jashtë planit vjetor të miratuar dhe ndryshime në organikën e sektorit të auditimit për vitin 2019, të paraqitur në pasqyrën nr.3, të ndryshuar.

**Plani Strategjik dhe vjetor për 2020** është përgatitur dhe dërguar 5 (pesë) ditë pas afatit të përcaktuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm për vitet 2020 ó 2022, me shkresën nr. 4351 prot., datë 25.10.2019, përpiluar në përputhje me standardin e përcaktuar në Manualin e Auditimit të Brendshëm, Kapitulli III, pika 3.1.6 dhe pika 3.3.

Bazuar në pasqyrën nr.2, për vitin 2020 janë planifikuar 7 (shtatë) angazhime auditimi, ku 5 (pesë) janë përputhshmërie dhe 2 (dy) të kombinuar. Por bazuar në Urdhër Nr. 276, datë 11.12.2020, me Nr. 5032 prot., datë 11.12.2020, për ndryshime në planin vjetor të angazhimeve të auditimit për vitin 2020. Ku te ky i fundit është përcaktuar që do kryhen gjithsej 6 (gjashtë) auditime, nga të cilat 5 (pesë) përputhshmërie dhe 1 (një) i kombinuar.

Plani Vjetor i dërguar në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm. Shkresa përcjellëse për ndryshimin e planit vjetor të angazhimeve të auditimit, me Nr. 5032/1 prot., datë 11.12.2020, bazuar në Urdhër Nr. 276, datë 11.12.2020, me Nr. 5032 prot., datë 11.12.2020, për miratimin e Programit të angazhimeve të Auditimit të Brendshëm për vitin 2020, të ndryshuar. Shkresë nr. 5032/2 prot., datë 11.12.2020, Relacion Shpjegues mbi ndryshimin e Planit Vjetor të Auditimit për vitin 2020. Si arsye kryesore për ndryshimin e Planit Vjetor të angazhimit të auditimit për vitin 2020, paraqitet ndikimi i pandemisë COVID ó 19. Referuar këtij fakti, NJAB Bashkia Mirditë, ka punuar me orare të reduktuara dhe on-line dhe nuk ka qenë i mundur kontakti me palët e planifikuara për t'u audituar, si rrjedhojë kjo ka pasur ndikim në mosrealizimin e plotë të angazhimit të auditimit për vitin 2020.

**Plani Strategjik dhe vjetor për 2021** është përgatitur dhe dërguar në afat në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm për vitet 2021 ó 2023, me shkresën nr. 3481 prot., datë 13.10.2020, përpiluar në përputhje me standardin e përcaktuar në Manualin e Auditimit të Brendshëm, Kapitulli III, pika 3.1.6 dhe pika 3.3.

Referuar shkresës me Nr. 3481/1 prot., datë 13.10.2020, rezulton se nga plani i auditimeve për vitin 2021, janë planifikuar 10 (dhjetë) subjekte për tu audituar, 8 (tetë) përputhshmërie dhe 2 (dy) financiare; 11 (njëmbëdhjetë) subjekte për vitin 2022; dhe 12 (dymbëdhjetë) subjekte për vitin 2023.

Plan Vjetor i vitit 2021, me kërkesë të sektorit të auditit të brendshëm në Bashkinë Mirditë, është dërguar me ndryshimet përkatëse në datë 10.02.2021 pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm në MFE. Shkresë përcjellëse Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, me Nr. 637 prot., datë 10.02.2021, bashkangjitur Urdhëri Nr. 39, Nr. 6371/1 prot., datë 10.02.2021, për ndryshimin e planit vjetor të angazhimeve të auditimit për vitin 2021, bashkangjitur relacion shpjegues 6371/2 prot., datë 10.02.2021, ku janë planifikuar 10 (dhjetë) subjekte për tu audituar, 8 (tetë) përputhshmërie, 1 (një) financiar dhe 1 (një) për shërbimet e konsulencës. Arsyet e ndryshimit të planit vjetor të auditimit për vitin 2021, i referohen urdhrin të



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport auditimi mbi auditimin e ushtruar në Bashkinë Mirditë me objekt “Auditim financiar”

dhënë nga Kryetari i Bashkisë Mirditë për auditime jashtë planit vjetor të miratuar, mbështetur kjo në pasqyrën nr.3 të ndryshuar.

**Programi i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë të NJ.A.B Mirditë për vitin 2019**, shkresë përcjellëse me Nr. 123 prot., datë 11.01.2019, drejtuar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë ó Njësisë Qendrore të Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm. Programi për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë së NJ.A.B të Bashkisë Mirditë është miratuar nga Kryetari i Bashkisë Mirditë, nr.123 prot. datë 11.01.2019.

**Programi i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë të NJ.A.B Mirditë për vitin 2020**, nuk është hartuar dhe si rrjedhim nuk figuron si dokument në Bashkinë Mirditë. Gjatë fazës së terrenit të grupit të auditimit si dhe gjatë intervistave të zhvilluara me personat përgjegjës për dërgimin e materialit, është reflektuar dhe është dërguar pranë Njësisë Qendrore të Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm me shkresën nr. 903 prot., datë 22.02.2022. Programi për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë së NJ.A.B të Bashkisë Mirditë është miratuar nga Kryetari i Bashkisë Mirditë, nr.903/1 prot. datë 22.02.2022.

Në intervistën e zhvilluar me znj. V. Gj., për periudhën takuese si përgjegjëse e NJAB, lidhur me mangësinë e sipërcituar, u argumentua nga ana e saj se për shkak të mos pasjes së ndryshimeve në Programin e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë të vitit 2019, është konsideruar i mirëqenë efekti i dokumentacionit óProgrami i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë të NJ.A.B Mirditëó për vitin 2019, shkresë përcjellëse me Nr. 123 prot., datë 11.01.2019, edhe për vitet në vazhdim.

**Regjistri i Riskut.** NJAB e Bashkisë Mirditë ka përgatitur Regjistrin e riskut në funksion të objektivave institucional, miratuar nga Titullari i Bashkisë Mirditë.

Dosjet e auditimeve të NJAB: Sipas Planit Strategjik të periudhës 2019 ó 2021, 2020 ó 2022, 2021 ó 2023, i nënshtrohen auditimit të plotë:

Për vitin 2019, i janë nënshtruar procesit të auditimit Agjencia e Punëve Publike, Njësia Administrative Fan, Agjencia e Shërbimeve Bujqësore, Veterinare dhe Pyjeve, (Sektori i Monitorimit dhe Shërbimit Pyjor; Sektori i Shërbimit Veterinar, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit), Inspektoriat Vendor i Mbrojtjes së Territorit, Ujësjetës Kanalizime sh.a Mirditë. Për vitin 2020, i janë nënshtruar procesit të auditimit Agjencia e Shërbimeve Sociale, Arsimit dhe Kulturës Mirditë, konkretisht Sektori i Ndhmës Ekonomike dhe të Drejtave Sociale, Sektori i Bibliotekës, Sektori i Muzeut, Sektori i Turizmit; Auditimi te Njësia Administrative Orosh; Auditimi te Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, konkretisht Sektori i Buxhetit Mirditë.

Për vitin 2021, i janë nënshtruar procesit të auditimit Ujësjetës Kanalizime sh.a Mirditë; Auditimi tematik mbi veprimtarinë dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm të bashkisë te Drejtoritë dhe Njësitë Administrative të Bashkisë Mirditë; Auditimi te Agjencia e Inspektimit, Kontrollit dhe Emergjencave në Bashkinë Mirditë; Auditimi te Njësia Administrative Rubik; Auditimi i Procedurës së Prokurimit óBlerje makine teknologjike për shërbimin e pastrimit dhe kosha për grumbullimin e mbeturinave për Bashkinë Mirditëó; Auditimi te Agjencia e Punëve Publike dhe Mirëmbajtjes në Bashkinë Mirditë.

Nga auditimi i dokumentacionit të dosjeve të përzgjedhura për vitet 2019, 2020 dhe 2021, u konstatua se përgjithësisht janë zbatuar kërkesat e ligjit nr.114/2015 óPër auditimin e brendshëm në sektorin publik, bazuar edhe te óManuali i Auditimit të Brendshëmó (MAB).

Nga auditimi i projekt - raportit dhe raportit përfundimtar, rezulton se në procesin e auditimit në përgjithësi, nga audituesit e brendshëm, janë zbatuar standardet e përcaktuara në MAB, në përmbajtje dhe në formë.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport auditimi mbi auditimin e ushtruar në Bashkinë Mirditë me objekt “Auditim financiar”

Vlerësojmë se sipas përcaktimeve të bëra në Manualin e Auditimit të Brendshëm, (Kapitulli VI, Evidentimi dhe dokumentimi i punës audituese, në përgjithësi programet kanë përmbledhur orientimet kryesore të veprimit në përputhje me risqet dhe problematikat e subjekteve dhe përmbajnë në mënyrë të qartë emërtimin e subjektit, llojin e auditimit, periudhën dhe afatin e auditimit, drejtimet që do të ndiqen, dhe grupin e auditimit. Gjithashtu referencat ligjore të vëna në programet e auditimit reflektojnë kuadrin ligjor në fuqi.

Në dosjet e auditimit të vitit 2019, dokumentacioni në dosje ka qenë specifikisht si vijon:

-Në rastin e auditimit Agjencia e Shërbimeve Bujqësore, Veterinare dhe Pyjeve, (Sektori i Monitorimit dhe Shërbimit Pyjor; Sektori i Shërbimit Veterinar , Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit), dosja përmban projekt ó axhenda, autorizimi për fillimin dhe përgatitjen e angazhimit për auditim, njoftim për fillimin e angazhimit të auditimit, programi i angazhimit të auditimit, vlerësimi i riskut, deklarata e konfliktit të interesit, memo, plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve, proces ó verbal takimi fillestar, proces ó verbal takimi përfundimtar, projekt ó raporti dhe raporti përfundimtar.

-Në rastin e auditimit Ujësjetës Kanalizime sh.a Mirditë, dosja përmban autorizimi për fillimin dhe përgatitjen e angazhimit për auditim, projekt ó axhenda, njoftim për fillimin e angazhimit të auditimit, programi i angazhimit të auditimit, deklarata e konfliktit të interesit, memo, observacione nga UK sh.a Mirditë, proces ó verbal takimi fillestar, proces ó verbal takimi përfundimtar, projekt ó raporti dhe raporti përfundimtar.

-Në rastin e auditimit Njësia Administrative Fan, dosja përmban autorizimi për fillimin dhe përgatitjen e angazhimit për auditim, deklarata e konfliktit të interesit, njoftim për fillimin e angazhimit të auditimit, projekt ó axhenda, vlerësimi i riskut, programi i angazhimit të auditimit, memo, proces ó verbal takimi fillestar, proces ó verbal takimi përfundimtar, projekt ó raporti dhe raporti përfundimtar.

-Në rastin e auditimit Inspektoriati Vendor i Mbrojtjes së Territorit, dosja përmban autorizimi për fillimin dhe përgatitjen e angazhimit për auditim, njoftim për fillimin e angazhimit të auditimit, programi i angazhimit të auditimit, vlerësimi i riskut, projekt ó axhenda, deklarata e konfliktit të interesit, proces ó verbal takimi fillestar, proces ó verbal takimi përfundimtar, projekt ó raporti, plani i veprimit për rekomandimet, memo, raporti përfundimtar.

-Në rastin e auditimit Agjencia e Punëve Publike, dosja përmban autorizimi për fillimin dhe përgatitjen e angazhimit për auditim, njoftim për fillimin e angazhimit të auditimit, programi i angazhimit të auditimit, vlerësimi i riskut, projekt ó axhenda, deklarata e konfliktit të interesit, proces ó verbal takimi fillestar, proces ó verbal takimi përfundimtar, projekt ó raporti, plani i veprimit për rekomandimet, memo dhe raporti përfundimtar.

Në dosjet e auditimit të vitit 2020, dokumentacioni në dosje ka qenë specifikisht si vijon:

-Në rastin e auditimit Njësia Administrative Orosh, dosja përmban autorizimi për fillimin dhe përgatitjen e angazhimit për auditim, njoftim për fillimin e angazhimit të auditimit, programi i angazhimit të auditimit, vlerësimi i riskut, projekt ó axhenda, deklarata e konfliktit të interesit, proces ó verbal takimi fillestar, proces ó verbal takimi përfundimtar, projekt ó raporti, plani i veprimit për rekomandimet, memo dhe raporti përfundimtar.



## **KONTROLLI I LARTË I SHETIT**

### **Raport auditimi mbi auditimin e ushtruar në Bashkinë Mirditë me objekt “Auditim financiar”**

-Në rastin e auditimit Drejtoria e Financës (Sektori i Buxhetit) Bashkia Mirditë, dosja përmban autorizimi për fillimin dhe përgatitjen e angazhimit për auditim, njoftim për fillimin e angazhimit të auditimit, programi i angazhimit të auditimit, vlerësimi i riskut, projekt ó axhenda, deklarata e konfliktit të interesit, proces ó verbal takimi fillestar, proces ó verbal takimi përfundimtar, projekt ó raporti, memo dhe raporti përfundimtar.

-Në rastin e auditimit Agjencia e Shërbimeve Sociale, Arsimit dhe Kulturës, dosja përmban autorizimi për fillimin dhe përgatitjen e angazhimit për auditim, njoftim për fillimin e angazhimit të auditimit, programi i angazhimit të auditimit, vlerësimi i riskut, projekt ó axhenda, deklarata e konfliktit të interesit, plan veprimi për rekomandimet, proces ó verbal takimi fillestar, proces ó verbal takimi përfundimtar, projekt ó raporti, memo dhe raporti përfundimtar.

Në dosjet e auditimit të vitit 2021, dokumentacioni në dosje ka qenë specifikisht si vijon;

- Në rastin e auditimit të Njësisë Administrative Rubik mungojnë disa dokumenta sepse është nënshtruar auditim tematik në NJA Rubik referuar problematikës që administratori i kësaj njësie ka propozuar me shkresën nr.509 prot., datë 05.08.2021. Në këtë dosje gjenden dokumentat si: raporti përfundimtar, programi i angazhimit të auditimit dhe urdhëri për përgatitjen e rekomandimeve përkatëse për gjetjet e konstatuara gjatë auditimit.

-Në rastin e auditimit të Procedurës së Prokurimit òBlerje makine teknologjike për shërbimin e pastrimit dhe kosha për grumbullimin e mbeturinave për Bashkinë Mirditë, në dosje gjenden dokumentat si: deklarata për konfliktin e interesit, urdhër për auditimin e procedurës, urdhër për marrjen në dorëzim të automjetit, procesverbal për marrjen në dorëzim të automjetit dhe raporti përfundimtar.

-Në rastin e auditimit të Agjencia e Punëve Publike dhe Mirëmbajtjes, në dosje gjenden dokumentat si: autorizimin për fillimin dhe përgatitjen e angazhimit për auditim, njoftimi për fillimin e angazhimit për auditim, programi i angazhimit të auditimit, projekt ó axhenda, proces ó verbal takimi përfundimtar, projekt ó raporti, raporti përfundimtar.

-Në rastin e auditimit të Agjencisë së Inspektimit Kontrollit dhe Emergjencave, në dosje gjenden dokumentat si: autorizimi për fillimin dhe përgatitjen e angazhimit për auditim, projekt ó axhenda, deklarata e konfliktit të interesit, vlerësimi i riskut, memo, plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve, proces ó verbal takimi përfundimtar, projekt ó raporti dhe raporti përfundimtar.

-Në rastin e auditimit tematik në Bashkinë Mirditë, në dosje gjenden dokumentat si: autorizim për fillimin dhe përgatitjen e angazhimit për auditim, deklarata e konfliktit të interesit, vlerësimi i riskut, memo, raporti përfundimtar dhe pyetësorët mbi zbatimin e rregullores së Bashkisë Mirditë të plotësuar nga Njësitë Administrative Orosh, Selitë, Kthellë, Rubik, Fan, Kaçinar, Rrëshen.

-Në rastin e auditimit të Verifikimit të Zbatimit të Rekomandimeve kundrejt Bashkisë Mirditë, në dosje gjenden dokumentat si: autorizim për kryerjen e auditimit për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve, programi i angazhimit të auditimit për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve, plan veprimi nga subjekti i audituar (Ujësjetllës Kanalizime sh.a Mirditë) mbi rekomandimet e lëna nga auditimi i kryer, vlerësimi i riskut, deklarata e konfliktit të interesit, raport mbi zbatimin e rekomandimeve (shkresë përcjellëse MFE), informacion mbi rekomandimet e raportit përfundimtar (UK sh.a; Agjencia e Shërbimeve Sociale, Arsimit dhe Kulturës; Njësia Administrative Orosh), autorizim òPër kryerjen e auditimit për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport auditimi mbi auditimin e ushtruar në Bashkinë Mirditë me objekt “Auditim financiar”

**Vlerësimi i Brendshëm i Cilësisë dhe Sigurimi i Cilësisë** gjatë vetëvlerësimit periodik për auditimet e vitit 2019, është përgatitur sipas formatit që specifikohet te Manuali i Auditimit të Brendshëm në pikën 7.1.1.

Rishikimi i Cilësisë për angazhimin e auditimit të brendshëm është realizuar për Ujësjetllës Kanalizime sh.a.; Inspektoriat Vendor i Mbrojtjes së Territorit; Agjencia e Punëve Publike dhe e Mirëmbajtjes; Njësia Administrative Fan; Sektori i Shërbimit Veterinar, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Sektori i Monitorimit dhe Shërbimit Pyjor.

**Titulli i gjetjes 1:** Mungesa e Vlerësimit të Brendshëm të Cilësisë, Sigurimit të Cilësisë dhe Rishikimit të cilësisë, për angazhimin e auditimit të brendshëm për vitet 2020 dhe 2021

**Situata:** Në dosjen e auditimit të brendshëm për vitet 2020 dhe 2021, mungonin: Vlerësimi i Brendshëm i Cilësisë, Sigurimi i Cilësisë gjatë vetëvlerësimit periodik dhe Rishikimi i cilësisë.

**Kriteri:** Ky veprim është në kundërshtim me Manualin e Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik, kapitulli VII, pika 7.1.1 e manualit cilëson se, Vlerësimi i brendshëm i cilësisë, që kryhet nga vetë Njësia e Auditimit të Brendshëm, ku cilësohet se:

Përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë të veprimtarisë së auditimit të brendshëm fillon me vlerësimet e brendshme të cilësisë me përcaktimin nëse politikat dhe procedurat e aplikueshme janë krijuar dhe zbatuar për vlerësimin e përputhshmërisë me standardet dhe kodin e etikës.

**Ndikimi/Efekti:** Mospërgatitja e Vlerësimit të Brendshëm të Cilësisë, Sigurimit të Cilësisë dhe Rishikimit të cilësisë, për angazhimin e auditimit të brendshëm për scilin nga angazhimet e auditimit, për një periudhë 2 (dy) vjeçare, ndikon në vështirësinë e njësive së auditit të brendshëm për të: monitoruar në mënyrë të vazhdueshme performancën e veprimtarisë së auditimit të brendshëm; realizuar vetëvlerësimin periodik lidhur me përputhshmërinë e parimeve bazë të Strukturës Ndërkombëtare për Praktikën Profesionale (IPPF) të auditimit të brendshëm; studiuar subjektin e audituar.

**Shkaku:** Neglizhenca e hartimit dhe realizimit të dokumentacioneve të përmendura më lart për çdo auditim, në mënyrë që procesi i angazhimit të auditimit të jetë i kompletuar.

**Rëndësia:** E ulët

**Rekomandime:** Njësia e Auditit të Brendshëm në Bashkinë Mirditë të marri masa që të hartojë dhe realizojë në mënyrë të detajuar, të gjitha dokumentat që kanë lidhje direkte me auditimin, me qëllim që të lejojnë vazhdimësi të procesit.

**Raporti i Veprimtarisë të Njësive së Auditimit të Brendshëm** për vitin 2019, është përgatitur dhe dërguar në afat në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm për vitin 2019, me shkresën nr. 516 prot., datë 07.02.2020; Raporti i Veprimtarisë të Njësive së Auditimit të Brendshëm për vitin 2020, është përgatitur dhe dërguar në afat në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm për vitin 2020, me shkresën nr. 499 prot., datë 01.02.2021; Raporti i Veprimtarisë të Njësive së Auditimit të Brendshëm për vitin 2021, është përgatitur dhe dërguar në afat në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm për vitin 2021, me shkresën nr.656 prot., datë 08.02.2022. Të gjitha raportet janë në përputhje me Kapitullin IV të Manualit të Auditimit të Brendshëm, të miratuar me urdhër të Ministrit të Financave nr.100, datë 25.10.2016, i ndryshuar.

Raport i veprimtarisë së Njësive së Auditimit të Brendshëm, për vitet 2019, 2020 dhe 2021, përmban të dhëna për secilin nga vitet e përmendura më lart lidhur me, Burimet Njerëzore



## KONTROLLI I LARTË I SHPETIT

### Raport auditimi mbi auditimin e ushtruar në Bashkinë Mirditë me objekt “Auditim financiar”

(pasqyra nr.1); Realizimi i planit të angazhimeve (pasqyra nr.2); Përmbledhje e gjetjeve me dëm ekonomik nga angazhimet e auditimit (pasqyra nr.3); Përmbledhje e parregullive të identifikuar sipas sistemeve (pasqyra nr.4); Rekomandimet e dhëna sipas kategorive (pasqyra n. 5); Çështje të dërguara për investigim (pasqyra nr. 6); Pyetëtori i vetëvlerësimit për auditimin e brendshëm; Raport shpjegues.

Viti 2019: Bazuar në pasqyrën nr.2, për vitin 2019 janë realizuar 6 (gjashtë) angazhime auditimi, nga të cilat 6 (gjashtë) përputhshmërie. Por bazuar në Urdhër Nr. 244, datë 26.08.2019, Nr. 3397 prot., datë 26.08.2019, për ndryshime të Programit Vjetor të Angazhimeve të Auditimit të Brendshëm për vitin 2019, te ky i fundit ishte përcaktuar se do të kryheshin gjithsej 7 (shtatë) auditime, nga të cilat 4 (katër) përputhshmërie dhe 3 (tre) të kombinuara. Referuar pasqyrës nr. 3 nuk ka gjetje me dëm ekonomik.

Referuar pasqyrës nr. 4, gjetjet sipas fushës ose sistemeve janë 4 (katër), te Sistemi i Prokurimeve, Blerjeve dhe Investimeve; 2 (dy) te Sistemet e Tatimeve, Taksave dhe Doganave; 30 (tridhjetë) te Sistemet e Administrimit të Pronës dhe Pasurisë dhe 1 (një) te kategoria Të tjera. Gjithsej 37 gjetje të parregullive, të konstatuara gjatë auditimit të brendshëm të vitit 2019. Referuar pasqyrës nr. 5, rekomandime 38 gjithsej, të zbatuara 23 (njëzet e tre), ndërsa 15 (pesëmbëdhjetë) rekomandime janë në proces zbatimi. Referuar pasqyrës nr. 6, çështje të dërguara për investigim për vitin 2019, nuk ka.

Viti 2020: Bazuar në pasqyrën nr.2, për vitin 2020 janë realizuar 6 (gjashtë) angazhime auditimi, nga të cilat 6 (gjashtë) përputhshmërie. Por bazuar në Urdhër Nr. 276, datë 11.12.2020, me Nr. 5032 prot., datë 11.12.2020, për ndryshime në planin vjetor të angazhimeve të auditimit për vitin 2020, ku te ky i fundit ishte përcaktuar se do të kryheshin gjithsej 6 (gjashtë) auditime, nga të cilat 5 (pesë) përputhshmërie dhe 1 (një) i kombinuar. Referuar pasqyrës nr. 3, nuk ka gjetje me dëm ekonomik. Referuar pasqyrës nr. 4, gjetjet sipas fushës ose sistemeve janë, 6 (gjashtë) te Sistemet e Administrimit të Pronës dhe Pasurisë; dhe 2 (dy) te kategoria Të tjera. Gjithsej 8 (tetë) gjetje të parregullive, të konstatuara gjatë auditimit të brendshëm të vitit 2020. Referuar pasqyrës nr. 5, rekomandime 8 (tetë) gjithsej, 8 (tetë) të zbatuara, 0 në proces zbatimi. Referuar pasqyrës nr. 6, çështje të dërguara për investigim për vitin 2020 nuk ka.

Viti 2021: Bazuar në pasqyrën nr.2, për vitin 2021 janë realizuar 6 (gjashtë) angazhime auditimi, nga të cilat 3 (tre) përputhshmërie dhe 3 (tre) angazhime auditimi me kërkesë të titullarit. Por bazuar në Urdhër Nr. 39, Nr. 6371/1 prot., datë 10.02.2021, për ndryshimin e planit vjetor të angazhimeve të auditimit për vitin 2021, bashkangjitur relacion shpjegues 6371/2 prot., datë 10.02.2021, ku te ky i fundit ishte përcaktuar se do të kryheshin gjithsej 10 (dhjetë) auditime, 8 (tetë) përputhshmërie, 1 (një) financiar dhe 1 (një) për shërbimet e konsulencës. Referuar pasqyrës nr. 3, nuk ka gjetje me dëm ekonomik. Referuar pasqyrës nr. 4, gjetjet sipas fushës ose sistemeve janë, 43 (dyzet e tre) gjithsej, të cilat i përkasin të gjitha kategorisë Të tjera. Gjithsej 43 (dyzet e tre) gjetje të parregullive, të konstatuara gjatë auditimit të brendshëm të vitit 2021. Referuar pasqyrës nr. 5, rekomandime 43 (dyzet e tre) gjithsej, 20 (njëzet) të zbatuara dhe 23 (njëzet e tre) në proces zbatimi. Referuar pasqyrës nr. 6, çështje të dërguara për investigim për vitin 2021 nuk ka.

Nga auditimi i dokumentacionit të rekrutimit të punonjësve të Njësisë së Auditimit të Brendshëm në Bashkinë Mirditë, rezulton se:

- Znj. V. Gj., me arsim të lartë, Fakulteti Ekonomi Agrarë, Universiteti Bujqësor i Tiranës, Ekonomist Agrar, me status Auditues i Brendshëm 06.07.2018, nr.regjistri 1956, është emëruar





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport auditimi mbi auditimin e ushtruar në Bashkinë Mirditë me objekt “Auditim financiar”

në detyrën e përgjegjës të auditit të brendshëm në NJAB, në periudhën (25.04.2017 ó 30.06.2021) në Bashkinë Mirditë me Akt Emërimi nr. 1807 prot., datë 25.04.2017, duke qenë i pajisur me certifikatën e audituesit.

- Znj. A.M., me arsim të lartë, MSC profili Ekonomik, me status Auditues i Brendshëm 06.07.2018, nr.regjistri 1917, është emëruar në detyrën e specialist auditit të NJAB 07.03.2019 në Bashkinë Mirditë, me Akt Emërimi nr. 1045 prot., datë 07.03.2019, duke qenë e pajisur me certifikatën e audituesit.
- Z. G. M., me arsim të lartë, profili Jurist, me status Auditues i Brendshëm 05.07.2019, nr.regjistri 1978 është emëruar në detyrën e specialist auditit të NJAB 01.08.2017, në Bashkinë Mirditë me Akt Emërimi nr. 3522 prot., datë 01.08.2017, duke qenë i pajisur me certifikatën e audituesit.
- Z. Gj. N., me arsim të lartë, MSC profili Financë- Kontabilitet, është emëruar në detyrën e specialist auditit të NJAB 24.11.2021, në Bashkinë Mirditë me Akt Emërimi nr. 4619/3 prot., datë 24.11.2021.

Referuar përbërjes së grupit të NJ.A.B për vitin 2021, pas largimit të Përgjegjës të NJ.A.B, znj. V. Gj., referuar Vendim Nr. 38, datë 30.06.2021, nr. 2594/1 prot., datë 30.06.2021 dhe pas emërimit të z. Gj. N., në pozicionin Specialist, datë 24.11.2021, grupi i NJ.A.B funksionon me 3 (tre) anëtarë, ku 2 (dy) janë në pozicionin Specialist, konkretisht Gj. N. dhe A. M., ndërsa G. M. si Përgjegjës i komanduar, bazuar në Urdhër nr.4909 prot., datë 26.11.2021. Referuar këtij urdhëri, theksohet se ky emërim është deri në emërimin e punonjësit të ri pas konkurimit në shërbimin civil për këtë pozicion pune, por jo më shumë së 6 ó muaj.

### **2.2 Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit, bazuar në ligjin organik të buxhetit të shtetit, nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, ligjet vjetore “Për buxhetin e shtetit” të vitit 2020, si dhe aktet nënligjore mbi planifikimin, monitorimin dhe zbatimin e buxhetit**

Për auditimin e planifikimit dhe zbatimin e PBA dhe buxhetit vjetor periudha ushtrimore raportuese *PBA 2019-2021; 2020-2022; 2021-2023 dhe programimi i buxhetit vjetor 2019, 2020, 2021* u mor në shqyrtim dokumentacioni sa më poshtë:

*1-Buxhetimi fondeve publike për shpenzimet e realizuara nga njësia publike vendore bashkia Mirditë në periudhën raportuese ushtrimore viti 2019,2020,2021 i miratuar me VKB përkatëse për secilin vit buxhetimi.;*

*2-Urdhrrat e Titullarit të Bashkisë për ngritje e grupit të punës me specialistë të fushës për përgatitjen e PBA 2019-2021; 2020-2022; 2021-2023 e projektbuxhetet vjetore periudha raportuese viti 2019, 2020, 2021;*

*3-Vendimet e Këshillit Bashkiak në lidhje me miratimin e ndryshimeve të planeve buxhetore.*

*4-Dokumentacioni mbi programimin PBA 2019-2021; 2020-2022; 2021-2023 dhe programimi treguesve të buxhetit vjetor për periudhën raportuese. (Projektbuxhetet e miratuar për periudhë viti (2019, 2020, 2021);*

*5-Dokumentacioni mbi çeljen e fondeve buxhetore të vitit me ndryshimet e planit të buxheti, sipas Akteve Normative të miratuara për periudhën raportuese viti (2019, 2020, 2021).*

*6-Regjistrat e realizimit të shpenzimeve të bazuara në nivelin e fondeve të çelura;*



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport auditimi mbi auditimin e ushtruar në Bashkinë Mirditë me objekt “Auditim financiar”

7-Dokumentacioni saktësisë së realizimit të treguesve buxhetor e pasqyrimi në raporte monitorimi;

8-Dokumentacioni mbi nivelin e faturave të pa likuiduara për (investime, mallra, shërbime, vendime gjyqësore).

9-Regjistrat me nivelin e realizimit të të ardhurave vendore;

10-Faturat e pa likuiduara të shoqëruara me listën analitike, të detajuara me numër fature dhe datë krijimi etj, sipas raportimit në MFE;

11-Situacioni shpenzimeve për periudhën raportuese 2019, 2020, 2021 i rakorduar me Degën e Thesarit Mirditë.

12-Situacioni i të ardhurave për periudhat raportuese 2019, 2020, 2021 të rakorduar me degën e Thesarit.

13-Dokumente të bankës për periudhën raportuese viti (2019, 2020, 2021).

14-Raportet periodike të monitorimit për treguesit të buxhetit vjetor;

### Nënpika (2/1). Programimi i PBA-ve dhe programimi i buxhetit vjetor për vitin 2019, 2020, 2021;

-Nga Kryetari i Bashkisë Mirditë janë ngritur urdhrat e GMS (grupit të menaxhimit strategjik) dhe urdhrat e EMP (ekipet e menaxhimit të programeve).

-Janë miratuar hapat për përgatitjen e kalendarit të PBA-ve 2019 -2021; 2020-2022; 2021-2023 dhe në vijim të kalendarit është proceduar për hartimin e programi buxhetor afatmesëm për njësitë shpenzuese.

-Pas miratimit të kalendarëve për hartimin e dokumenteve të PBA-ve, Kryetari i Bashkisë ka dërguar në Këshillin Bashkiak, për miratim projekt-vendimet e hartuara nga GMS, për tavanet buxhetore sipas programeve.

-Pas daljes së udhëzimit për hartimin e PBA-ve nga MFE, Kryetari i Bashkisë ka miratuar udhëzimin e brendshëm për PBA-të 2019 -2021; 2020-2022; 2021-2023.

**PBA 2019-2021:** Mevendim nr. 36, datë 21.03.2018 janë miratuar tavanet e programeve buxhetore afatmesëm për periudhat (2019-2021), ndërsa struktura buxhetore në (19)programe buxhetimi.

PBA	Urdhratë GMS		Urdhratë EMP		VKB			Nr	shënime
	Nr	Datë	Nr	Datë	Objekti	Nr	Datë	Programe	
2019-2021	348	28.12.2017	65	20.04.2018	miratim kalendar	110	26.12.2017	19	në afat
					miratim tavaneve të shpenzimeve	36	21.03.2018		në afat

Shënim: Të dhënat janë të disponuar nga Drejtoria e Financës me programimet buxhetore

**PBA 2020-2022:** Me vendim nr. 26, datë 22.02.2019 janë miratuar tavanet e programeve buxhetore afatmesëm për periudhat (2020-2022), ndërsa struktura buxhetore në (20)programe buxhetimi.

PBA	Urdhratë GMS		Urdhratë EMP		VKB			Nr	shënime
	Nr	Datë	Nr	Datë	Objekti	Nr	Datë	Programe	



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport auditimi mbi auditimin e ushtruar në Bashkinë Mirditë me objekt "Auditim financiar"

2020-2022	325	03.10.2018	89	01.03.2019	miratim kalendari	4	23.01.2019	20	jashtë afatit duhet brenda dhjetor 2018
					miratim tavaneve të shpenzimeve	26	22.02.2019		në afat
					miratimi i tabelave të PBA	59	22.05.2019		në afat

Shënim: Të dhënat janë të disponuar nga Drejtoria e Financës me programimet buxhetore

**PBA 2021-2023:** Me vendim nr. 39, datë 11.04.2020 janë miratuar tavanet e programeve buxhetore afatmesëm për periudhat (2021-2023), ndërsa struktura buxhetore në (20) programe buxhetimi.

PBA	Urdhurat GMS		Urdhurat EMP		VKB		Nr Programe	shënime	
	Nr	Datë	Nr	Datë	Objekti	Nr			
2021-2023	272	19.09.2019	271	19.09.2021	miratim kalendari	07	28.01.2020	20	jashtë afatit duhet brenda dhjetor 2019
					miratim tavaneve të shpenzimeve	39	10.04.2020		në afat
					miratimi i tabelave të PBA	119	23.12.2020		dok përfundimtar në afat

Shënim: Të dhënat janë të disponuar nga Drejtoria e Financës me programimet buxhetore

Viti i parë i PBA është njëkohësisht edhe vit buxhetor vjetor.

Gjatë hartimit të PBA, 2020-2022, 2021-2023 janë përcaktuar ÷Përshkrimi i çdo programi; ÷Politikat e programit; ÷Qëllimi Politikës së programit; ÷Objektivat e politikës së programit.

### Buxheti i vitit 2019 (në planifikim)

Për hartimin e buxhetit të vitit 2019 është ndjekur baza ligjore përkatëse si dhe udhëzimi plotësues nr. 6/3 datë 10.07.2018 ÷Për përgatitjen e buxhetit vendor 2019.

Është ngritur urdhëri për dëgjesa publike, programi i punës për të 7 (shtatë) njësitë administrative të Bashkisë Mirditë, dhe janë mbajtur proces-verbalet përkatëse për secilën njësi.

Janë miratuar vkb përkatëse për miratimin e buxhetit 2019 dhe ndryshimet gjatë vitit ushtrimorë 2019 si në tabelën më poshtë:

Nr	Vendimi K.B		P ë r s h k r i m i	T ë a r d h u r a	Struktura shpenzimeve	Shpenzimet
	Nr	Datë				
	145	VKB Buxhet 19.12.2018	Miratim buxheti	430,228	Miratim buxheti	430,228
		Nrysh.buxhet				
1	61	22.05.2019	Prog.të ardhura	73,115	Art.600 Paga	210,857
2	67	17.06.2019				
3	71	17.06.2019				
4	72	17.06.2019				
5	73	17.06.2019	Të ardhura te trashëguara	0	Art.601 Sig.shoqërore	35,214
6	17	25.09.2019	Transferta e Pakushtëzuar	196,526	Art.602 Shpenz.Operative	88,288
7	18	25.09.2019				



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport auditimi mbi auditimin e ushtruar në Bashkinë Mirditë me objekt "Auditim financiar"

8	37	26.11.2019				
9	51	11.12.2019				
			Transferta e pakushtëzuar e trashëguar	14,000	Art.230-231 Investime	90,369
			Transferta specifike	146,587	Fondi Rezervë+Kontigj (609)	5,500
			Transferta specifike e trashëguar	0		

Shënim: Të dhënat janë të disponuar nga Drejtoria e Financës me programimet buxhetore

Ndryshimet në buxhetin e vitit 2019 janë bërë si më poshtë

- Vendim këshilli nr. 61, datë. 22.05.2019 konfirmim prefekti nr. 682/4, datë. 30.05.2019
- Vendim këshilli nr. 67, datë. 17.06.2019 konfirmim prefekti nr. 812/4, datë. 24.06.2019
- Vendim këshilli nr. 71, datë. 17.06.2019 konfirmim prefekti nr. 812/8, datë. 24.06.2019
- Vendim këshilli nr. 72, datë. 17.06.2019 konfirmim prefekti nr. 812/9, datë. 24.06.2019
- Vendim këshilli nr. 73, datë. 17.06.2019 konfirmim prefekti nr. 812/10, datë. 24.06.2019
- Vendim këshilli nr. 17, datë. 25.09.2019 konfirmim prefekti nr. 1304/2, datë. 08.10.2019
- Vendim këshilli nr. 18, datë. 25.09.2019 konfirmim prefekti nr. 1304/3, datë. 08.10.2019
- Vendim këshilli nr. 37, datë. 26.11.2019 konfirmim prefekti nr. 1598/1, datë. 06.12.2019
- Vendim këshilli nr. 51, datë. 11.12.2019 konfirmim prefekti nr. 1654/2, datë. 13.12.2019

### Buxheti i vitit 2020 (në planifikim)

Për hartimin e buxhetit të vitit 2020 është ndjekur baza ligjore përkatëse si dhe udhëzimi plotësues "Për përgatitjen e buxhetit vendor 2020"

Është ngritur urdhëri për dëgjesa publike, programi i punës për të 7 (shtatë) njësitë administrative të Bashkisë Mirditë, dhe janë mbajtur proces-verbalet përkatëse për secilën njësi. Janë miratuar VKB përkatëse për miratimin e buxhetit 2020 dhe ndryshimet gjatë vitit ushtrimorë 2020 si në tabelën më poshtë:

000/lekë

Nr	Vendimi K.B		P e r s h k r i m i	Të ardhura	Struktura shpenzimeve	Shpenzimet
	Nr	Datë				
	60	VKB Buxhet 20.12.2019	Miratim buxheti	464,580	Miratim buxheti	464,580
		Nrysh.buxhet	Prog.të ardhura	80,821	Art.600 Paga	217,828
1	50	20.05.2020	Të ardhura te trashëguara	2,519	Art.601 Sig. shoqërore	36,334
2	52	20.05.2020	Transferta e Pakushtëzuar	211,236	Art.602 Shpenz. Operative	135,325
3	62	30.06.2020	Transferta e pakushtëzuar e trashëguar	19,666	Art.230-231 Investime	60,380
4	63	30.06.2020	Transferta specifike	147,659	Fondi Rezervë+Kontigj (609)	14,713
5	64	30.06.2020	Transferta specifike e trashëguar	2,679		
6	65	30.06.2020				
7	80	30.09.2020				
8	85	30.09.2020				

Shënim: Të dhënat janë të disponuar nga Drejtoria e Financës me programimet buxhetore

Ndryshimet në buxhetin e vitit 2020 janë bërë si më poshtë



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport auditimi mbi auditimin e ushtruar në Bashkinë Mirditë me objekt "Auditim financiar"

- Vendim këshilli nr. 50, datë. 20.05.2020 konfirmim prefekti nr. 394/9, datë. 02.06.2020
- Vendim këshilli nr. 52, datë. 20.05.2020 konfirmim prefekti nr. 394/11, datë. 02.06.2020
- Vendim këshilli nr. 62, datë. 30.06.2020 konfirmim prefekti nr. 555/3, datë. 14.07.2020
- Vendim këshilli nr. 63, datë. 30.06.2020 konfirmim prefekti nr. 555/4, datë. 14.07.2020
- Vendim këshilli nr. 64, datë. 30.06.2020 konfirmim prefekti nr. 555/5, datë. 14.07.2020
- Vendim këshilli nr. 65, datë. 30.06.2020 konfirmim prefekti nr. 555/6, datë. 14.07.2020
- Vendim këshilli nr. 80, datë. 30.09.2020 konfirmim prefekti nr. 871/10, datë. 13.10.2020
- Vendim këshilli nr. 85, datë. 30.09.2020 konfirmim prefekti nr. 871/9, datë. 13.10.2020
- Vendim këshilli nr. 51, datë. 11.12.2019 konfirmim prefekti nr. 1654/2, datë. 13.12.2019

### Buxheti i vitit 2021(në planifikim)

Për hartimin e buxhetit të vitit 2021 është ndjekur baza ligjore përkatëse si dhe udhëzimi plotësues për përgatitjen e buxhetit vendor 2021

Është ngritur urdhëri për dëgjesa publike, programi i punës për të 7 (shtatë) njësitë administrative të Bashkisë Mirditë, dhe janë mbajtur proces-verbalet përkatëse për secilën njësi, duke qenë si vit me pandemi(2020), nga drejtoria e fin/buxhet, është hartuar pyetësor për dëgjesa publike.

Janë miratuar VKB përkatëse për miratimin e buxhetit 2021 dhe ndryshimet gjatë vitit ushtrimorë 2021 si në tabelën më poshtë:

000/lekë

Nr	Vendimi K.B		P e r s h k r i m i	T ë a r d h u r a	Struktura shpenzimeve	Shpenzimet
	Nr	Datë				
	120	Vkb buxhet23.12.2020	Miratim buxheti	477,328	Miratim buxheti	477 328
		Ndryshimet buxhet				
1	23	30.03.2021	Prog.të ardhura	73,489	Art.600 Paga	217,828
	55	31.05.2021	Te ardhura sponsorizim	9925		
2	60	30.06.2021	Të ardhura te trashëguara	2,398	Art.601 Sig.shoqërore	36,334
3	91	30.09.2021	Transferta e Pakushtëzuar	209,021	Art.602 Shpenz.Operative	135,325
4	102	24.11.2021	Transferta e pakushtëzuar e trashëguar	17,093	Art.230-231 Investime	60,380
5			Transferta specifike	158,681	Fondi Rezervë+Kontigji (609)	14,713
6			Transferta specifike e trashëguar	6,721	Art 231 kap 06 teknologji	9925

Shënim: Të dhënat janë të disponuar nga Drejtoria e Financës me programimet buxhetore.

Ndryshimet në buxhetin e vitit 2021 janë bërë si më poshtë

- Vendim këshilli nr. 23, datë. 30.03.2021 konfirmim prefekti nr. 319/9, datë. 16.04.2021
- Vendim këshilli nr. 55, datë. 31.05.2021 konfirmim prefekti nr. 480/6, datë. 11.06.2021
- Vendim këshilli nr. 60, datë. 30.06.2021 konfirmim prefekti nr. 584/8, datë. 12.07.2021
- Vendim këshilli nr. 91, datë. 30.09.2021 konfirmim prefekti nr. 818/4, datë. 12.10.2021
- Vendim këshilli nr. 102, datë. 24.11.2021 konfirmim prefekti nr. 693/3, datë. 03.12.2021

Në hartimin e dokumentit të buxhetit vjetor, është bërë programimi i shpenzimeve, të detajuara sipas secilit program në vlerë dhe % (të dhënat paraqiten të pasqyruara sa më poshtë për buxhetet 2019-2020-2021):

000/lekë



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport auditimi mbi auditimin e ushtruar në Bashkinë Mirditë me objekt “Auditim financiar”

	Shpenzimet të detajuara sipas programeve	Viti 2019		Viti 2020		Viti 2021	
		Vlera	%	Vlera	%	Vlera	%
1	Programi 1 (01110)	73,395	17.06	64,122	13.80	66,380	13.91
2	Programi 2 (01120)	31,634	7.35	31,960	6.88	34,550	7.24
3	Programi 3 (03140)	9,517	2.21	9,795	2.11	10,439	2.19
4	Programi 4 (03280)	15,708	3.65	17,087	3.68	16,180	3.39
5	Programi 5 (04220)	6,791	1.58	8,917	1.92	8,912	1.87
6	Programi 6 (04240)	14,979	3.48	15,758	3.39	19,427	4.07
7	Programi 7 (04260)	12,325	2.86	13,625	2.93	15,436	3.23
8	Programi 8 (04520)	55,558	12.91	54,011	11.63	57,724	12.09
9	Programi 9 (04760)	2,353	0.55	2,363	0.51	2,670	0.56
10	Programi 10 (04570)	970	0.23	980	0.21	995	0.21
11	Programi 11 (06140)	10,798	2.51	9,305	2.00	11,379	2.38
12	Programi 12 (06260)	60,298	14.02	96,383	20.75	66,780	13.99
13	Programi 13 (08130)	8,766	2.04	3,869	0.83	4,726	0.99
14	Programi 14 (08220)	6,553	1.52	8,357	1.80	7,820	1.64
15	Programi 15 (09120)	77,289	17.96	75,319	16.21	93,183	19.52
16	Programi 16 (09230)	7,355	1.71	7,355	1.58	7,577	1.59
17	Programi 17 (09240)	21,882	5.09	21,882	4.71	21,882	4.58
18	Programi 18 (10430)	8,557	1.99	12,791	2.75	9,742	2.04
19	Programi 19 (08230)	0	0.00	651	0.14	669	0.14
20	Programi 20 (08110)	5,500	1.28	10,050	2.16	10,112	2.12
21	Programi 21 (06330)	0	0.00	0	0.00	6,585	1.38
22	Programi 22 (Mbr.civile)	0	0.00	0	0.00	3,660	0.77
23	Programi 23 (10910)	0	0.00	0	0.00	200	0.04
24	Programi 24 (06190)	0	0.00	0	0.00	300	0.06
	<b>TOTALI</b>	<b>430,228</b>	<b>100.00</b>	<b>464,580</b>	<b>100.00</b>	<b>477,328</b>	<b>100.00</b>

Shënim: Të dhënat janë të disponuar nga Drejtoria e Financës me programimet buxhetore



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport auditimi mbi auditimin e ushtruar në Bashkinë Mirditë me objekt "Auditim financiar"

--Nënpika (2/2) Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas akteve normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fondeve të çelura:

Burimet e financimit të buxhetit të Bashkisë për periudhën raportuese viti 2019-2020-2021 të dhënat paraqiten të pasqyruara sa më poshtë:

-Ndarja e shpenzimeve sipas natyrës për periudhën raportuese ushtrimore viti (2019-2020-2021) në vlerë e % me të dhënat paraqiten të pasqyruara sa më poshtë:

Planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve për periudhën janaró dhjetor 2019.

**Për vitin 2019;** Shpenzimet buxhetore të planifikuara në vlerë 911,699 mijë lekë, janë realizuar në vlerë 886,158 mijë lekë në masën 97%, ndërsa të detajuar sipas artikujve është:

-pagat në masën 95%; kontributet për sigurimet në masën 96%; shpenzimet operative në masën 91% dhe investimet në masën 100%.

në/000 lekë

Nr	EMERTIMI	Viti 2019		
		Plani Vjetor (me ndryshime)	Fakti progresiv viti 2019	%
1	Llog.(600)-Paga	199,945	190,842	95%
2	Llog.(601)-Sig.shoq.Shënd	33,285	31,820	96%
3	Llog.( 602-609)Shpenz.opera	98,908	85,510	86%
4	Llog.(230-231) Investime	63,003	63,003	100%
5	Llog.(600) funk.deleguara	4,510	4,510	100%
6	Llog.(601) funk.deleguara	1032	1032	100%
7	Llog.( 602) funk.deleguara	3172	3043	96%
8	Llog.( 604) funk.deleguara	1,137	1,137	100%
9	Llog.(606) ndihmë e burasa pa	250,742	249,296	99%
10	Llog.(231) Investime fonde te deleg	0	0	100%
11	Llog.(231) Investime FZHR	178,451	178451	100%
12	Llog 466 garanci obj të dala	24,279	24,279	100%
13	Llog.(231) Investime të tjera (AKUM)	53,235	53,235	100%
	<b>Totali</b>	<b>911,699</b>	<b>886,158</b>	<b>97%</b>

Shënim: Të dhënat janë të disponuar nga Drejtoria e Financës me programimet buxhetore

**Për vitin 2020;** Shpenzimet buxhetore të planifikuara në vlerë 947,313 mijë lekë, janë realizuar në vlerë 907,822 mijë lekë në masën 96%, ndërsa të detajuar sipas artikujve është:

-pagat në masën 96%; kontributet për sigurimet në masën 96%; shpenzimet operative në masën 87% dhe investimet në masën 100%.

në/000 lekë

Nr	EMERTIMI	Viti 2020		
		Plani Vjetor (me ndryshime)	Fakti progresiv viti 2020	%
1	Llog.(600)-Paga	199,630	192,597	96%
2	Llog.(601)-Sig.shoq.Shënd	32,503	31,252	96%
3	Llog.( 602-609)Shpenz.opera	125,546	109,540	87%
4	Llog.(230-231) Investime	48,785	48,785	100%
5	Llog.(600) funk.deleguara	4,602	4,602	100%
6	Llog.(601) funk.deleguara	953	953	100%
7	Llog.( 602) funk.deleguara	2098	1984	95%
8	Llog.( 604) funk.deleguara	14,495	15	0%
9	Llog.(606) ndihmë e burasa pa	288,438	287,849	100%
10	Llog.(231) Investime fonde te deleg	0	0	0
11	Llog.(231) Investime FZHR	135,617	135,617	100%
12	Llog 466 garanci obj të dala	18,138	18,138	100%

**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT****Raport auditimi mbi auditimin e ushtruar në Bashkinë Mirditë me objekt "Auditim financiar"**

13	Rindërtimi	46,084	46,079	100%
14	Llog.(231) Investime të tjera (AKUM)	30,424	30,424	100%
	<b>Totali</b>	<b>947,313</b>	<b>907,822</b>	<b>96%</b>

Shënim: Të dhënat janë të disponuar nga Drejtoria e Financës me programimet buxhetore

Planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve për periudhën janarë dhjetor 2021.

**Për vitin 2021;** shpenzimet buxhetore të planifikuara në vlerë 1,075,809 mijë lekë, janë realizuar në vlerë 927,558 mijë lekë në masën 86%, ndërsa të detajuar sipas artikujve është:

-pagat në masën 96%; kontributet për sigurimet në masën 100%; shpenzimet operative në masën 90%, investimet në masën 100% dhe investime rindërtimi në masën 60%.

në/000 lekë

Nr	EMERTIMI	Viti 2021		
		Plani Vjetor (me ndryshime)	Fakti progresiv viti 2021	%
1	Llog.(600)-Paga	209,944	201,243	96%
2	Llog.(601)-Sig.shoq.Shënd	33,407	33,390	100%
3	Llog.( 602-609)Shpenz.opera	92,106	82,623	90%
4	Llog.(230-231) Investime	66,373	66,370	100%
5	Llog.(600) funk.deleguara	4,602	4,529	98%
6	Llog.(601) funk.deleguara	954	924	97%
7	Llog.( 602) funk.deleguara	2655	2655	100%
8	Llog.( 604) funk.deleguara	0	0	0%
9	Llog.(606) ndihmë e bursa pa	305,701	302,032	99%
10	Llog.(231) Investime fonde të deleg	0	0	0%
11	Llog.(231) Investime FZHR	0	0	0%
12	Llog 466 garanci obj të dala	21,202	21,202	100%
13	Rindërtimi	313,865	187,590	60%
14	Llog.(231) Investime të tjera (AKUM)	25,000	25,000	100%
	<b>Totali</b>	<b>1,075,809</b>	<b>927,558</b>	<b>86%</b>

Shënim: Të dhënat janë të disponuar nga Drejtoria e Financës me programimet buxhetore

Sipas burimeve të financimit paraqiten;

-Nga transfertat e pakushtëzuar; treguesit e buxhetit janë të planifikuar

- Për vitin 2019 në vlerën 204,265 mijë lekë, ndërsa janë realizuar në vlerën 195,067 mijë lekë, ose në masë 95%

- Për vitin 2020 në vlerën 224,045 mijë lekë, ndërsa janë realizuar në vlerën 221,053 mijë lekë, ose në masë 99%

- Për vitin 2021 në vlerën 205,657 mijë lekë, ndërsa janë realizuar në vlerën 202,985 mijë lekë, ose në masë 99%, të dhënatsi më poshtë:

Viti 2019

000/lekë

Nr	Artikulli	Plan	Fakt	Diferenca	
				%	Në vlerë
1	600	86,896	80,768	93%	6,128
2	601	14,656	14,076	96%	580
3	602	39,710	37,220	94%	2,490
4	604	0	0	0%	0
5	606	0	0	0%	0
6	231	63,003	63,003	100%	0
	<b>Totali</b>	<b>204,265</b>	<b>195,067</b>	<b>95%</b>	<b>9,198</b>

VITI 2020

Nr	Artikulli	Plan	Fakt	Diferenca
----	-----------	------	------	-----------





## KONTROLLI I LARTË I SHETIT

### Raport auditimi mbi auditimin e ushtruar në Bashkinë Mirditë me objekt “Auditim financiar”

				%	Në vlerë
1	600	87,597	87,597	100%	0
2	601	17,356	16,322	94%	1,034
3	602	70,394	68,971	98%	1,423
4	604	0	0	0%	0
5	606	3787	3252	0%	535
6	231	44,911	44,911	100%	0
	<b>Totali</b>	<b>224,045</b>	<b>221,053</b>	<b>99%</b>	<b>2,992</b>

#### VITI 2021

Nr	Artikulli	Plan	Fakt	Diferenca	
				%	Në vlerë
1	600	89,174	89,099	100%	75
2	601	17,290	17,273	100%	17
3	602	36,808	34,823	95%	1,985
4	604	0	0	0%	0
5	606	6121	5529	0%	592
6	231	56,264	56,261	100%	3
	<b>Totali</b>	<b>205,657</b>	<b>202,985</b>	<b>99%</b>	<b>2,672</b>

Shënim: Të dhënat janë të disponuar nga Drejtoria e Financës me programimet buxhetore.

-Nga transfertat specifike; treguesit e buxhetit janë të planifikuar

- Për vitin 2019 në vlerën 121,295 mijë lekë, ndërsa janë realizuar në vlerën 118,676 mijë lekë, ose në masë 98%.

- Për vitin 2020 në vlerën 119,141 mijë lekë, ndërsa janë realizuar në vlerën 117,322 mijë lekë, ose në masë 98%

- Për vitin 2021 në vlerën 130,422 mijë lekë, ndërsa janë realizuar në vlerën 127,614 mijë lekë, ose në masë 98%, të dhënatsi më poshtë:

#### Viti 2019

000/lekë

Nr	Artikulli	Plan	Fakt	Diferenca	
				%	Në vlerë
1	600	91,310	91,164	100%	146
2	601	15,247	15,019	99%	228
3	602	14,738	12,493	85%	2,245
4	231	0	0	0%	0
	<b>Totali</b>	<b>121,295</b>	<b>118,676</b>	<b>98%</b>	<b>2,619</b>

#### Viti 2020

Nr	Artikulli	Plan	Fakt	Diferenca	
				%	Në vlerë
1	600	91,190	91,044	100%	146
2	601	15,147	14,930	99%	217
3	602	12,804	11,348	89%	1,456
4	231	0	0	0%	0
	<b>Totali</b>	<b>119,141</b>	<b>117,322</b>	<b>98%</b>	<b>1,819</b>

#### Viti 2021

Nr	Artikulli	Plan	Fakt	Diferenca	
				%	Në vlerë
1	600	98,999	97,759	99%	1,240
2	601	16,117	16,117	100%	0



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport auditimi mbi auditimin e ushtruar në Bashkinë Mirditë me objekt “Auditim financiar”

3	602	15,306	13,738	90%	1,568
4	231	0	0	0%	0
	<b>Totali</b>	<b>130,422</b>	<b>127,614</b>	<b>98%</b>	<b>2,808</b>

Shënim: Të dhënat janë të disponuar nga Drejtoria e Financës me programimet buxhetore.

-Të e dhënat mbi të ardhurat e planifikuara sipas buxheteve 2019, 2020, 2021 dhe të realizuara sipas akt-akordimeve vjetore me thesarin, duke përfshirë në fakt edhe të ardhurat e trashëguara rezultojnë:

000/lekë

Periudha	Programimi, realizimi të Ardhurave		Diferenca		Planifikimi dhe përdorimi i të ardhurave në Buxhet		Diferenca	
	Plani	Fakti	Vlerë	%	Plani fillimit Buxhetit	Fakti në thesar sipas realizimit përfshirë të trashëguara.	Vlerë	%
Viti 2019	73,115	63,719	9,396	87%	73,115	63,719	9,396	87%
Viti 2020	80,821	55,658	25,163	69%	83,340	58,177	25,163	70%
Viti 2021	73,488	70,056	3,432	95%	75,886	72,454	3,432	95%

Përdorimi i të ardhurave sipas planifikimit në buxhetet respektive rezultojnë sa më poshtë:

- Për vitin 2019 në vlerën të planifikuara 73,115 mijë lekë, ndërsa janë përdorur nga bashkia në vlerën 55,959 mijë lekë, ose në masë 82%;
- Për vitin 2020 në vlerën të planifikuara 80,821 mijë lekë, ndërsa janë realizuar në vlerën 43,692 mijë lekë, ose në masë 69% .;
- Për vitin 2021 në vlerën të planifikuara 73,488 mijë lekë, ndërsa janë realizuar në vlerën 56,449 mijë lekë, ose në masë 86% .

Viti 2019

000/lekë

Nr	Artikulli	Plan	Fakt	Diferenca	
				%	Në vlerë
1	600	20,266	17,437	86%	2,829
2	601	3,382	2,725	81%	657
3	602	44,460	35,797	81%	8,663
4	604	0	0	0%	-
5	606	0	0	0%	-
6	231	0	0	0%	-
	<b>Totali</b>	<b>68,108</b>	<b>55,959</b>	<b>82%</b>	<b>12,149</b>

Viti 2020

Nr	Artikulli	Plan	Fakt	Diferenca	
				%	Në vlerë
1	600	20,843	13,956	67%	6,887
2	601	-	-	0%	-
3	602	42,333	29,221	69%	13,112
4	604	15	15	0%	-
5	606	0	0	0%	-
6	231	500	500	0%	-
	<b>Totali</b>	<b>63,691</b>	<b>43,692</b>	<b>69%</b>	<b>19,999</b>

Viti 2021

Nr	Artikulli	Plan	Fakt	Diferenca	
				%	Në vlerë
1	600	19,970	12,478	62%	7,492
2	601	-	-	0%	-
3	602	36,141	34,062	94%	2,079
4	604	0	0	0%	-
5	606	0	0	0%	-



## KONTROLLI I LARTË I SHETIT

### Raport auditimi mbi auditimin e ushtruar në Bashkinë Mirditë me objekt "Auditim financiar"

6	(231) Nga ardhura jashtë limiit	9,889	9,889	0%	0
7	231	20	20	0%	-
	<b>Totali</b>	<b>66,020</b>	<b>56,449</b>	<b>86%</b>	<b>9,571</b>

Shënim: Të dhënat janë të disponuar nga Drejtoria e Financës me programimet buxhetore.

#### Nga fondet e deleguara; treguesit e buxhetit janë të planifikuar

- Për vitin 2019 në vlerën 493,752 mijë lekë, ndërsa janë realizuar në vlerën 492,177 mijë lekë, ose në masë 100%.

- Për vitin 2020 në vlerën 522,298 mijë lekë, ndërsa janë realizuar në vlerën 504,617 mijë lekë, ose në masë 97%.

- Për vitin 2021 në vlerën 648,763 mijë lekë, ndërsa janë realizuar në vlerën 492,177 mijë lekë, ose në masë 100%, të dhënatsi më poshtë:

Viti 2019

000/lekë

Nr	Artikulli	Plan	Fakt	Diferenca	
				%	Në vlerë
1	600	5,983	5,983	100%	0
2	601	1032	1032	100%	0
3	602	3172	3043	96%	129
4	604	1,137	1,137	100%	0
5	606	250,742	249,296	99%	1,446
6	(231) Nga AKUM (MIE)	53,235	53,235	100%	0
7	(231) Nga fondet FZHR	178,451	178,451	100%	0
	<b>Totali</b>	<b>493,752</b>	<b>492,177</b>	<b>100%</b>	<b>1,575</b>

Viti 2020

Nr	Artikulli	Plan	Fakt	Diferenca	
				%	Në vlerë
1	600	4,602	4,602	100%	0
2	601	953	953	100%	0
3	602	2098	1984	95%	114
4	604	14,495	0	0%	14,495
5	606	284,651	284,597	100%	54
6	(231) Nga AKUM (MIE)	30,424	30,424	100%	0
8	Rindërtimi	46,084	46,079	100%	5
7	(231) Nga fondet FZHR	138 991	138 978	100%	13
	<b>Totali</b>	<b>522,298</b>	<b>507,617</b>	<b>97%</b>	<b>14,681</b>

Viti 2021

Nr	Artikulli	Plan	Fakt	Diferenca	
				%	Në vlerë
1	600	6,509	6,436	99%	73
2	601	954	924	97%	30
3	602	2655	2655	100%	0
4	604	0	0	0%	0
5	606	299,580	296,503	99%	3,077
6	(231) Nga AKUM (MIE)	25,200	25,200	100%	0
8	Rindërtimi	313,865	187,590	60%	126,275
7	(231) Nga fondet FZHR	0	0	0%	0
	<b>Totali</b>	<b>648,763</b>	<b>519,308</b>	<b>80%</b>	<b>129,455</b>

**Nënpika (2/3). Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit. Fondet e shpenzuara nga njësia vendore për shkak të situatës COVID<sup>-19</sup>, miratimi i këtyre fondeve sipas kuadrit rregullator në fuqi.**



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport auditimi mbi auditimin e ushtruar në Bashkinë Mirditë me objekt “Auditim financiar”

**Raportet e monitorimit të treguesve buxhetor.** Nga Kryetari Njesisë së Vetëqeverisjes Vendore në zbatim të detyrimeve ligjore për monitorimin e zbatimit të buxhetit janë bërë raportet periodike si vijon:

Në zbatim të kërkesave të nenit 44 të Raporti vjetorë, të ligjit nr. 139/2015 për vetëqeverisjen vendore, ku kërkohet që kryetari njesisë së vetëqeverisjes vendore është përgjegjës të paraqesë çdo vit një raport me shkrim të këshillit për veprimtarinë financiare dhe zbatimin e buxhetit të njesisë së vetëqeverisjes vendore, përfshirë dhe institucionet e saj të varësisë. Ky raport i paraqitet këshillit jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës, nenit 54, të ligjit nr. 68/2017 për financat e vetëqeverisjes vendore, si kërkesë ligjore e udhëzimit nr. 22, datë. 30.07.2018 për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore,

#### -Viti 2019

-Meshkresën nr. 663 prot., datë 19/02/2020 i është dërguar këshillit bashkiak të Raporti vjetor i monitorimit të zbatimit të buxhetit për vitin 2019.

Për vitin 2019 janë bërë edhe 3 raporte të monitorimit të zbatimit buxhetit .

Raportet janë bërë për çdo 4 muaj. Gjithashtu këto raporte 4 muajore i janë dërguar dhe me shkresë zyrtare edhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (Drejtoria e Buxhetit Vendor).

#### -Viti 2020

-Raporti vjetor i monitorimit të zbatimit të buxhetit të vitit 2020, nga titullari i njesisë vendore i është dërguar këshillit bashkiak, dhe është miratuar me vkb nr,7, datë 27.01.2021, nr. 335/1 prot, datë. 29.01.2021.

#### Viti 2021

-Për vitin 2021 janë bërë 2 raporte të monitorimit të zbatimit buxhetit dhe respektivisht janë dërguar në këshillin bashkiak me shkresën nr 1985/1 prot, datë. 31.05.2021, katërmujori i parë, me shkresën nr. 1985/1 prot, datë. 31.05.2021 dhe në MFE me shkresën nr. 2125 prot, datë. 31.05.2021, katërmujori i dytë, me shkresën nr 1985/1 prot, datë. 31.05.2021 në këshillin bashkiak dhe në MFE me shkresën nr. 3732 prot, datë. 29.09.2021, ndërsa raporti tretë është në vazhdim pasi ka afat dorëzimi sipas udhëzimit nr 22, brenda muajit shkurt të vitit pasardhës. Gjithashtu raportet 4 muajore i janë dërguar me shkresë zyrtare Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Për zbatimin e buxhetit vjetor të vitit 2019; 2020; 2021 është hartuar raport monitorimi (analizë vjetore) nga titullari i njesisë vendore, si analizë vjetore për secilin vit dhe është dërguar për miratim në këshillin bashkiak .

Nga auditimi mbi dokumentacionin e vënë në dispozicion mbi plan buxhetin dhe detajimi e tyre në nivel Titull; Kapitull; Artikull; Nën/artikull u konstatua se, në të gjitha rastet është respektuar disiplina buxhetore të pasqyruara sa më poshtë:

*Pasqyra e realizimit të treguesve të zërave të buxhetit për vitin 2019-2020-2021*

*000/lekë*

Nr	Emërtimi	Viti 2019		
		Plani Vjetor (me ndryshime)	Fakti progresiv viti 2019	%
1	Llog.(600)-Paga	199,945	190,842	95%
2	Llog.(601)-Sig.shoq.Sh	33,285	31,820	96%
3	Llog.( 602-609)Shpenz.opera	98,908	85,510	86%
4	Llog.(230-231) Investime	63,003	63,003	100%
5	Llog.(600) funk.deleguara	4,510	4,510	100%



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport auditimi mbi auditimin e ushtruar në Bashkinë Mirditë me objekt “Auditim financiar”

6	Llog.(601) funk.deleguara	1032	1032	100%
7	Llog.( 602) funk.deleguara	3172	3043	96%
8	Llog.( 604) funk.deleguara	1,137	1,137	100%
9	Llog.(606) ndihmë e burasa pa	250,742	249,296	99%
10	Llog.(231) Investime fonde te deleg	157,375	157,375	100%
11	Llog.(231) Investime FZHR	21,076	21,076	100%
12	Llog 466 garanci obj të dala	24,279	24,279	100%
13	Llog.(231) Investime të tjera (AKUM)	53,235	53,235	100%
	<b>Totali</b>	<b>911,699</b>	<b>886,158</b>	<b>97%</b>

Nr	E m ë r t i m i	Viti 2020		
		Plani Vjetor (me ndryshime)	Fakti progresiv viti 2020	%
1	Llog.(600)-Paga	199,630	192,597	96%
2	Llog.(601)-Sig.shoq.Sh	32,503	31,252	96%
3	Llog.( 602-609)Shpenz.opera	125,546	109,540	87%
4	Llog.(230-231) Investime	48,785	48,785	100%
5	Llog.(600) funk.deleguara	4,602	4,602	100%
6	Llog.(601) funk.deleguara	953	953	100%
7	Llog.( 602) funk.deleguara	2098	1984	95%
8	Llog.( 604) funk.deleguara	14,495	15	0%
9	Llog.(606) ndihmë e burasa pa	288,438	287,849	100%
10	Llog.(231) Investime fonde te deleg	135,617	135,604	100%
11	Llog.(231) Investime FZHR	0	0	0%
12	Llog 466 garanci obj të dala	18,138	18,138	100%
13	Rindertimi	46,084	46,079	100%
14	Llog.(231) Investime te tjera (AKUM)	30,424	30,424	100%
	<b>Totali</b>	<b>947,313</b>	<b>907,822</b>	<b>96%</b>

Nr	E M E R T I M I	Viti 2021		
		Plani Vjetor (me ndryshime)	Fakti progresiv viti 2021	%
1	Llog.(600)-Paga	209,944	201,243	96%
2	Llog.(601)-Sig.shoq.Sh	33,407	33,390	100%
3	Llog.( 602-609)Shpenz.opera	92,106	82,623	90%
4	Llog.(230-231) Investime	66,373	66,370	100%
5	Llog.(600) funk.deleguara	4,602	4,529	98%
6	Llog.(601) funk.deleguara	954	924	97%
7	Llog.( 602) funk.deleguara	2655	2655	100%
8	Llog.( 604) funk.deleguara	0	0	0%
9	Llog.(606) ndihmë e burasa pa	305,701	302,032	99%
10	Llog.(231) Investime fonde te deleg	0	0	0%
11	Llog.(231) Investime FZHR	0	0	0%
12	Llog 466 garanci obj te dala	21,202	21,202	100%
13	Rindertimi	313,865	187,590	60%



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport auditimi mbi auditimin e ushtruar në Bashkinë Mirditë me objekt “Auditim financiar”

14	Llog.(231) Investime te tjera (AKUM)	25,000	25,000	100%
<b>Totali</b>		<b>1,075,809</b>	<b>927,558</b>	<b>86%</b>

*Shënim: Të dhënat janë të disponuar nga Drejtoria e Financës me programimet buxhetore.*

Realizimi fondit të pagave, sigurimeve shoqërore e shëndetësore, si edhe e numrit të punonjësve në plan dhe fakt për periudhën objekt i auditimit paraqiten me të dhënat si më poshtë:

Periudha	Paga (600)		Sigurime (601)		Numri i punonjësve	
	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plani	Fakti
Viti 2019	204,455	195,352	34,317	32,852	352	334
Viti 2020	204,232	197,199	37,214	32,760	357	337
Viti 2021	214,546	205,772	34,361	34,314	376	332

*Shënim: Të dhënat janë të disponuar nga Drejtoria e Financës me programimet buxhetore*

-Për fondet e shpenzuara Bashkia Mirditë, për shkak të situatës COVID<sup>-19</sup>, rezultojë;

Nga kjo bashki janë përdorur fonde të miratuar me VKB nr. 32, datë. 11.03.2020 në shumën 2,000,000 lekë.

-Janë miratuar me Vendimin e Këshillit të Bashkisë shuma 2,000,000 lekë, nga fondi i emergjencave civile të miratuara në buxhetin fillestarë të Bashkisë për vitin 2020.

Këto fonde janë përdorur si më poshtë:

-Me vendim e këshillit nr. 51, datë. 20.05.2020, janë miratuar fondi prej 220,800 lekë, për blerje klori për dezinfektimin e objekteve dhe ambienteve të përbashkëta në të gjithë territorin e Bashkisë (i përfshirë në VKB nr 32, datë. 11.03.2020).

-Është bërë blerje e vogël me faturë nr. 5, datë. 15.05.2020, serial 32938055, në shumën 85, 839 lekë, me objekt materiale për dezinfektim për situatën COVID<sup>-19</sup>.

-Është bërë blerje e vogël me faturë nr. 58, datë. 19.06.2020, serial 89609407, në shumën 26, 016 lekë, me objekt blerje termometra për situatën COVID<sup>-19</sup>.

-Është prokuruar dhe lidh kontrata me nr. 4902/4, datë. 11.12.2020 me objekt blerje dizifektant situata COVID<sup>-19</sup> dhe DDD për Bashkinë Mirditë në shumën 1,168,980 lekë

-Në total fonde të shpenzuara nga Bashkia Mirditë për shkak të situatës COVID<sup>-19</sup>, për periudhën 2019-2021 janë 1,501,635 lekë .

**-Nënpika (2/4) Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikuiduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve; (Faturat e palikuiduara të shoqërohen me listë analitike, të detajuara me numër fature dhe datë krijimi etj, sipas raportimit në MFE, ku të evidentohen detyrimet nga mungesa e burimeve të veta dhe detyrimet nga mungesa e alokimit të grandeve si FZHR, Ministrinë e linjës etj.);**

#### **Për periudhën raportuese ushtrimore viti 2019;**

Nga auditimi mbi dokumentacionin e vendosur në dispozicion nga Drejtoria e Financës në Bashkia Mirditë, si dhe mbi të dhënat e evidentuar në pasqyrat financiare (*bilanci kontabël*) konstatohet se; totali faturave të pa likuiduara në periudhën (2019) objekt i procesit të auditimit sipas zërave në; (*shpenzime për investime, mallra e shërbime dhe vendime gjyqësore*), bazuar në listën analitike që administrohet nga sektori i financës si dhe nga vlera e llogarisë -486 ÷shpenzime të periudhave të ardhshme, të aktivitetit të bilancit, vlera e detyrimeve të prapambetura për Bashkinë Mirditë në datën 31.12.2018 është 98,847,012 lekë, dhe në fund të periudhës në datë 31.12.2019 gjendja paraqitet në vlerën totale prej 73,027,330 lekë. Bashkia Mirditë për vitin 2019 ka akt rakordimi me degën e thesarit Mirditë për detyrimet e prapambetura. Bazuar në listën analitike që administrohet nga sektori i financës si dhe nga vlera e llogarisë -434.2 ÷Operacione me shtetin të drejta të aktivitetit të bilancit, (në të cilën janë përfshirë si kundraparti



## KONTROLI I LARTË I SHETIT

### Raport auditimi mbi auditimin e ushtruar në Bashkinë Mirditë me objekt "Auditim financiar"

llog 401,421,431,435,436,467 të pasivitet), kjo vlerë është përfshirë gabimisht në këtë llogari duhej në llogarinë 486 òshpenzime të periudhave të ardhshmeò, vlera e detyrimeve të prapambetura për Bashkinë Mirditë në datën 31.12.2019 është 73,027,330 lekë, e cila sipas natyrës së detyrimit paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Nr	Emërtimi i natyrës së detyrimit	Vlera e detyrimit më 31.12.2019
1	Detyrim për investime	24,006,186
2	Detyrim për vendimet gjyqësore	0
3	Detyrim për mallra dhe shërbime	49,021,144
	Total	<b>73,027,330</b>

Burimi: Drejtoria Financës dhe Buxheti Bashkia Mirditë

Nga të dhënat e mësipërme konstatohet se detyrimet për mallra dhe shërbime zënë 67% të vlerës së detyrimeve totale.

Lista analitike e detyrimeve të prapambetura më 31.12.2019, paraqitet në rubrikën e anekseve, aneksi nr.1, pika 2/4: 2, pika 2/4 bashkëngjitur këtij akti konstatimi.

Nga auditimi pasqyrave financiare të vitit 2019 konstatohet se vlera e llogarisë 520 ó Disponibilitete në thesar (e cila tregon fondet e pa shpenzuara gjatë vitit 2019, të cilat kalojnë për përdorim në vitin 2020), ka vlerën 24,754,293 lekë.

Tabela në vijim:

Subjekti	Vlera e kredisë (detyrimit) më 31.12.2019	Fondet e trashëguara në 31.12.2019 për vitin 2020 (Llog. 520 në bilanc)	Diferenca fonde të trashëguara (Llog. 520 në bilanc) me vlerën e detyrimit në fund të vitit(kreditore)
Bashkia Mirditë	<b>73, 027, 330</b>	24,754,239	- 48, 273, 091

Burimi: Drejtoria Financës dhe Buxheti Bashkia Mirditë

Nga auditimi konstatohet se fondet e trashëguara janë më të pakta se vlera e detyrimeve të prapambetura me datë. 31.12.2019.

Të dhënat e detyrimeve të prapambetura më 31.12.2019 sipas burimit të financimit, paraqiten si më poshtë:

Sipas bilancit:

Viti 2019 Bashkia Mirditë				në 000/lekë				Nga totali i detyrimeve:		
Investime			Detyrimi total për investimet	Mallra dhe shërbime			Vendime gjyqësore	Totali detyrimeve në 31.12.2019	Pjesa që i përket Grantit Qeveritar +FZHR	Pjesa që i përket të ardhurave
Pjesa që i përket të ardhurave	Investime nga FZHR	Investime nga buxheti i shtetit Transf pakusht +ardh bashkise		Pjesa që i përket Grantit Qeveritar	Pjesa që i përket të ardhurave	Detyrimi total për mallra				
0	0	24,006	24,006	0	49,021	49,021	0	73,027	0	73,027

Burimi: Drejtoria Financës dhe Buxheti Bashkia Mirditë

Sipas të dhënave të drejtorisë së buxhetit të Bashkisë Mirditë, shuma e detyrimeve prej 73,027 mijë lekë në fund të vitit 2019, është krijuar për këto arsye:

- 1-Mosrealizimi i të ardhurave sipas planit të fillim vitit, të miratuar dhe planifikuar në buxhet.
- 2-Planifikimi i kontratave të investimeve dhe shërbimeve në dy vite buxhetimi, ku punimet dhe shërbimet janë kryer brenda vitit të parë të buxhetimit, për rrjedhojë janë prerë faturat tatimore dhe regjistruar si detyrime të prapambetura në sistemin e thesarit.

Përsa më sipër pjesa e detyrimeve të prapambetura në datën 31.12.2019, që janë llogaritur duhet të mbuloreshin nga të ardhurat e veta dhe buxheti i Bashkisë transferta e pakushtëzuar.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport auditimi mbi auditimin e ushtruar në Bashkinë Mirditë me objekt “Auditim financiar”

Situata e detyrimeve të prapambetura të paraqitura në bilanc, ka përputhje me situatën e raportuar në raportet e monitorimit që njëzia vendore përcjell në MFE dhe degën e Thesarit Mirditë. Risqet buxhetore nga niveli i faturave të pa likuiduara të investimeve për periudhën raportuese viti 2019 janë konstatuar për objektet;

**a**-Sistemi asfaltim rruga kryqëzimi autostradë, Bashkia Mirditë në vlerën 7,874,052 lekë (buxheti i Bashkisë)

**b**-Rruga Klos Gjakëz Domgjon, Bashkia Mirditë në vlerë 6,422,600 lekë, (buxheti i Bashkisë).

**c**-Objekte arsimore 10% (sipas vendimit nr. 01, datë. 28.02.2019 të KZHR shtojta 1, pika a) e vlerës së kontratës (822,608+471,293+3,107,140+1,942,795) = 6,343,836 lekë (buxheti i Bashkisë).

**d**-Riparim i urave të ndryshme Bashkia Mirditë në vlerën 940,793 lekë (buxheti i Bashkisë).

Gjithashtu risqe të tjera kemi konstatuar edhe për shpenzime për kolaudim dhe mbikëqyrje të punimeve në objektet;

**a**-Mbikëqyrje e punimeve, òKonvikti shkolla e mesme Rrëshenë në vlerën 810,948 lekë.

**b**-Kolaudimi i punimeve òNdërtimi i kopshtit të fëmijëve Rrëshenë në vlerën 73,878 të financuara nga Bashkia.

Risqet buxhetore nga niveli i faturave të pa likuiduara të shpenzimeve operative për periudhën raportuese viti 2019 janë konstatuar për objektet kryesisht

-Kontrata e shërbimit të mirëmbajtjes së sipërfaqeve të gjelbërimit sipas aneksit 2, pika 2.4 nr. rendor 6 në shumën 6,890,975 lekë.

-Kontrata e shërbimit të pastrimit të qytetit sipas aneksit 2, pika 2.4 nr. rendor 7 në shumën 25,835,892 lekë.

-Kontrata qerasë së zyrave sipas aneksit 2, pika 2.4 nr. rendor 8 në shumën 2,093,784 lekë.

-Kontrata karburanti sipas aneksit 2, pika 2.4 nr. rendor 23 në shumën 3,724,331 lekë.

-Kontrata e ushqimeve sipas aneksit 2, pika 2.4 nr. rendor 32 në shumën 1,500,541 lekë.

Nga auditimi u konstatua se nuk kishte detyrime të prapambetura për vendimet gjyqësore.

#### **Për periudhën raportuese ushtrimore viti 2020;**

Nga auditimi mbi dokumentacionin e vendosur në dispozicion nga Drejtoria e Financës në Bashkia Mirditë, si dhe mbi të dhënat e evidentuar në pasqyrat financiare (*bilanci kontabël*) konstatohet se; totali i faturave të pa likuiduara në periudhën (2020) objekt i procesit të auditimit sipas zërave në; (*shpenzime për investime, mallra e shërbime dhe vendime gjyqësore*), në fund të periudhës në datë 31.12.2020 gjendja paraqitet në vlerën totale prej 66,194,216 lekë.

Bashkia Mirditë për vitin 2020 ka akt-rakordimi me degën e thesarit Mirditë për detyrimet e prapambetura.

Bazuar në listën analitike që administrohet nga sektori i financës si dhe nga vlera e llogarisë

-486 shpenzime të periudhave të ardhshme, të aktivitetit të bilancit, vlera e detyrimeve të prapambetura për Bashkinë Mirditë në datën 31.12.2020 është 66,194,216 lekë, e cila sipas natyrës së detyrimit paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Nr	Emërtimi i natyrës së detyrimit	Vlera e detyrimit më 31.12.2020
1	Detyrim për investime	39 798 292
2	Detyrim për vendimet gjyqësore	0
3	Detyrim për mallra dhe shërbime	26 395 924
	Total	<b>66, 194,216</b>

Burimi: Drejtoria Financës dhe Buxheti Bashkia Mirditë





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport auditimi mbi auditimin e ushtruar në Bashkinë Mirditë me objekt “Auditim financiar”

Nga të dhënat e mësipërme konstatohet se detyrimet për investime zënë pjesën më të madhe të detyrimeve të prapambetura 60% të vlerës së detyrimeve totale. Këtu sqarohet se në detyrimet e investimeve është përfshirë edhe investimi me fondet e e AKUM në vlerën 4,972,983 lekë.

Vlera neto e detyrimeve të prapambetura nga fondet e Bashkisë (të ardhurat e Bashkisë + transferta e pakushtëzuar) është (66,194,216- 4,972,983) = **61,221,233 lekë**.

Lista analitike e detyrimeve të prapambetura më 31.12.2020, paraqitet në rubrikën e anekseve, (aneksi nr. 1, pika 2/4: 2, pika 2/4) bashkëngjitur këtij akti konstatimi.

Nga auditimi pasqyrave financiare të vitit 2020 konstatohet se vlera e llogarisë 520 ó Disponibilitete në thesar (e cila tregon fondet e pa shpenzuara gjatë vitit 2020, të cilat kalojnë për përdorim në vitin 2021), ka vlerën 24,199,010 lekë.

Tabela në vijim:

Subjekti	Vlera e kredisë (detyrimet) më 31.12.2020	Fondet e trashëguara në 31.12.2020 për vitin 2021 (Llog. 520 në bilanc)	Diferenca fonde të trashëguara (Llog. 520 në bilanc) me vlerën e detyrimit në fund të vitit (kreditore)
Bashkia Mirditë	66,194,216	24,199,010	- 41,995,206

Burimi: Drejtoria Financës dhe Buxhetit Bashkia Mirditë

Nga auditimi konstatohet se fondet e trashëguara janë më të pakta se vlera e detyrimeve të prapambetura me datë 31.12.2020.

Të dhënat e detyrimeve të prapambetura më 31.12.2019 sipas burimit të financimit, paraqiten si më poshtë: Sipas bilancit

Viti 2020 Bashkia Mirditë në 000/lekë								Nga totali i detyrimeve:		
Investime				Mallra dhe shërbime			Vendime gjyqësore	Totali detyrimeve në 31.12.2019	Pjesa që i përket Grantit Qeveritar +FZHR+AKUM	Pjesa që i përket të ardhurave+ TRANSF E PAKUSHTËZUAR
Pjesa që i përket të ardhurave	Investime nga FZHR +AKUM	Investime nga buxheti i shtetit Transf pakusht +ardh bashkise	Detyrimi total për investimet	Pjesa që i përket Grantit Qeveritar	Pjesa që i përket të ardhurave	Detyrimi total për mallra				
0	4,973	34,825	39,798	0	26,396	26,396	0	66,194	4,973	61,221

Burimi: Drejtoria Financës dhe Buxhetit Bashkia Mirditë

Sipas të dhënave të drejtorisë së buxhetit të Bashkisë Mirditë, shuma e detyrimeve prej 66, 194 mijë lekë në fund të vitit 2020, është krijuar për këto arsye:

- 1-Mosrealizimi i të ardhurave sipas planit të fillim vitit të miratuar dhe planifikuar në buxhet;
- 2-Planifikimi i kontratave të investimeve dhe shërbimeve në dy vite buxhetimi, ku punimet dhe shërbimet janë kryer brenda vitit të parë të buxhetimit, për rrjedhojë janë prerë faturat tatimore dhe regjistruar si detyrime të prapambetura në sistemin e thesarit.
- 3-Mungesë fondesh nga AKUM

Përsa më sipër pjesa e detyrimeve të prapambetura në datën 31.12.2020, që janë llogaritur duhet të mbulohehin nga të ardhurat e veta, buxheti i Bashkisë transferta e pakushtëzuar dhe AKUM. Situata e detyrimeve të prapambetura të paraqitura në bilanc, ka përputhje me situatën e raportuar në raportet e monitorimit që njëjësia vendore përcjell në MFE dhe degën e Thesarit Mirditë.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport auditimi mbi auditimin e ushtruar në Bashkinë Mirditë me objekt “Auditim financiar”

Risqet buxhetore nga niveli i faturave të pa likuiduara të investimeve për periudhën raportuese viti 2020 janë konstatuar për objektet;

**a**-Godina e shërbimit për qytetarët shtese kontrateö, Bashkia Mirditë në vlerën 15,271,786 leke (buxheti i Bashkisë)

**b**-Objekte arsimore 10% e vlerës së kontratës (9,013,013+539,279+7,213,243+822,608+732,912)=18,321,055 lekë (buxheti i Bashkisë).

Gjithashtu risqe të tjera kemi konstatuar edhe për shpenzime për kolaudim dhe mbikëqyrje të punimeve në objektet;

**a**-Mbikëqyrje e punimeve, öKonvikti shkolla e mesme Rrëshenö në vlerën 810,948 lekë.

AKUM.

a)-Ndërtimi i ujësjellësit Rubik, bashkia Mirditë.

Risqet buxhetore nga niveli i faturave të pa likuiduara të shpenzimeve operative për periudhën raportuese viti 2021 janë konstatuar për objektet kryesisht

-Kontrata e shërbimit të mirëmbajtjes së sipërfaqeve të gjelbërimit sipas aneksit 2, pika 2.4 nr rendor 5, në shumën 4,768,302 lekë

-Kontrata e shërbimit të pastrimit të qytetit sipas aneksit 2, pika 2.4 nr rendor 6, në shumën 9,881,964 lekë

-Kontrata qerasë së zyrave sipas aneksit 2, pika 2.4 nr rendor 9, në shumën 1,332,408 lekë

-Kontrata karburanti sipas aneksit 2, pika 2.4 nr rendor 44, në shumën 931,858 lekë

-Kontrata e druve të zjarrit sipas aneksit 2, pika 2.4 nr rendor 40, në shumën 2,019,960 lekë

Nga auditimi u konstatua se nuk kishte detyrime të prapambetura për vendimet gjyqësore

#### **Për periudhën raportuese ushtrimore viti 2021;**

Nga auditimi mbi dokumentacionin e vendosur në dispozicion nga Drejtoria e Financës në Bashkia Mirditë, objekt i procesit të auditimit sipas zërave në; (shpenzime për investime, mallra e shërbime dhe vendime gjyqësore), në fund të periudhës në datë 31.12.2021 gjendja paraqitet në vlerën totale prej 48,633,621 lekë.

Bashkia Mirditë për vitin 2021 ka akt-rakordimi me degën e thesarit Mirditë për detyrimet e prapambetura..

Bazuar në listën analitike që administrohet nga sektori i financës vlera e detyrimeve të prapambetura për Bashkinë Mirditë në datën 31.12.2021 është 48,633,621lekë, e cila sipas natyrës së detyrimit paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Në lekë

Nr	Emërtimi i natyrës së detyrimit	Vlera e detyrimit më 31.12.2021
1	Detyrim për investime	36,367,295
2	Detyrim për vendimet gjyqësore	0
3	Detyrim për mallra dhe shërbime	12,266,326
	Total	<b>48,633,621</b>

Burimi: Drejtoria Financës dhe Buxheti Bashkia Mirditë

Nga të dhënat e mësipërme konstatohet se detyrimet për investime zënë pjesën më të madhe të detyrimeve të prapambetura 75% të vlerës së detyrimeve totale. Këtu sqarojmë se ne detyrimet e investimeve është përfshirë edhe investimi me fondet e e AKUM në vlerën 25, 423,657 lekë e cila zë pjesën më të madhe të detyrimeve për investime.

Vlera neto e detyrimeve të prapambetura nga fondet e Bashkisë (të ardhurat e Bashkisë +transfera e pakushtëzuar) është (48,633,621- 25,423,657) = **23,209,964 lekë.**



## KONTROLI I LARTË I SHTETIT

### Raport auditimi mbi auditimin e ushtruar në Bashkinë Mirditë me objekt "Auditim financiar"

Lista analitike e detyrimeve të prapambetura më 31.12.2021, paraqitet në rubrikën e anekseve, aneksi nr.1, pika 2/4; 2, pika 2/4 bashkëngjitur këtij akti konstatimi.

Nga auditimi pasqyrave financiare të vitit 2021 konstatohet se vlera e llogarisë 520 ó Disponibilitete në thesar (e cila tregon fondet e pa shpenzuara gjatë vitit 2021, të cilat kalojnë për përdorim në vitin 2022), ka vlerën 24,199,010 lekë.

Tabela në vijim:

Subjekti	Vlera e kredisë (detyrimit) më 31.12.2021	Fondet e trashëguara në 31.12.2021 për vitin 2022 (Llog. 520 në bilanc)	Diferenca fonde të trashëguara (Llog. 520 në bilanc) me vlerën e detyrimit në fund të vitit
Bashkia Mirditë	48,633,621	402,135,925	353,502,304

Burimi: Drejtoria Financës dhe Buxhetit Bashkia Mirditë

Nga auditimi konstatohet se fondet e trashëguara janë në vlerë shumë të lartë në krahasim me detyrimet por ky trashëgim analitikisht është si më poshtë:

-Fonde të trashëguara të Rindërtimit.....375,135,925 lekë (të ngurtësuar me vkm 345 datë. 10.06.2021; vkm 527, datë. 22.09.2021)

Të dhënat e detyrimeve të prapambetura më 31.12.2019 sipas burimit të financimit, paraqiten si më poshtë:

Sipas (bilancit) akt rakordimit me Thesarin:

Viti 2021 Bashkia Mirditë në 000/lekë								Nga totali i detyrimeve:		
Investime				Mallra dhe shërbime			Vendime gjyqësore	Totali detyrimeve në 31.12.2021	Pjesa që i përket Grantit Qeveritar +AKUM	Pjesa që i përket të ardhurave+ TRANSF E Pakushtëzuar
Pjesa që i përket të ardhurave	Investime nga AKUM	Investime nga buxheti i shtetit Transf pakusht +ardh Bashkisë	Detyrimi total për investimet	Pjesa që i përket Grantit Qeveritar	Pjesa që i përket të ardhurave	Detyrimi total për mallra				
0	25,424	10,944	36,368	0	12,266	12,266	0	48,634	25,424	23,210

Burimi: Drejtoria Financës dhe Buxhetit Bashkia Mirditë

Sipas të dhënave të drejtorisë së buxhetit të Bashkisë Mirditë, shuma e detyrimeve prej 48, 634 mijë lekë në fund të vitit 2021, është krijuar për këto arsye:

1-Mosrealizimi i të ardhurave sipas planit të fillim vitit te miratuar dhe planifikuar në buxhet.

2-Planifikimi i kontratave të investimeve dhe shërbimeve në dy vite buxhetimi, ku punimet dhe shërbimet janë kryer brenda vitit të parë të buxhetimit, për rrjedhojë janë prerë faturat tatimore dhe regjistruar si detyrime të prapambetura në sistemin e thesarit.

3-Mungesë fondesh nga AKUM

Risqet buxhetore nga niveli i faturave të pa likuiduara të investimeve për periudhën raportuese viti 2021 janë konstatuar për objektet;

**a**-T vsh blerje automjet teknologjikë, Bashkia Mirditë në vlerën 1,977,780 lekë (buxheti i bashkisë)

**b**-Objekte arsimore 10% e vlerës së kontratës (5,112,170+3,232,701) = 8,344,871 lekë (buxheti i bashkisë).

**AKUM.**

a)Ndërtimi i ujësjellësit Rubik, bashkia Mirditë..... 25,423,657 lekë



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport auditimi mbi auditimin e ushtruar në Bashkinë Mirditë me objekt “Auditim financiar”

Risqet buxhetore nga niveli i faturave të pa likuiduara të shpenzimeve operative për periudhën raportuese viti 2021 janë konstatuar për objektet kryesisht.

-Kontrata e shërbimit të mirëmbajtjes së sipërfaqeve të gjelbërimit sipas aneksit 2, pika 2.4 nr rendor 4, në shumën 2,718,316 lekë.

-Kontrata karburanti sipas aneksit 2, pika 2.4 nr rendor 32, në shumën 2,746,000 lekë.

-Kontrata e druve të zjarrit sipas aneksit 2, pika 2.4 nr rendor 40, në shumën 2,321,280 lekë

Nga auditimi u konstatua se nuk kishte detyrime të prapambetura për vendimet gjyqësore

-Theksojmë se detyrimet e prapambetura nga viti 2019 në vitin 2021 kanë ulje të ndjeshme.

Bashkia Mirditë rezulton se për periudhën raportuese ushtrimore 2019-2020-2021 nuk ka detyrime të prapambetur ndaj DRT Lezhë në lidhje me kontributet për sigurimet shoqërore e shëndetësore. Vlera dhe përqindja e mbulimit të shpenzimeve totale me të ardhurat e veta të njësisë vendore për periudhën raportuese viti 2019-2020-2021.

në/000 lekë

Emërtimi	Shpenzimet faktike viti 2019 (Pa Nd Ekonomike dhe PAK)				
	Vlera e shpenzimit vjetor	Transferata e pakushtëzuar dhe specifike	Transferata e kushtëzuar	Të ardhurat e veta	% që zënë burimet e veta tek totali i shpenzimeve
230- Projekte	0	0	0	0	0%
231-Investime	294,689	63,003	231,686	0	0.00%
600-Paga	195,352	171,932	5,983	17437	8.93%
601-Sigurime shoqërore	32,852	29,095	1032	2725	8.29%
602-Shp.operative	88,553	49,713	3043	35,797	40.42%
604;6096Transferata korente	1,639	0	1,639	0	0.00%
603- Subvencione	0	0	0	0	0.00%
<b>Total</b>	<b>613,085</b>	<b>313,743</b>	<b>243,383</b>	<b>55,959</b>	<b>9.13%</b>
Emërtimi	Shpenzimet faktike viti 2020 (Pa Nd Ekonomike dhe PAK)				
	Vlera e shpenzimit vjetor	Transferata e pakushtëzuar dhe specifike	Transferata e kushtëzuar	Të ardhurat e veta	% që zënë burimet e veta tek totali i shpenzimeve
230- Projekte	0	0	0	0	0%
231-Investime	214,813	44,911	169,402	500	0.23%
Rindërtim	46,079	0	46,079	0	0.00%
600-Paga	197,199	178,641	4,602	13956	7.08%
601-Sigurime shoqërore	32,205	31,252	953	0	0.00%
602-Shp.operative	111,524	80,319	1984	29,221	26.20%
604;6096Transferata korente	9,007	3,252	5,740	15	0.17%
603- Subvencione	0	0	0	0	0.00%
<b>Total</b>	<b>610,827</b>	<b>338,375</b>	<b>228,760</b>	<b>43,692</b>	<b>7.15%</b>
Emërtimi	Shpenzimet faktike viti 2021 (Pa Nd Ekonomike dhe PAK)				



## KONTROLLI I LARTË I SHETIT

### Raport auditimi mbi auditimin e ushtruar në Bashkinë Mirditë me objekt “Auditim financiar”

	<i>Vlera e shpenzimit vjetor</i>	<i>Transferata e pakushtëzuar dhe specifike</i>	<i>Transferata e kushtëzuar</i>	<i>Të ardhurat e veta</i>	<i>% që zënë burimet e veta tek totali i shpenzimeve</i>
230- Projekte	0	0	0	0	0%
231-Investime	91,370	56,261	25,200	9,909	10.84%
Rindërtimi	187,590	0	187,590	0	0.00%
600-Paga	205,772	186,858	6,436	12478	6.06%
601-Sigurime shoqërore	34,314	33,390	924	0	0.00%
602-Shp.operative	85,278	48,561	2655	34,062	39.94%
604;6096Transferua korente	11,848	5,529	6,319	0	0.00%
603- Subvencione	0	0	0	0	0.00%
<b>Total</b>	<b>616,172</b>	<b>330,599</b>	<b>229,124</b>	<b>56,449</b>	<b>9.16%</b>

Burimi: Drejtoria Financës dhe Buxhetit Bashkia Mirditë

#### **Titulli i gjetjes 2:** Mos marrja e masave të duhura për uljen e vlerës së detyrimeve të prapambetura

**Situata:** Nga Bashkia Mirditë nuk janë marrë masa të plota për uljen e vlerës së detyrimeve të prapambetura.

Bazuar në aktin e rakordimit me degën e thesarit dhe të dhënat e kontabilitetit, detyrimet e prapambetura më 31.12.2019 kanë vlerën 73,027,330 lekë, në 31.12.2020 është 66,194,216 lekë dhe në 31.12.2021 është 48,633,621 lekë. Kjo situatë tregon se vlera e faturave të pa likuiduara nga ana e Bashkisë Mirditë vjen duke u ulur.

Detyrimet e prapambetura kanë si burim financimi të ardhurat e veta të Bashkisë Mirditë.

**Kriteri:** Marrja e angazhimeve buxhetore pa pasur fonde në dispozicion dhe krijimi i detyrimeve të prapambetura është në kundërshtim me kërkesat e UMF nr. 5, datë 27.12.2014 për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura, Udhëzimi MFE Nr. 4, datë 25.01.2021 për zbatimin e buxhetit të vitit 2021 si dhe me nenin 52 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, ku thuhet: Shpenzimet, që rezultojnë nga angazhime të marra përsipër gjatë viteve të mëparshme, në përputhje me dispozitat e veçanta të ligjit të buxhetit vjetor, përfshihen në buxhetin e vitit pasardhës.

**Ndikimi/Efekti:** Likuidimi jo në kohë të detyrimeve të prapambetura, përveçse është moszbatim i kuadrit rregullator në fuqi, e vë nënshprehje vendore në kushtet e palës përgjegjëse ndaj kreditorëve. Ndodhur në kushtet kur shkelur marrëveshja e përcaktuar në kontratë me kreditorët për afatin e kryerjes së këtyre pagesave, krijohen premisa që kreditorët nëpërmjet proceseve gjyqësore, përveç vlerës së detyrimit sipas situacionit dhe kontratës, të kërkojnë edhe përqindje të interesave etj., gjë e cila rrit kostot financiare në mënyrë artificiale.

**Shkaku:** Mos vendosja e fondeve buxhetor në masën e duhur në likuidimin e detyrimeve të prapambetura, si dhe krijimi i detyrimeve të reja gjatë vitit buxhetor.

**Rëndësia:** I mesëm

**Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Mirditë të analizojë krijimin e vlerës prej 48,633,621 lekë si detyrime të faturave pa likuiduara në datë 31.12.2021, të nxjerr përgjegjësitë, të ndërpresë krijimin



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport auditimi mbi auditimin e ushtruar në Bashkinë Mirditë me objekt “Auditim financiar”

e detyrimeve të prapambetura pa fonde në dispozicion dhe të mos kryejë angazhime të reja buxhetore

#### **Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:**

Për mos marrjen e masave për likuidimin e detyrimeve të prapambetura dhe krijimin e detyrimeve të reja për periudhën 01.01.2019 - 31.12.2021, ngarkohet me përgjegjësi Kryetari i Bashkisë Mirditë z. N. D., në cilësinë e nëpunësit autorizues dhe znj. F. F. , me me detyrë, Drejtore e Financës & Buxhetit.

#### **-Nënpika (2/5). Çelja dhe ekzekutimi i fondeve të përfituara përmes FZHR, saktësia e raportimit buxhetor të tyre;**

Nëpërmjet FZHR;

Për gjatë vitit 2019 treguesit e buxhetit të përfituara përmes alokimit nga FZHR janë të planifikuar në vlerën (178,452+6,344 (punime të kryera) = 184,796 mijë lekë, ndërsa janë realizuar në vlerën 178,452 mijë lekë, ose në masën 96.57%.

Viti 2019

Nr	Emërtimi i objektit	Data e lidhjes së kontratës	Data e përfundimit të objektit	Vlera e kontratës	Vlera e likuiduar e kontratës	Vlera e pa likuiduar e kontratës	Arsyeja e mos likuidimit
1	Rikonstruksion Rruga auto Kthjelle e Eper - Varreza Komuna Selite	nr.88/1 prot. datë 07.09.2012	30.12.2013	27,456,533	1,530,394	0	
2	Sistemim asfaltim rruga auto Troje Komuna Kthjelle	nr.373 prot. datë 10.09.2012	12.12.2013	34,467,155	19,546,481	0	
3	rikonstruksion I plote I pallatit Arjana Arapi rrëshen	nr.4616, dt.23.10.2018	24.08.2019	63,275,876	28,262,914	3,578,433	mungese fondesh
	rikonstruksioni plotei god 1,2,3+ambj sport,shk 9-vjeçare Rrëshen	nr 3073 dt 29.07.2019	30.05.2020	120,918,970	36,917,510	84,001,460	mungese fondi për shumën 1942795 dhe pa përfunduar afati I punimeve pj tj
	rikonstruksioni ,shk 9-vjeçare Pashko Vasa god nr.2, 2kt	nr4175 prot, datë.29.10.2018	29.04.2019	29,588,476	18,018,390	822,608	mungese fondi
	Ndërtim I kopshtit të fëmijëve Rrëshen	4463, dt.17.10.2018	09.06.2019	57,025,710	28,211,035	539,279	pa sjelle fature
	Rehabilitimi rrjetit ujitës te rezervuarit Malaj -2 (faza III)	NR . 3196 DT 06.08.2019	05.02.2020	47,196,085	19,983,438	27,199,927	pa përfunduar afati i punimeve
	Rikonstruksion , sistem ngrohje, palestër dhe sistemim ambientit shkolla e mesme Ndrec Ndue Gjoka Fan Mirdite	NR. 3072 dt 29.07.2019	24.01.2020	69,805,421	25,982,152	43,823,269	pa përfunduar afati i punimeve

**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT****Raport auditimi mbi auditimin e ushtruar në Bashkinë Mirditë me objekt “Auditim financiar”**

<b>Totali</b>	449,734,226	178,452,314	159,964,976
---------------	-------------	-------------	-------------

*Burimi: Drejtoria Financës dhe Buxhetit Bashkia Mirditë*

Për gjatë vitit 2020 treguesit e buxhetit të përfituara përmes alokimit nga FZHR janë të planifikuar në vlerën 138,449 mijë lekë, ndërsa janë realizuar në vlerën 138,449 mijë lekë, ose në masën 100%. Këtu sqarohet se vlera e pa likuiduar e kontratave është e planifikuar nga buxheti i Bashkisë sipas vendimit të FZHR, në të cilat përcaktohet se vlera 10% e kontratës do të shlyhet nga fondet e njësisë vendore.

Viti 2020

Nr	Emërtimi i objektit	Data e lidhjes së kontratës	Data e përfundimit të objektit	Vlera e kontratës	Vlera e likuiduar e kontratës	Vlera e pa likuiduar e kontratës	Arsyeja e mos likuidimit
3	rikonstruksion i plote i pallatit A. A.Rrëshen	nr.4616, dt.23.10.2018	24.08.2019	63,275,876	2,845,521	732,912	mungese fondesh
	Rikonstruksioni plotë god 1,2,3+ambj sport,shk 9-vjeçare Rrëshen	nr 3073 dt 29.07.2019	30.05.2020	120,918,970	71,797,940	12,203,520	mungese fondi
	Rikonstruksioni ,shk 9-vjeçare Pashko Vasa god nr.2, 2kt	nr4175 prot, datë.29.10.2018	29.04.2019	29,588,476	0	822,608	mungese fondi
	Ndërtim i kopshtit të fëmijëve Rrëshen	4463, dt.17.10.2018	09.06.2019	57,025,710	0	539,279	mungese fondi
	Rehabilitimi rrjetit ujëtës te rezervuarit Malaj -2 (faza III)	NR . 3196 DT 06.08.2019	05.02.2020	47,196,085	27,199,927	0	
	Rikonstruksion , sistem ngrohje, palestër dhe sistemim ambientit shkolla e mesme Ndreç Ndue Gjoka Fan Mirdite	NR. 3072 dt 29.07.2019	24.01.2020	69,805,421	36,606,005	7,215,524	mungese fondi
<b>Totali</b>				387,810,538	138,449,393		

Për gjatë vitit 2021 treguesit e buxhetit të përfituara përmes alokimit nga FZHR janë të planifikuar në vlerën 138,449 mijë lekë, ndërsa janë realizuar në vlerën 138,449 mijë lekë, ose në masën 100%. Këtu sqarohet se vlera e pa likuiduar e kontratave është e planifikuar nga buxheti i Bashkisë sipas vendimit të FZHR, në të cilat përcaktohet se vlera 10% e kontratës do të shlyhet nga fondet e njësisë vendore.

Viti 2021

Nr	Emërtimi i objektit	Data e lidhjes së kontratës	Data e përfundimit të objektit	Vlera e kontratës	Vlera e likuiduar e kontratës	Vlera e pa likuiduar e kontratës	Arsyeja e mos likuidimit
3	Rikonstruksion i plotë i pallatit A. A.Rrëshen	nr.4616, dt.23.10.2018	24.08.2019	63,275,876	732,912	0	



## KONTROLLI I LARTË I SHËTETIT

### Raport auditimi mbi auditimin e ushtruar në Bashkinë Mirditë me objekt “Auditim financiar”

rikonstruksioni plotë i god 1,2,3+ambj sport,shk 9-vjeçare Rrëshen	nr 3073 dt 29.07.2019	30.05.2020	120,918,970	7,092,479	5,111,028	mungese fondi
Rikonstruksioni shk 9-vjeçare Pashko Vasa god nr.2, 2kt	nr4175 prot, datë.29.10.2018	29.04.2019	29,588,476	822,608	0	
Ndërtim i kopshtit të fëmijëve Rrëshen	4463, dt.17.10.2018	09.06.2019	57,025,710	539,279	0	
Rikonstruksion , sistem ngrohje, palestër dhe sistemim ambjenti shkolla e mesme Ndreç Ndue Gjoka Fan Mirdite	NR. 3072 dt 29.07.2019	24.01.2020	69,805,421	3,980,542	3,234,982	mungese fondi
<b>Totali</b>			340,614,453	13,167,820		

**Konkluzion:** -Mos shlyerja në kohë e detyrimeve ndaj të tretëve paraqet rrishtë për buxhetin e vitit në vazhdim të njësisë vendore, pasi një pjesë e buxhetit të kësaj njësie do të përdoret jo për të financuar nevojat reale të vitit buxhetor, por për të likuiduar detyrimet e prapambetura, duke zvogëluar fondet në dispozicion për investime dhe shpenzime të tjera në interes të komunitetit.

-Në të gjitha dokumentet e PBA-ve vihet re një përqindje e lartë ndaj totalit të buxhetit, në zërin ÷Paga dhe sigurime, që janë shpenzime për personelin në llogarinë (600-601).

Që kjo përqindje të ulet dhe të rritet përqindja e investimeve si një zë që ka impakt direkt në komunitetin e njësisë së qeverisjes vendore, Bashkia Mirditë.

**Nënpika 2/6 Niveli i realizimit të të ardhurave dhe mënyra e përdorimit të tyre. Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore dhe borxhi tatimor.**

**Titulli i gjetjes 3:** Mos arkëtimi për tarifata nga subjektet që tregtojnë karburante për konsumatorët fundorë

**Situata:** Sipas dokumentacionit të paraqitur nga Drejtoria e Taksave të të Ardhurave Vendore në lidhje me subjektet e tregimit të karburanteve që ushtrojnë aktivitet me seli në territorin e Bashkisë Mirditë dhe në Njësitë Administrative në vartësi Rrëshen, Rubik, Kthell, Than, Oroshi, Kaçinar dhe Selitë na u vunë në dispozicion 14 dosje të subjekteve që ushtrojnë aktivitet në tregtimin e karburanteve dhe njësitë e shitjes së lëndëve djegëse për konsumatorët fundorë, ku rezultoi: Subjektet “K.” shpk me nipt L07.....01S me afat 08.05.2016-08.05.2021, subjekti “L.” shpk me nipt K38.....18A, subjekti “K.” shpk me nipt J61.....29P me afat 05.05.2020-05.05.2025, subjekti “K.” shpk me nipt J69.....23D me afat 18.07.2017-18.07.2022, subjekti “K.” me nipt L618.....6J me afat 19.09.2016-19.09.2021, subjekti “T.” shpk me nipt K09.....12Ë me afat 05.10.2020-05.10.2025, subjekti “D.” shpk me nipt L51.....15E me afat 08.04.2015-12.05.2020, subjekti “A.” me nipt K38.....21C me afat 12.11.2016-12.11.2021, subjekti “Xh.O” shpk me nipt L69.....01M me afat 30.07.2020-30.07.2025, subjekti “N.K” me nipt L49.....01C me afat 07.05.2015-07.05.2020, subjekti “E.” shpk me nipt L09.....02D me afat 22.11.2016-22.11.2021, subjekti “O.” me nipt J34.....3I me afat 15.11.2021-15.11.2026,





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport auditimi mbi auditimin e ushtruar në Bashkinë Mirditë me objekt “Auditim financiar”

subjekti “N.T. O” me nipt L 284.....01T me afat 10.11.2017-10.11.2022 dhe subjekti “D. B.O.shpk” me nipt L88.....02O me afat 28.02.2018-28.02.2023. Gjithashtu nga Drejtoria e Taksave të të Ardhurave Vendore na u paraqit dhe lista e subjekteve që ushtrojnë aktivitet në tregtimin e karburanteve dhe njësitë e shitjes së lëndëve djegëse për konsumatorët fundorë, por për këto subjekte nuk kishte dokumentacion (dosje), regjistër për evidentimin e tyre, ku nuk janë zbatuar “Procedura për Dhënien e Licencave për Tregtimin me Pakicë të Karburanteve, Gazit të Lëngshëm të Naftës, për Automjetet, Vajrave Lubrifikante dhe Lëndëve Djegëse për Përdorim nga Konsumatorët Fundorë” 1. Dhënia e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve, për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, e vajrave lubrifikante dhe të njësive të lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë, bëhet nga: b) Organet e qeverisjes vendore, sipas juridiksionit përkatës, në rastet kur stacionet e shitjes së karburanteve, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të karburanteve për automjete, gazit të lëngshëm e vajrave lubrifikante dhe të njësive të shitjes së lëndëve djegëse, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të tyre për përdorim nga konsumatorët fundorë, do të ndërtohen në territoret e tjera.

- a) Ekstraktin historik dhe tregtar të regjistrit tregtar, nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit, ku në objekt të ketë të përcaktuar veprimtarinë e tregtimit të nënprodukteve të naftës bruto;
- c) Certifikatën e përdorimit të objektit, të lëshuar nga institucionet përkatëse, sipas legjislacionit në fuqi për planifikimin e territorit;
- ç) Vërtetimin për kontrollin e objektit, për respektimin e kushteve teknike, të lëshuar nga Inspektorati Shtetëror Përgjegjës; dh) Lejen e mjedisit, sipas legjislacionit në fuqi për mjedisin; e) Autorizimin hyrje-dalje në rrugë, të lëshuar nga enti pronar i rrugës; ë) Regjistrimin e markës tregtare pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Markave dhe Patentave; f) Vërtetimin e shlyerjes së detyrimeve vendore; g) Vërtetimin e shlyerjes së detyrimeve tatimore, përfshirë sigurimet shoqërore.

3. Dhënia e licencave për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse, për veprimtarinë e tregtimit për përdorim nga konsumatorët fundorë, bëhet nga organet e qeverisjes vendore. Personi juridik, që kërkon të pajiset me këtë licencë, duhet të paraqesë, në njësitë e qeverisjes vendore, dokumentet e përcaktuara në shkronjat òaò, òcò, òçò e òdhò, të pikës 2, të këtij kreu, si dhe certifikatën e kalibrimit të enëve dhe të aparateve të shitjes, të lëshuar nga organet e metrologjisë e të kalibrimit.

4. Organet që kanë përgjegjësi për dhënien e licencave, sipas këtij kreu, ushtrojnë kontroll për të dhënat dhe treguesit e paraqitur në dokumentacionin e personit juridik kërkues.

Në mënyrë të përmbledhur paraqiten në pasqyrën në vijim për subjektet të tregtimit të karburanteve, detyrimet, arkëtimet dhe vlera e tarifës së pa likuiduar, të cilat nuk janë pajisur me autorizime/licenca për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe për dhënien dhe përsëritjen e licencës për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë.



## KONTROLI I LARTË I SHTETIT

### Raport auditimi mbi auditimin e ushtruar në Bashkinë Mirditë me objekt “Auditim financiar”

Në vijim paraqiten subjektet sipas vendndodhjes ku ushtrojnë aktivitetin e tyre të biznesit dhe nipti përkatës, për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë të Bashkisë Mirditë sipas aneksit nr.2.2/6/1

Në mënyrë të përmbledhur paraqiten në pasqyrën në vijim për subjektet të tregtimit të karburanteve, detyrimet, arkëtimet dhe vlera e tarifës së pa likuiduar, të cilat nuk janë pajisur me autorizime/licenca për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe për dhënien dhe përsëritjen e licencës për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë.

-Të gjitha subjektet që tregtojnë karburante të aplikohet tarifa për pajisjen me leje/autorizim tregtimi ose të pezullojnë aktivitetin deri në pajisjen me lejen/autorizimin e nevojshëm për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm, lëndëve djegëse.

-Bashkia Mirditë të marrë masa për të krijuar një regjistër të posaçëm për këtë kategori biznesesh. Nga moszbatimi VKM nr. 970, datë 2.12.2015 òPër përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të sajë i ndryshuar me VKM nr. 344, datë 19.04.2017, òPër disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.970, datë 2.12.2015, të Këshillit të Ministrave, òPër përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të sajë kapitulli II, pika 1; germa òbö, dhe pika 9, këto subjekte të trajtuara në aneksin nr.2.2/6/2, kanë sjell të ardhura të munguara, të pa planifikuar për buxhetin e Bashkisë Mirditë, në vlerën 13,000,000 lekë.

**Kriteri:** 1) Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 òPër Sistemin e Taksave Vendoreë, i ndryshuar neni 35.

2)VKM nr. 970, datë 2.12.2015 òPër përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të sajë i ndryshuar kapitulli II, pika 1; germa òbö, dhe pika 9.

3)VKM nr. 344, datë 19.04.2017, òPër disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.970, datë 2.12.2015, të Këshillit të Ministrave, òPër përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të sajë, kapitulli II, pika 1; germa òbö dhe pika 9.

**Ndikimi/Efekti:** -Mungesa e të ardhurave për realizimin e shërbimeve dhe investimeve.

**Shkaku:** Nga mos funksionimin i detyrave dhe kompetencat përkatëse në mos zbatimin e ligjit, për arkëtimin e kësaj tarife nga ana e Bashkisë.

**Rëndësia:** I mesëm

**Rekomandimi:** Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore e Bashkisë Mirditë, të marrë masa për arkëtimin e vlerës debitore prej 10,000,000 lekë krijuar nga 13 subjektet (sipas listës në aneksin nr.2.2/6/2, bashkangjitur raportit të auditimit) për mospagimin e taksës për licencën e tregtimit të naftës bruto dhe nënprodukteve të sajë.

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:**

Z. T. P.me detyrë Përgjegjës Sektori Transporti&Autorizim Licencash (NC)

Paraqitur me shkresën me nr. 1062 prot, datë 04.03.2022 ( Bashkisë Mirditë) dhe të KLSH-së nr. 52/2 prot., datë 15/03/2022 nga ana e z. T. P.

**Pretendimi i subjektit:**



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport auditimi mbi auditimin e ushtruar në Bashkinë Mirditë me objekt “Auditim financiar”

1. Për 5 subjekte kanë bërë arkëtimet si më poshtë;

Subjekti òD.ò SHPK ka arkëtuar 200,000 lekë

Subjekti òD.B.O.ò ka arkëtuar 200,000 lekë

Subjekti òO.ò shpk ka arkëtuar vlerën 1,000,000 lekë

Subjekti òK.ò ka arkëtuar vlerën 800,000 lekë

Subjekti òK.ò ka arkëtuar vlerën 800,000 lekë

Subjektet kanë njohur detyrimin dhe kanë filluar likuidimin e detyrimit dhe do të arkëtohen për një periudhë 6-mujore pasi po shohim dhe gjendjen financiare dhe periudhën që po kalojnë.

#### **Qëndrimi i Grupit të auditimit:**

*1-Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, sqarojmë se pretendimet tuaja do të merren pjesërisht në konsideratë dhe për subjektet që kanë arkëtuar detyrimet do të trajtohen në projektraportin. Për subjektin “K.” që ju pretendoni që janë arkëtuar 800,000 lekë dhe kjo vlerë nuk do të merret parasysh., ku nuk del e qartë që janë arkëtuar, prandaj paraqisin mandat pagesën nga ana e bankës me datë e vulë.*

*2-Nga ana juaj duhet të merren masa deri në likuidimin e plotë të subjekteve që operojnë në këtë fushë në zbatim në zbatim VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të sajë, i ndryshuar me VKM 344, datë 19.04.2017, kapitulli II, pika 1; germa “b” dhe pika 9, për subjektet e tregtimit me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë.*

**Titulli i gjetjes 4:** Mos arkëtim për tarifën e pastrimit, ndriçimit dhe tarifën e gjelbërimit për subjektet e ndërtimit të cilat kanë kryer punime ndërtimi dhe janë shpallur fitues në procedurat e prokurimit.

**Situata:** Nga auditimi i subjekteve të ndërtimit të cilat kanë kryer punime dhe janë shpallur fitues në procedurat e prokurimit me fonde publike në territorin e Bashkisë Mirditë dhe Njësi Administrative në vartësi për periudhën 2019, 2020 dhe 2021, për tarifën vendore, në bazë të paketës fiskale me vendim nr.135 datë 30.11.2018, vendimi nr.40 datë 26.11.2019 dhe vendimi nr.110 datë 20.11.2020 *òPër Miratimin e Paketës Fiskale Vendoreò*. Bazuar në evidencën e prokurimeve ku subjektet që janë kualifikuar si oferta e vlefshme dhe kanë lidhur kontrata për kryerjen e punimeve në territorin e Bashkisë janë të pasqyruara në aneksin e mëposhtëm. Nga auditimi i dokumentave këto subjekte nuk kishin paguar tarifën vendore si e pastrimit, gjelbërimin e ndriçimit.

Nga Drejtoria e Taksave të Ardhurave Vendore Bashkia Mirditë, nuk është vepruar, për të aplikuar dhe arkëtuar tarifën e pastrimit, të ndriçimit dhe tarifën e gjelbërimit për subjektet e ndërtimit të cilat kanë kryer punime ndërtimi dhe janë shpallur fitues në procedurat e prokurimit me fonde publike, për periudhën e auditimit 2019-2021 sipas paketës fiskale Vendimit të Këshillit të Bashkisë Mirditë me vendim nr.135 datë 30.11.2018, vendimi nr.40 datë 26.11.2019 dhe vendimi nr.110 datë 20.11.2020 *òPër Miratimin e Paketës Fiskale Vendoreò*, dhe Ligji nr. 9920 datë 19.05.2008 *òPër procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisëò* i ndryshuar, neni 43 pika 1/1 dhe udhëzimit përkatës nr.24, datë 02.09.2008 i ndryshuar 43.1.1 Këto subjekte janë debitorë në vlerën 1,677,000 lekë, gjë që ka sjellë të ardhura të munguara për Bashkinë Mirditë.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport auditimi mbi auditimin e ushtruar në Bashkinë Mirditë me objekt “Auditim financiar”

**Kriteri:** 1) Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 òPër sistemin e taksave vendoreò i ndryshuar, Kreut VII, nenit 35

2) Ligji nr. 9920 datë 19.05.2008 òPër procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisëò i ndryshuar, neni 43 pika 1/1 dhe udhëzimit përkatës nr.24, datë 02.09.2008 i ndryshuar 43.1

3) Vendimit të Këshillit të Bashkisë Mirditë nr.135 datë 30.11.2018, vendimi nr.40 datë 26.11.2019 dhe vendimi nr.110 datë 20.11.2020 òPër Miratimin e Paketës Fiskale Vendoreò.

**Ndikimi/Efekti:** -Mungesa e të ardhurave për realizimin e shërbimeve dhe investimeve në bashki.

**Shkaku:** Nga mos funksionimin i detyrave dhe kompetencat përkatëse dhe në mos zbatimin e ligjit, për arkëtimin e kësaj tarife nga ana e kësaj drejtorie.

**Rëndësia:** I mesëm

**Rekomandimi:** Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Mirditë, të marrë masa të menjëhershme për arkëtimin e vlerës 1,677,000 lekë, nga subjektet të cilat kanë zhvilluar aktivitetet dhe kanë lidhur kontratë me Bashkinë Mirditë, për arsye të shpalljes fitues në procedurat e prokurimit publik, sipa aneksit nr.2.2/6/2 bashkangjitur raportit të auditimit.

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:**

Z.Gj. R., me detyrë inspektor taksash terreni nga periudha 13.07.2007 e në vazhdim (NC)

Z.V. T., me detyrë inspektor taksash dhe terreni nga periudha 16.03.2002 e në vazhdim (NC)

Z.K.M., me detyrë specialist për kontrollin dhe mbledhjen e të ardhurave nga periudha 31.08.2020 e në vazhdim (NC)

Z.J. P., me detyrë inspektor taksash nga periudha 18.06.2015 e në vazhdim (NC)

Paraqitur me shkresën me nr. 1062 prot, datë 04.03.2022 ( Bashkisë Mirditë) dhe të KLSH-së nr. 52/2 prot., datë 15/03/2022 nga ana e z. Gj. R., z.V. T., z.K. M. dhe z.J. P.

#### **Pretendimi i subjektit:**

-Nga bashkia Mirditë është aplikuar hedhja e faturës për subjektet që kanë hapur NIPT sekondar, por jo në bazë të numrit të kontratave të lidhura gjatë vitit kalendarik.

Sqarojmë se ;

Në bazë të paketave fiskale të viteve 2019,2020 dhe 2021, subjektet që janë me seli në bashkinë mirditë paguajnë taksa dhe tarifa fikse dhe jo në bazë të kontratave të prokurimit që janë lidhur në këtë bashki.

Ne si inspektor terreni kemi verifikuar të gjitha subjektet që janë me seli në këtë bashki dhe në bazë të paketës fiskale dhe detyrimeve ligjore do të ndjekim procedurat e përcaktuara me ligj për vjeljen e detyrimeve.

#### **Qëndrimi i Grupit të auditimit:**

*1-Në lidhje me komentet e bëra nga ana e inspektorëve të taksave dhe tarifave vendore të Bashkisë Mirditë sqarojmë se;*

*Pretendimet tuaja nuk do të merren parasysh, pasi është detyrim ligjor që ju të bëni evidentimin e të gjitha subjekteve që operojnë në bashkinë tuaj për regjistrimin e biznesit në zbatim të ligjit nr.9920 datë 19.05.2008 i ndryshuar neni 43 pika 1/1 dhe Udhëzimit nr.24, datë 02.09.2008 i ndryshuar, neni 43/1/1 “Në përputhje me ligjin për regjistrimin e biznesit, aplikimi për ndryshimin e selisë dhe hapja e vendeve të tjera të ushtrimit të veprimtarisë, të ndryshme nga selia, në çdo rast bëhen përpara nisjes efektive të veprimtarisë në atë vend. Për hapjen e vendeve të tjera të ushtrimit të veprimtarisë, të ndryshme nga selia, tatimpaguesi pajiset me një certifikatë, me numër unik identifikimi të njëjtë me atë të regjistrimit, por me numër serial të ndryshëm. Kjo certifikatë*



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport auditimi mbi auditimin e ushtruar në Bashkinë Mirditë me objekt “Auditim financiar”

*lëshohet për të identifikuar vendndodhjen e ushtrimit të veprimtarisë, kur është e ndryshme nga selia”kontraktori përpara fillimit të punimeve duhet të aplikojë në QKB për hapjen e vendit të ushtrimit të veprimtarisë të ndryshëm nga selia (sipas vendndodhjes të objektit të kontratës) dhe Vendimit të Këshillit të Bashkisë Mirditë nr.135 datë 30.11.2018, vendimi nr.40 datë 26.11.2019 dhe vendimi nr.110 datë 20.11.2020 “Për Miratimin e Paketës Fiskale Vendore”.*

Paraqitur me shkresën me nr. 356/13 prot, datë 21.04.2022 (Bashkisë Mirditë) nga ana e z. Gj. R., z.V.T., z.K. M. dhe z.J. P..

#### **Pretendimi i subjektit:**

-Nga bashkia Mirditë është aplikuar hedhja e faturës për subjektet që kanë hapur NIPT sekondar, por jo në bazë të numrit të kontratave të lidhura gjatë vitit kalendarik.

Sqarojmë se ;

Në bazë të paketave fiskale të viteve 2019,2020 dhe 2021, subjektet që janë me seli në bashkinë mirditë paguajnë taksa dhe tarifa fikse dhe jo në bazë të kontratave të prokurimit që janë lidhur në këtë bashki.

Ne si inspektor terreni kemi verifikuar të gjitha subjektet që janë me seli në këtë bashki dhe në bazë të paketës fiskale dhe detyrimeve ligjore do të ndjekim procedurat e përcaktuara me ligj për vjeljen e detyrimeve.

#### **Oëndrimi i Grupit të auditimit:**

*1-Në lidhje me komentet e bëra nga ana e inspektorëve të taksave dhe tarifave vendore të Bashkisë Mirditë sqarojmë se;*

*Pretendimet tuaja nuk do të merren parasysh, pasi është detyrim ligjor që ju të bëni evidentimin e të gjitha subjekteve që operojnë në bashkinë tuaj për regjistrimin e biznesit në zbatim të ligjit nr.9920 datë 19.05.2008 i ndryshuar nenit 43 pika 1/1 dhe Udhëzimit nr.24, datë 02.09.2008 i ndryshuar, neni 43/1/1 “Në përputhje me ligjin për regjistrimin e biznesit, aplikimi për ndryshimin e selisë dhe hapja e vendeve të tjera të ushtrimit të veprimtarisë, të ndryshme nga selia, në çdo rast bëhen përpara nisjes efektive të veprimtarisë në atë vend. Për hapjen e vendeve të tjera të ushtrimit të veprimtarisë, të ndryshme nga selia, tatimpaguesi pajiset me një certifikatë, me numër unik identifikimi të njëjtë me atë të regjistrimit, por me numër serial të ndryshëm. Kjo certifikatë lëshohet për të identifikuar vendndodhjen e ushtrimit të veprimtarisë, kur është e ndryshme nga selia”kontraktori përpara fillimit të punimeve duhet të aplikojë në QKB për hapjen e vendit të ushtrimit të veprimtarisë të ndryshëm nga selia (sipas vendndodhjes të objektit të kontratës) dhe Vendimit të Këshillit të Bashkisë Mirditë nr.135 datë 30.11.2018, vendimi nr.40 datë 26.11.2019 dhe vendimi nr.110 datë 20.11.2020 “Për Miratimin e Paketës Fiskale Vendore”.*

**Titulli i gjetjes 5:** Mos arkëtimi i kontratave të qirave të lidhura ndërmjet subjekteve me asetet e Bashkisë Mirditë.

**Situata:** Bashkia Mirditë ka lidhur kontrata qiraje me subjekte të ndryshëm për dhënien e aseteve në pronësi të saj, kontrata për kullotë nga fondi pyjor e kullosor, antena, hec etj në bazë të ligjeve nr. 139, datë 17.12.2015 òPër vetëqeverisjen vendore, ligji 7850 datë 29.07.1994 òKodi Civil Republikës Shqipërisë i ndryshuar, ligji nr. 57 datë 30.04.2020 òPër pyetë, ligji nr. 9632 datë 30.12.2006 òPër sistemin e taksave vendore në Republikës Shqipërisë i ndryshuar, ligji nr. 9920 datë 15.09.2008 òPër procedurat tatimore në Republikës Shqipërisë i ndryshuar, VKM nr. 433 datë



## KONTROLLI I LARTË I SHPETIT

### Raport auditimi mbi auditimin e ushtruar në Bashkinë Mirditë me objekt “Auditim financiar”

08.06.2016 òPër transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrimin të Ministrisë së Mjedisit si dhe ish komunave/bashkive, VKM nr. 391, datë 21.06.2006 të Këshillit të Ministrave òPër përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave ò të ndryshuar, Udhëzimi nr. 1 datë 09.06.2016 ò Për rregullat, procedurat e kërkimit të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik.

Nga Drejtoria e Taksave të të Ardhurave Vendore Bashkia Mirditë dhe Agjencia e Shërbimeve Pyjore të bashkërendojnë, për të arkëtuar vlerën vjetore të kontratave të qirave në vit dhe të ushtror të drejtën dhe detyrimet e qiradhënësit për zgjidhjen e njëanshme kur qiramarrësi nuk ka shlyer detyrimet dhe kamatë vonesë prej 0.1% për çdo ditë vonesë, por jo më shumë se 10% e vlerës totale të vlerës së pagesës përkatëse dhe e sanksionuar në kontratë, për periudhën e auditimit 2019-2021.

Nga gjithë puna e bërë nga ana e inspektorëve të taksave e të të ardhurave vendore ka rezultuar në mos arkëtimin në vlerën **14,997,426 lekë, gjë që ka sjellë dëm ekonomik për Bashkinë Mirditë.**

**Kriteri:** VKM nr. 433 datë 08.06.2016 òPër transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrimin të Ministrisë së Mjedisit si dhe ish komunave/bashkive;

VKM nr. 391, datë 21.06.2006 të Këshillit të Ministrave òPër përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave” të ndryshuar;

VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 për disa ndryshime të vendimit nr. 391, datë 21.06.2006 të Këshillit të Ministrave òPër përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave ò të ndryshuar.

**Ndikimi/Efekti:** -Mungesa e të ardhurave për realizimin e shërbimeve dhe investimeve.

**Shkaku:** Nga mos funksionimi i detyrave dhe kompetencat përkatëse në mos zbatimin e ligjit, për arkëtimin e kësaj vlere nga ana e Bashkisë.

**Rëndësia:** I mesëm

**Rekomandimi:** Drejtoria e Taksave të të Ardhurave Vendore dhe Agjencia e Shërbimeve Pyjore Bashkia Mirditë të bashkërendojnë dhe të marri të gjitha masat (administrative dhe gjyqësore), për arkëtimin e vlerës 14,997,426 lekë e 11 kontratave të qirave të operatorëve sipas aneksit nr. II/2/6/1 bashkangjitur raportit përfundimtar të auditimit, gjë që ka sjellë dëm ekonomik.

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:**

Znj. E. D., me detyrë specialiste asetesh në drejtorinë të ardhurave nga periudha 24.05.2017 e në vazhdim (NC).

Paraqitur me shkresën me nr. 1062 prot, datë 04.03.2022 ( Bashkisë Mirditë) dhe të KLSH-së nr. 52/2 prot., datë 15/03/2022 nga ana e znj. E. D.

#### **Pretendimi i subjektit:**

-Subjekti Hec òSh.ò me shumën totale të pa arkëtuar 10,569,197 lekë. Nga viti 2019 deri tani ky subjekt është në proces gjyqësor me banorët e njësisë administrative Kaçinar, ku rrjedhimisht kontrata quhet e pezulluar që me fillimin e procedurave me Prekursorinë dhe procesit gjyqësor.

-Subjekti òP. E.ò me shumën totale e pa likuiduar është 1,776,137 lekë , për këtë subjekt nuk janë marë masat shtrënguese për arsye se subjekti është në proces gjyqësor.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport auditimi mbi auditimin e ushtruar në Bashkinë Mirditë me objekt “Auditim financiar”

- Subjekti Z.Xh. ka rezultuar debitor dhe ka bërë pagesën më datën 01.02.2022 me vlerë 610,471 lekë.
- Subjekti K. ka rezultuar debitor dhe ka bërë pagesën më datën 18.02.2022 me vlerë 405,995 lekë.

#### **Oëndrimi i Grupit të auditimit:**

*Në lidhje me komentet e bëra nga ana e juaj sqarojmë se;*

*1-Pretendimet tuaja nuk do të merren parasysh për subjektin, Hec “Sh.ö për detyrimin e pa likuiduar në vlerën 10,569,197 lekë, pasi është lidhur një kontratë ndërmjet dy palëve përpara një zyre juridike ligjore, ku ka prodhuar një detyrim për të zbatuar dhe nuk jeni ju si bashki që i keni sjellë pengesë këtij subjekti. Nga ana juaj të meren të gjitha masat shtrënguese në bazë të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, kreu XI, Neni 89, 90, 91.*

*2- Pretendimet tuaja nuk do të merren parasysh për subjektin òP. E.ö për detyrimin e pa likuiduar në vlerën 1,776,137 lekë, pasi është lidhur një kontratë ndërmjet dy palëve përpara një zyre juridike ligjore, ku ka prodhuar një detyrim për të zbatuar. Nga ana juaj të meren të gjitha masat shtrënguese në bazë të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, kreu XI, Neni 89, 90, 91.*

*3-Subjekti “Z. Xh.” do të meret parasysh dhe do të trajtohet në projektraport.*

*4-Subjekti “K.” nuk do të meret parasysh, në bazë të dokumenteve të bashkëngjitur në observacion nuk del qartë se për çfarë pagese është paguar.*

Paraqitur me shkresën me nr. 356/12 prot, datë 21.04.2022 ( Bashkisë Mirditë) nga ana e znj. E. D.

#### **Pretendimi i subjektit:**

-Subjekti Hec öSh.ö me shumën totale të pa arkëtuar 10,569,197 lekë. Nga viti 2019 deri tani ky subjekt është në proces gjyqësor me banorët e njësisë administrative Kaçinar, ku rrjedhimisht kontrata quhet e pezulluar që me fillimin e procedurave me Prekursorinë dhe procesit gjyqësor.

-Subjekti òP. E.ö me shumën totale e pa likuiduar është 1,776,137 lekë, për këtë subjekt nuk janë marë masat shtrënguese për arsye se subjekti është në proces gjyqësor.

- Subjekti K. ka rezultuar debitor dhe ka bërë pagesën më datën 18.02.2022 me vlerë 405,995 lekë. Pagesa është bërë me kamata dhe gjoba në vlerën 596,407 lekë.

#### **Oëndrimi i Grupit të auditimit:**

*Në lidhje me komentet e bëra nga ana e juaj sqarojmë se;*

*1-Pretendimet tuaja nuk do të merren parasysh për subjektin, Hec “Sh.ö për detyrimin e pa likuiduar në vlerën 10,569,197lekë, pasi është lidhur një kontratë ndërmjet dy palëve përpara një zyre juridike ligjore, ku ka prodhuar një detyrim për të zbatuar dhe nuk jeni Ju si bashki që i keni sjellë pengesë këtij subjekti. Nga ana juaj të meren të gjitha masat shtrënguese në bazë të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, kreu XI, Neni 89, 90, 91.*

*2- Pretendimet tuaja nuk do të merren parasysh për subjektin òP. E.ö për detyrimin e pa likuiduar në vlerën 1,776,137 lekë, pasi është lidhur një kontratë ndërmjet dy palëve përpara një zyre juridike ligjore, ku ka prodhuar një detyrim për të zbatuar. Nga ana juaj të meren të gjitha masat shtrënguese në bazë të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, kreu XI, Neni 89, 90, 91.*



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport auditimi mbi auditimin e ushtruar në Bashkinë Mirditë me objekt “Auditim financiar”

3-Subjekti “K.” do të meret parasysh nga ana jonë, në bazë të dokumenteve të bashkëngjitur në observacion dhe do të trajtohet në raportin përfundimtar.

**Titulli i gjetjes 6:** Mbi mos vjeljen e detyrimeve për taksat dhe tarifatat nga Drejtoria e Planifikimit të të Ardhurave Vendore.

**Situata:** Në lidhje me auditimin e kryer për burimin e krijimit të të ardhurave, bazuar në kuadrin rregullator ligjor / nënligjor në fuqi, përdorimi i tyre, vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore dhe borxhi tatimor, u auditua dokumentacioni i paraqitur nga Drejtoria e Planifikimit të të Ardhurave, për periudhën 2019-2021.

Në Bashkinë Mirditë për periudhën e objekt auditimi ka funksionuar Drejtoria e Planifikimit të të Ardhurave me strukturë të rregullt, e cila është miratuar me miratimin e strukturës organike të Bashkisë. Në vijim paraqesim evidencën e gjendjes së bizneseve dhe ndryshimet e ndodhura si regjistrimet e reja, bizneset që kanë mbyllur aktivitetin dhe gjendja në fund të periudhës sipas aneksit 2/2/6/1.

Sa më sipër konstatohet se numri i biznesit të vogël për periudhën e auditimit ka pasur një paqëndrueshmëri, kjo vërtetohet nga fakti i mbylljes së bizneseve dhe gjendja ekonomike jo e favorshme dhe për biznesin e madh ka pasur një rritje të lehtë të regjistrimeve të reja.

Në vijim po paraqesim në formë tabele planifikimin dhe realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore për periudhën 2019-2021 sipas aneksit 2/2/6/2.

Për vitin 2019, të ardhurat janë planifikuar në vlerën 73,115 mijë lekë dhe janë realizuar në vlerën 63,719 lekë ose 87%. Ndikim negativ në mos realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore, ka mos realizimi i të ardhurave nga taksa e pasurisë mbi ndërtesat, taksa mbi tokën bujqësore, dhe tarifatat e pastrimit, gjelbërimit dhe ndriçimit.

Për vitin 2020, të ardhurat janë planifikuar në vlerën 80,821 mijë lekë dhe janë realizuar në vlerën 57,659 lekë ose 71,34%. Ndikim negativ në mos realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore, ka mos realizimi i të ardhurave nga taksa e pasurisë mbi ndërtesat, taksa e tokës bujqësore, tarifatat e pastrimit, gjelbërimit/ndriçimit.

Për vitin 2021, të ardhurat janë planifikuar në vlerën 73,489 mijë lekë dhe janë realizuar në vlerën 70,056 lekë ose 95,33%. Për këtë vit shikojmë që ka pasur një planifikim më të ulët nga ana e drejtorisë së taksave vendore. Për vitin 2021 nga Drejtoria e Planifikimit të të Ardhurave është bërë një punë e mirë në realizimin e të ardhurave vendore si pasojë e masave shtrënguese në drejtim të debitorëve. Ndikim negativ në mos realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore, ka mos realizimi i të ardhurave nga taksa e pasurisë mbi ndërtesat, taksa e tokës bujqësore, tarifatat e pastrimit, gjelbërimit/ndriçimit.

Arsyet e mosrealizimit, sipas pretendimeve të specialistëve të taksave bashkia Mirditë janë:

-I rënies së numrit të subjekteve aktive (biznese të vogël)

-Si rezultat i fatkeqësive natyrore (tërmeti i 26 Nëntorit 2019 dhe pandemisë globale) ka patur mjaft problematika në realizimin e të ardhurave të parashikuar si dhe vjeljes së debisë pasi shumë nga subjektet (biznese) kanë pezulluar apo mbyllur aktivitetin e tyre për shkak të dëmtimeve apo rënies ekonomike në përgjithësi.

**Vlera e borxhit në 31.12.2019 në mënyrë progresive është në vlerën 36,952,700 lekë**

**Vlera e borxhit në 31.12.2020 në mënyrë progresive është në vlerën 41,017,006 nga të cilat**

**- debitorë të viteve 2010-2019**

**14,838,512 lekë**





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport auditimi mbi auditimin e ushtruar në Bashkinë Mirditë me objekt "Auditim financiar"

-181 subjekte të biznesit të madh dhe të vogël në vlerën 10,293,316 lekë

-13 subjekte debitorë në vlerën 15,885,178 lekë

**Vlera e borxhit në 31.12.2021 në mënyrë progresive është në vlerën 38,852,309 lekë nga të cilat**

-të trashëguara nga vitet 2010-2019 14,838,512 lekë

-subjekti 0Sh.ö 2020 10,569,197 lekë

-Subjekte biznesi 2021 8,599,825 lekë

-1463 familje debitorë për taksën e tokës bujqësore në vlerën 188,474 lekë

-1374 familje debitorë për tarifafat vendore në vlerën 1,557,400 lekë

-1463 subjekte familjare për taksën e ndërtesës në vlerën 3,098,901 lekë

**Vlera e borxhit të vitit në 31.12.2021 është në vlerën 13,444,600 lekë nga të cilat**

-129 subjekte të biznesit të madh dhe të vogël në vlerën 8,599,825 lekë

-1463 familje debitorë për taksën e tokës bujqësore në vlerën 188,474 lekë

-1374 familje debitorë për tarifafat vendore në vlerën 1,557,400 lekë

-1463 subjekte familjare për taksën e ndërtesës në vlerën 3,098,901 lekë

Nga auditimi i 20 dosjeve të subjekteve debitorë për vjeljen e detyrimeve për taksat dhe tarifafat vendore, nga ana e Drejtorisë së Planifikimit të të Ardhurave, është mjaftuar vetëm me dërgimin e njoftim detyrimeve për subjektet debitorë dhe shkresa për bllokimin e llogarive bankare në bankat e nivelit të dytë.

Nuk kanë vazhduar më tej procedurat për të dërguar shkresa për sekuestro të mjeteve të transportit pranë Drejtorisë së Kontrollit dhe Shfrytëzimit të Automjeteve, në Zyrën Vendore të e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZRPP) sot Agjencia Shtetërore e Kadastrës (ASHK) për vendosjen e barrës së pasurisë dhe Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB).

Për më tej nuk është vazhduar për marrjen e masave të tjera shtrënguese si bllokimi i aktivitetit të biznesit deri në sekuestron e mallrave të debitorëve dhe në kallëzim penal të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 *öPër Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë* i ndryshuar.

\*\*\*\*\*

Në lidhje me realizimin e të ardhurave të Bashkisë nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimi, urbanizimi dhe integrimi i ndërtimeve pa leje, bazuar në dokumentet e shkresave të dërguara nga zyra e ALUIZNI- Drejtoria Rajonale Lezhë, u auditua i gjithë dokumentacioni për periudhën e vitit 2019-2021, i paraqitur nga Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit dhe Kontrollit të Territorit.

Në Bashkinë Mirditë deri në 31.12.2021, disponohen shkresat përcjellëse dhe listat me emrat përkatës që ju janë miratuar Lejet e Legalizimit për ndërtimet pa leje ndërtimi brenda territorit të Bashkisë Mirditë. Nga ALUIZNI- Drejtoria Rajonale Lezhë, janë dërguar dokumentet për çdo person që ka ndërtuar objekt banimi apo social ekonomik në territorin e Njësisve Administrative të Bashkisë Mirditë, ku përcaktohet edhe detyrimi për të paguar vlerën e taksës së ndikimit në infrastrukturë. Nga auditimi mbi vjeljen e detyrimeve për taksën e ndikimit në infrastrukturë, konstatohet se nga Bashkia Mirditë, nuk janë marrë plotësisht masa të veçanta për vjeljen e taksës së ndikimit në infrastrukturë për objektet ndërtimore që legalizohen nga ALUIZNI- Drejtoria Rajonale Lezhë. Në vijim paraqiten pasqyra e personave të cilët janë pajisur me Leje Legalizimi, sipërfaqet ndërtimore sipas objekteve, funksioni, vendndodhja e objektit, sipërfaqja e



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport auditimi mbi auditimin e ushtruar në Bashkinë Mirditë me objekt “Auditim financiar”

objektit, detyrimi sipas personave që duhet të paguanin, për periudhën 2019-2021 deri më, sipas aneksit 2/6/1.-Në auditimin e programimit dhe realizimit të të ardhurave, nga arkëtimi i taksës së ndikimit në infrastrukturë, konstatohet se, nga Bashkia Mirditë, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, nuk janë marrë plotësisht masa me arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për objektet ndërtimore që legalizohen nga ALUIZNI-Drejtoria Rajonale Lezhë. Sipas të dhënave zyrtare që ALUIZNI i ka dërguar Bashkisë Mirditë, konstatohet se deri më 31.12.2021, janë posedues të lejes së legalizimit që nuk kanë paguar detyrimet për taksën e ndikimit në infrastrukturë për 38 persona, veprimi dhe mosveprimi është jo në përputhje me kërkesat dhe përcaktimet e bëra në ligjin nr. 9482 datë 03.04.2016, òPër legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa lejeò i ndryshuar, neni 23, në bazë të paketës fiskale me vendim nr. 135 datë 30.11.2018, vendimi nr. 40 datë 26.11.2019 dhe vendimi nr. 110 datë 20.11.2020 òPër Miratimin e Paketës Fiskale Vendoreò A. 4/d. Këta qytetar dhe subjekte janë debitorë në vlerën **1,071,877 lekë, gjë që ka sjellë të ardhura të munguara për Bashkinë Mirditë.**

**Kriteri:** Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 òPër procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisëò i ndryshuar, kreu XI, Neni 89, 90, 91, 93.

Ligji nr. 7895, datë 27.1.1995 òKodin Penal në Republikën e Shqipërisëò, neni 181,-Mospagimi i taksave dhe tatimeve.

Ligji nr. 9482 datë 03.04.2016, òPër legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa lejeò i ndryshuar, neni 23,

**Ndikimi/Efekti:** -Mungesa e të ardhurave për realizimin e shërbimeve dhe investimeve.

**Shkaku:** Mos respektimi e kuadrit ligjorë nga peronat përgjegjës.

**Rëndësia:** I lartë

**Rekomandimi:** Drejtoria e Planifikimit të të Ardhurave Vendore të marrë masa për arkëtimin e detyrimeve në mënyrë progresive në vlerën **38,852,309 lekë**. Për këtë, bazuar në nenin 70 pika 3 òE drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimorò, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 òPër Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar, për të gjitha subjektet e private të nxjerrë njoftim vlerësimit tatimor dhe në vazhdim të marren masat për arkëtimin e këtij detyrimi, duke ndjekur rrugët e mëposhtme:

**a- Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit (ASHK) dhe Zyrën Vendore të e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZRVPP), kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në (për pasuritë e paluajtshme), bazuar në nenin 91, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 òPër Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisëò.**

**b- Për subjektet të cilët nuk kanë paguar detyrimet tatimore në afat, ndaj tyre të aplikohet Neni 93**të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 òPër Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisëò.

**Sekuestrimi dhe konfiskimi i pasurisë 1.** Nëse tatimpaguesi nuk paguan detyrimin tatimor në datën e caktuar, në përputhje me nenin 89 të këtij ligji, për njoftimin dhe kërkesën për pagesë, administrata tatimore mund ta mbledhë detyrimin tatimor të papaguar nëpërmjet sekuestrimit, e më pas konfiskimit, të pasurisë së siguruar në favor të administratës tatimore, në pronësi të tatimpaguesit.

**c- Në rast se bizneset private edhe pas njoftimeve zyrtare** dhe dërgimit të urdhër bllokimeve në bankë nuk kryejnë pagesën e detyrimeve, pasi të merren masat administrative apo sekuestro, të bëhet **kallëzim penal**, bazuar në Kodin Penal i Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr.



## KONTROLLI I LARTË I SHETIT

### Raport auditimi mbi auditimin e ushtruar në Bashkinë Mirditë me objekt “Auditim financiar”

7895, datë 27.1.1995 me ndryshimet e mëvonshme, neni 181 òMospagimi i taksave dhe tatimeveò.

**d- Për debitorët familjar,** në zbatim të udhëzimit plotësues të Ministrisë së Financave nr. 01, datë 17.01.2019 òPër zbatimin e buxhetit të vitit 2019ò, pika 98, të njoftojë nëpërmjet postës familjarët të cilët nuk kanë paguar detyrimet për taksën e tokës, të ndërtesave dhe tarifat familjare dhe të realizojë arkëtimin e detyrimit të miratuar nga Këshilli Bashkiak.

-Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit dhe Kontrollit të Territorit në bashkëpunim me Drejtorinë e të Ardhurave Vendore dhe Policinë Bashkiake të marrë plotësisht masa me arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për objektet ndërtimore që legalizohen nga ALUIZNI-Drejtoria Rajonale Lezhë për vlerën debitorë **1,071,877 lekë** në mbështetje të Ligjit nr. 9482 datë 03.04.2016, òPër legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa lejeò i ndryshuar, neni 23, dhe Vendimin e Këshillit të Bashkisë me vendim nr. 135 datë 30.11.2018, vendimi nr. 40 datë 26.11.2019 dhe vendimi nr. 110 datë 20.11.2020 òPër Miratimin e Paketës Fiskale Vendoreò.

#### **Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:**

Znj.M. N. me detyrë, Përgjegjëse e Sektorit të të Ardhurave, Taksa e Tarifa, nga periudha 2016 e në vazhdim (N/C)

Z.K. M. me detyrë, Specialiste e Mbledhjes të të Ardhurave, nga periudha 01.09.2020 (N/C)

Z.V.T. me detyrë, Inspektor i Taksave, nga periudha viti 2000 e në vazhdim (N/C)

Z.Gj. R. me detyrë, Inspektor i Taksave, nga periudha 2009 e në vazhdim (N/C)

Z.J. P. me detyrë, Inspektor Taksash nga periudha 2011 e në vazhdim (K/P)

Znj.A. D., me detyrë Drejtor Planifikimit Zhvillimit Territorit, nga periudha 07.03. 2016 e në vazhdim. (N/C)

Paraqitur me shkresën me nr. 1062 prot, datë 04.03.2022 (Bashkisë Mirditë) dhe të KLSH-së nr. 52/2 prot., datë 15/03/2022 nga ana e znj. M. N., z. K. M., z. V. T., z. J. P. dhe z. Gj. R.

#### **Pretendimi i subjektit:**

-Numri i subjekteve debitorë për vitin 2020 për taksat dhe tarifat familjare ka ardhur si rezultati e pandemisë globale, me të cilën nuk është bërë e mundur arkëtimi i këtyre pagesave, pagesë e cila ka filluar në vitin pas ardhës dhe janë reflektuar në realizimin e të ardhurave në masën 95,33% për këtë arsye janë konstatuar këto mungesa.

-Për taksën e ndikimit në infrastrukturë sqarojmë se;

Debitorët e TNI, ish Aluizmi ka dhënë paraprakisht lejen e legalizimit, ndërkohë që ASHK Lezhë nuk mund të emetojë asnjë leje legalizimi pa marrë më parë konfirmimin me anë të një vërtetimi nga Bashkia Mirditë ku të jetë bërë dhe pagesa.

#### **Qëndrimi i Grupit të auditimit:**

*Në lidhje me komentet e bëra nga ana e juaj sqarojmë se;*

*1-Për vitet 2019 dhe 2020 duhet të ishte bërë një punë më e mirë për arkëtimin e detyrimeve ndaj subjekteve dhe familjarëve për taksat dhe tarifat dhe të ishin përdorur të gjitha masat shtrënguese në bazë të legjislacionit tatimor për vjeljen e borxhit në bazë të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, kreu XI, Neni 89, 90, 91 dhe pretendimet tuaja nuk do të meren parasysh.*

*-Për vitin 2021 nga ana juaj është bërë një punë më efikase, gjë që ka sjell dhe një realizim e të ardhurave në masën 95,33% dhe në uljen e borxhit tatimor.*



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport auditimi mbi auditimin e ushtruar në Bashkinë Mirditë me objekt “Auditim financiar”

2- Pretendimet tuaja në lidhje me taksën e TNI nuk do të merren parasysh pasi është detyrimi juaj si drejtori për vjeljen e taksës, kjo e shprehur qartë dhe në paketat fiskale të miratuara nga Këshilli Bashkiak i Mirditës për vjeljen e taksës për ndërtimet e reja dhe për ndërtimet pa leje por që kanë qenë në proces legalizimi.

### **2.3 Vlerësimi Raportimit Financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitin 2020, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi dhe konkretisht, ligjin nr. 24/2018, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” si dhe udhëzimi MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”.**

Në zbatim të pikës 3 të programit të auditimit nr. 52/1 datë 18.01.2022, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Lista emërore e punonjësve nga Zyra e Burimeve Njerëzore, ku përfshihen funksioni, niveli i pagës për pozicion, kategoria statusi i punonjësit, dhe kontrata individuale e punonjësve, si dhe urdhrat e emërimit të punonjësve. etj.
- Lista emërore dhe evidenca mbi emërimin e punonjësve nga Zyra e Burimeve Njerëzore dhe kontrata individuale e punonjësve, etj.
- Bilancet kontabël dhe pasqyrat financiare për vitin 2019-2020 dërguar dhe rakorduar me Degën e Thesarit Mirditë.
- Analitikët për vitin 2020 të llogarive;
  - 468 Debitor te ndryshem
  - 4342 Operacione me shtetin( te drejta )
  - 481 Shpenzime për tu shpërndare
  - 486 Shpenzime te periudhave te ardhshme,
  - 202 Studime dhe Kërkime
  - 210 Toka, T,roje, Terene
  - 211 Pyje, Plantacione
  - 212 Ndërtesa e Konstruksione
  - 213 Rruge, rrjete, vepra ujore
  - 214 Instalime teknike, makineri e pajisje
  - 215 Mjete Transporti
  - 218 Inventari ekonomik
  - 24 AAGJ të dëmtuara
  - 230 SHp.AAGJM në proces
  - 231 Shp.AAGJM në proces
  - 401-408 Furnitorë e llogari te lidhura me to
  - 466 Kreditore për mjete ne ruajtje
  - 467 Kreditore te ndryshëm
  - 475 ardhura për tu regjistruar
- Dokumentet origjinale justifikuese dhe argumentuese të regjistruara për kryerjen e veprimeve financiare kontabël (mandat arkëtime, mandat pagesa, kontrata, fatura, situacione, urdhër shpenzime, fletë hyrje, fletë dalje, etj).



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport auditimi mbi auditimin e ushtruar në Bashkinë Mirditë me objekt “Auditim financiar”

- Situacionet e shpenzimeve për vitin 2019-2020 i rakorduar me Degën e Thesarit Mirditë.

**Mbajtja e kontabilitetit** është bërë në zbatim të kërkesave të nenit 3, pika 1, të ligjit nr.9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, ligjit 25/2018 datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standarteve dhe rregullave kontabile” pjesa e parë “Rregulla të përgjithshme” kapitulli i parë “Mbajtja e kontabilitetit” dhe Planit Kontabël të miratuar për institucionet dhe UMF nr. 14, datë 28.12.2006, “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore, për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe të njëjsteve që varen prej tyre”, ndryshuar me UMF nr. 26, datë 27.12.2007 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të institucioneve qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësitë që varen prej tyre si dhe njëjsteve të menaxhimit/zbatimit të projekteve e marrëveshjeve me donatorët e huaj” dhe dhe udhëzimi i MF nr. 08, datë 09.03.2018” Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njëjsteve të Qeverisjes së Përgjithshme“.

Pasqyrat Financiare Vjetore të vitit ushtrimor 2020 janë hartuar dhe depozituar më datën 31.03.2021 në Degën e Thesarit Mirditë, **brenda afatit ligjor**.

**Qëllimi i auditimit:** Qëllimi i auditimit të pasqyrave financiare është të rrisim shkallën e besimit të përdoruesve të pasqyrave financiare, nëpërmjet shprehjes së një opinioni nga ana jonë nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar, si një mekanizëm kontrolli për të siguruar përgjegjshmërinë financiare.

Kjo përgjegjshmëri ka të bëjë drejtpërdrejt me menaxhimin e shëndoshë financiar si dhe me faktin që, rezultatet dhe përdorimi i burimeve janë të paraqitura drejt dhe në përputhshmëri me kornizën e raportimit financiar.

Audituesit shtetëror do të japin sigurinë ose jo nëse informacioni i paraqitur mbi shpenzimin e parave publike në programet publike përfaqëson në mënyrë të përshtatshme situatën financiare.

**Objektivat e auditimit:** Objektivat specifike të auditimit ose pohimet për marrjen e garancive për besueshmërinë e pasqyrave financiare janë:

- Pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim si; përkatësia, plotësia, saktësia, periudha, klasifikimi, ligjshmëria dhe rregullsia.
- Pohimet rreth gjendjeve të llogarive në fund të periudhës si; ekzistenca, të drejtat dhe detyrimet, plotësia, vlerësimi dhe alokimi.
- Pohimet rreth prezantimit të shënimeve shpjeguese si: transaksionet, të drejtat dhe detyrimet, plotësia, klasifikimi dhe kuptueshmëria, saktësia dhe vlerësimi.

**Dokumentimi i rezultateve të auditimit:** Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm dhe i mbështetur në testet e kontrollit dhe testet thelbësore të transaksioneve për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet e rëndësishme profesionale



## KONTROLI I LARTË I SHTETIT

### Raport auditimi mbi auditimin e ushtruar në Bashkinë Mirditë me objekt “Auditim financiar”

të bëra në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërben si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

**Përputhshmëria me kërkesat ligjore për Raportimin Financiar:** Përgatitja dhe miratimi i Pasqyrave Financiare, në Bashkinë Mirditë, është realizuar në mbështetje të kërkesave të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 *“Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”* i ndryshuar, dhe ligjit 25/2018 datë 10.05.2018 *“Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”* akteve të tjera nënligjore në fuqi, në funksion të këtij ligji. Pasqyrat financiare janë dorëzuar brenda afateve të parashikuara në ligjet dhe aktet nënligjore të sipërcituara. Pasqyrat financiare janë plotësuar në përputhje me kërkesat ligjore dhe formatet e miratuara nga Ministria e Financave.

#### **Mbajtja e Kontabilitetit dhe Hartimi i Pasqyrave Financiare**

Në fund të periudhës ushtrimore 2020 janë plotësuar 7 Formate, (pasqyra financiare), sipas formularëve standard të miratuara me UMF nr.08, datë 09.03.2018 *“Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisve të Qeverisjes së Përgjithshme”*,

Formati 1 ó Pasqyra e Pozicionit Financiar

Formati 2 ó Pasqyra e Performancës Financiare

Formati 3 ó Pasqyra e Flukseve Monetare (*Cash Flow*)

Formati 4 ó Pasqyra e ndryshimeve në Aktivitet Neto/ Fondet Neto

Formati 5- Pasqyra e shënimeve shpjeguese

Formati 6 ó Pasqyra e investimeve dhe e burimeve të financimit

Formati 7/a ó Pasqyra mbi gjendje dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata me koston historike

Formati 7/b - Pasqyra mbi gjendje dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata me vlerën neto

Formati 8 - Pasqyra mbi numrin e punonjësve dhe fondin e pagave

#### **Mbajtja e kontabilitetit dhe funksionimi i llogarive sintetike me llogaritë analitike.**

Në këtë Bashki, kontabiliteti mbahet **në mënyrë manuale, që e bën me risk të lart** për sa i përket sigurisë në saktësinë e informacionit që marrim nga ky sistem kontabiliteti.

#### **Mbi aktivet e qëndrueshme të trupëzuara dhe të pa trupëzuara.**

a. Objektivat e auditimit të aktiveve të qëndrueshme, janë që të sigurohemi se:

*Aktivet ekzistojnë; ato i përkasin subjektit; janë të vlerësuara në mënyrë korrekte; janë regjistruar në mënyrë korrekte; është bërë mirë ndarja midis shpenzimeve dhe aktiveve të qëndrueshme; informacionet që ndodhen në aneksin përkatës janë të plota dhe korrekte.*

b. Kontrollë të llogarive dhe dokumenteve

#### **1. Pasqyra e pozicionit financiar (F1)**

Aktivitet neto janë të barabarta me Aktivitet-Pasivet = **122,154,446,591 lekë.**

	Viti 2020	Viti 2019
AKTIVET	122,321,323,538	122,272,784,123
PASIVET(DETYRIMET)	166,876,947	208,816,320
<b>AKTIVET NETO/ FONDET (A-B)</b>	<b>122,154,446,591</b>	<b>122,063,967,803</b>

Burimi: Bashkia Mirditë



## KONTROLI I LARTË I SHTETIT

### Raport auditimi mbi auditimin e ushtruar në Bashkinë Mirditë me objekt “Auditim financiar”

#### 1.1 Aktivët afatshkurtra

Aktivët afatshkurtra më datë 31.12.2020 paraqiten në vlerën **178,172,158** lekë dhe përbëhen nga:

- Llogaritë e Klasës 5 ÷ Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre në shumën 25,996,510 lekë;
- Llogaritë e Klasës 3 ÷ Gjendje inventari qarkullues në shumën 11,252,654 lekë;
- Llogaritë e Klasës 4 ÷ Llogari të arkëtueshme në shumën 74,728,778 lekë dhe  
÷ Të tjera aktive afatshkurtra në shumën 66,194,216 lekë.

#### - Llogaritë e Klasës 5 “Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre” përbëhet nga:

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	Viti 2020	Viti i 2019	Diferenca
				2020-2019
531	Mjete monetare ne arkë	-	-	-
512	Mjete monetare në bankë	-	-	-
520	Disponibilitete në thesar	24,999,010	24,754,291	244,719
50	Letra me vlerë	-	-	-
532	Vlera të tjera	997,500	997,500	0
54	Akredeitiva dhe paradhënie	-	-	-
59	Provizione zhvlerësimi	-	-	-
	<b>TOTALI</b>	<b>25,996,510</b>	<b>25,751,791</b>	<b>244,719</b>

Burimi: Bashkia Mirditë

Vlera e llogarisë 520 ÷ Disponibilitete në thesarë në shumën **24,999,010** lekë, përbëhet nga:

- Llog 466 ÷ Kreditorë për mjete në ruajtje në shumën 23,568,322 lekë; dhe
- Llog 85 ÷ Rezultati i veprimtrisë ushtrimore që ndërkohë është në shumën 0 lekë;

#### **Titulli i gjetjes 7:** Mosraportim i saktë në bilancë i llogarisë 520 ÷ Disponibiliteti në thesarë

**Situata :** Llogaria 520 ÷ Disponibiliteti në thesarë nuk paraqet gjendjen e saktë në bilanc. Kjo llogari duhet të sistemohet në vlerën 25,996,510 lekë për shtesën 997,500 lekë. Llogaritë e klasës 5, nuk kanë funksionuar duke u debituar për shtesat në kredi të llogarive përkatëse për të ardhurat dhe grante të ndryshme, si dhe duke u kredituar për pakësimet në debi të llogarive përkatëse të klasës 4. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimi nr.8, datë 09.03.2018 ÷ Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të PF vjetore në NJQPë pika 46/a , 49, 50.

**Kriteri:** UMF nr. nr.8 datë 09.03.2018 ÷ Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore, pika 36. Ligji nr. 10296 ÷ Për menaxhimin financiar dhe kontrollin në neni 6, udhëzimi nr. 30 datë 27.12.2011 ÷ Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikë pikat nga 26-30, 74, 96-101, 102 dhe 103

**Ndikimi/Efekti:** Paraqitja jo e saktë në pasqyrat financiare e vlerave përkatëse të disponibilitetit në thesar, keq informon subjektin mbi gjendjen realë si dhe përdoruesit e pasqyrave financiare të Bashkisë Mirditë.

**Shkaku:** Mosnjohje e legjislacionit të fushës.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandimi:** Nëpunësi Zbatues, Drejtorja e Financës dhe Buxhetit të marri masa për sistemimin e llogarisë 520 ÷ Disponibiliteti në thesarë për shtesën **997,500** lekë.

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi: Drejtorja e Menaxhimit Financiar dhe Buxhetit znj. F. F., Përgjegjëse e zyrës së Financës znj. V. Gj.**



## KONTROLLI I LARTË I SHETIT

### Raport auditimi mbi auditimin e ushtruar në Bashkinë Mirditë me objekt "Auditim financiar"

#### - Llogaritë e Klasës 3 "Gjendje inventari qarkullues", përbëhet nga:

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	Viti 2020	Viti 2019	Diferenca 2020-2019
31	Materiale	9,744,565	7,411,195	2,333,370
32	Objekte inventari Inventar i imët	1,508,089	1,508,089	0
33	Prodhime, punime e shërbime ne proces			
34	Produkte			
35	Mallra			
36	Gjë e gjalle ne rritje e majmeri			
37	Gjendje te pambritura ose pranë të treteve			
38	Diferenca nga çmimet e magazinimit			
39	Provizgjione për zhvlerësim te inventarit(-)			
	<b>Totali</b>	<b>11,252,654</b>	<b>8,919,284</b>	<b>2,333,370</b>

Burimi: Bashkia Mirditë

Llogaritë e Klasës 3, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Bashkisë Mirditë në 31.12.2020 paraqitet në vlerën **11,252,654 lekë** dhe përbëhet nga:

- Llogaria kontabël 31 "Materiale" për shumën 9,744,565 lekë;
- Llogaria kontabel 32 "Objekte inventari" për shumën 1,508,089 lekë;
- Diferenca me vitin e mëparshëm përfaqëson lëvizjen e inventarit në shumën 2,333,370 lekë e cila kuadron me llogarinë 63 "Ndryshimi i Gjendjes së Inventarit" në shumën 2,333,370 lekë.
- **Llogaria 312 "Materiale"** ka vlerën 9,744,565 lekë dhe lëvizjet e kësaj llogarie për vitin 2020 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendje në 01.01.2020	7,411,195
Hyrjet në magazinë gjatë	17,632,627
Dalje nga magazina gjatë	15,299,257
<b>Gjendja në 31.12.2020</b>	<b>9,744,565</b>

Burimi: Bashkia Mirditë

- **Llogaria 327 "Objekte inventari"** ka vlerën 1,508,089 lekë dhe përputhet me rezultatin e inventarizimit vjetor dhe nuk ka ndryshime. Lëvizjet e llogarisë 32 "Objekte inventari" paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendja në 01.01.2020	1,508,089
Hyrje gjatë vitit 2020	0
Dalje gjatë vitit 2020	0
<b>Gjendja në 31.12.2020</b>	<b>1,508,089</b>

Burimi: Bashkia Mirditë

Gjendja e llogarive të mësipërme është e kuadruar me gjendjen e inventarëve. Për kryerjen e tyre është zbatuar udhëzimi i MF nr. 30, datë 27.12.2012 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik". Titullari i Bashkisë Mirditë ka nxjerrë Urdhër nr.202 datë 03.09.2020 "Për inventarizimin e pajisjeve aktiveve dhe inventarin ekonomik në institucione varësie të bashkisë për vitin 2020, ku është përcaktuar komisioni me 56 anëtarë (përfshirë kryetarin e komisionit dhe nën kryetarin) për inventarizimin dhe vlerësimin e aktiveve, shoqëruar me Programin e punës për secilën njësi shpenzuese.





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport auditimi mbi auditimin e ushtruar në Bashkinë Mirditë me objekt “Auditim financiar”

Llogaritë e klasës 3 kanë funksionuar duke u debituar për shtesat në kredi të llog. 63 òNdryshimi i gjendjeve të inventaritò dhe duke u kredituar për daljet e inventarit në debi të llogarisë 63 òNdryshimi i gjendjeve të inventaritò.

- Llogaritë Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” & “Të tjera aktive afatshkurtra” përbëhen nga:

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	Viti 2020	Viti 2019	Diferenca 2020-2019
	<b>Llogari të arkëtueshme</b>			
411	Klientë e llogari të ngjashme			
423,429	Personeli, paradhënie, deficite e gjoba	6,729,900	6,765,900	-36,000
431	Tatime e taksa	-	-	-
432	Tatime mbledhur nga shteti për llog.Pushtetit Lokal	-	-	-
433	Shpenzime fatkeqësi natyrore që mbulon shteti	-	-	-
435	Sigurime Shoqërore	-	-	-
436	Sigurime Shëndetësore	-	-	-
437,438	Organizma të tjerë shoqërore	-	-	-
44	Institucione të tjera publike	-	-	-
466	Kreditorë për mjete në ruajtje	-	-	-
468	Debitorë të ndryshëm	47,679,138	42,685,882	4,993,256
4342	Te tjera operacione me shtetin(debitor)	20,319,740	100,123,692	-79,803,952
45	Marrëdhënie me instit. brenda dhe jashtë sistemit	-	-	-
49	Shuma të parashikuara për zhvleresim(-)	-	-	-
	<b>Totali</b>	<b>74,728,778</b>	<b>149,575,474</b>	<b>-74,846,696</b>
	<b>Të tjera aktive afatshkurtra</b>			
409	Furnitore(Debitorë),parapagime pagesa pjesore	-	-	-
473	Llogari të pritjes të marrëdhënieve me thesarin	-	-	-
477	Diferenca konvertimi aktive	-	-	-
481	Shpenzime për tui shpërndarë në disa ushtrime	-	-	-
486	Shpenzime të periudhave të ardhshme	66,194,216	33,489,055	-
	<b>Totali</b>	<b>66,194,216</b>	<b>33,489,055</b>	<b>32,705,161</b>

Burimi: Bashkia Mirditë

- Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm” në fund të vitit 2020 është në vlerën 47,679,138 lekë. Kjo shumë është rritur krahasuar me tepicën e vitit 2019 dhe debitorët e tatim taksave të krijuara ndër vite në shumën 42,685,882 lekë me 4,993,256 lekë.

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendja në 01.01.2020	42,685,882
Shtesa gjatë vitit 2020 debitorët e	4,993,256
Pakësime gjatë vitit 2020 (K)	0
<b>Gjendja në 31.12.2020</b>	<b>47,679,138</b>

Burimi: Bashkia Mirditë

Gjatë shqyrtimit të llogarive analitike për vitin 2020 janë evidentuar debitorët për taksat dhe tarifave vendore. Duke rakorduar me zyrën e Taksave dhe Tarifave të Bashkisë Mirditë, janë evidentuar detyrimet për vitin 2020, detyrime të cilat paraqitet si më poshtë vijon:

Debitorë Bashkia Mirditë dhe NJA	Gjendja 31.12.2019	Gjendja 31.12.2020
Debitorë Biznes i Madh	5,820,400	7,548,180
Debitorë Biznes i Vogel	1,068,278	2,572,708
Debitorë nga Taksa e tokës bujqësore	160,202	172,428



## KONTROLLI I LARTË I SHETIT

### Raport auditimi mbi auditimin e ushtruar në Bashkinë Mirditë me objekt “Auditim financiar”

Debitore nga Taksat e familjes(asete të mbartura	29,128,820	30,723,690
<b>Totali</b>	<b>36,177,700</b>	<b>41,017,006</b>

Burimi: Bashkia Mirditë

Diferenca prej 6,662,132 lekë e llogarisë 468 òDebitor të ndryshëmò krahasuar vlerën e bilancit 47,679,138 lekë me atë analitike prej 41,017,006 lekë, është sepse në bilanc janë futur edhe detyrimet e nxjerra nga auditimi i mëparshëm i KLSH mbi individët dhe furnitorët debitor nga mos arkëtimi i dëmeve ekonomike.

Ky veprim është kryer në përputhje me ligjin 10296 datë 08.07.2010 òPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò neni 6;të nenit 10 dhe 11, të ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004, òPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiareò , ligjin nr. 25/2018 datë 10.05.2018 òPër kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiareò datë udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 òPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshmeò ku citohet: òKontabiliteti i të drejtave dhe detyrimeve përbëhet nga:

Llogaritë e klientëve dhe debitorëve të ndryshëm.

Llogaritë e furnitorëve e kreditorëve të ndryshëm.

Të drejtat. Funkcionimi i llogarive të të drejtave 411, 468 e të tjera, në rastet e përdorimit të tyre në sektorin publik debitohe (në rastin e konstatimeve), në kredi të llogarive respektive të klasës 7 dhe klasës 1 (116).

Detyrimet. Kreditohen llogaritë (401/404 e 467), në debi të llogarive përkatëse të klasës 6 dhe 23 (në rastin e konstatimeve).

Funkcionimi kontabël sipas rasteve në mënyrë të përmbledhur është si më poshtë:

a) Konstatohet e arkëtohen të ardhurat:

**Debitohet 411, 468 e të tjera me analiza (rasti i konstatimit);**

Debitohet 520, 512, 531 e të tjera financiare (për rastet e arkëtimeve direkte);

**Kreditohet klasa 7 me analiza;**

Kreditohet 466 me analiza (kur bëhet fjalë për mjetet në ruajtje).

b) Arkëtohen të drejta të konstatuara:

Debitohet klasa 5 (512,520), llogaritë financiare me analiza;

Kreditohet 411, 468, 466 e të tjera me analiza.

c) Konstatohen e paguhen shpenzime korrente e kapitale:

Debitohet klasa 6 ose 23 (sipas analizave përkatëse);

Kreditohet 401, 404, 467 e të tjera me analiza, kur detyrimi paguhet më vonë;

Kreditohet klasa 5 llogaritë financiare (kur paguhet menjëherë)ò

Pra për periudhën ushtrimore 2020 është paraqitur saktë Llogaria 468 òDebitorë të ndryshëmò dhe Llogaria 70 ò Të ardhurat nga taksat dhe tatimeò, duke mos krijuar mbi apo nën vlerësime llogarie.

- **Llogaria 4342 “Të tjera operacione me shtetin (debitor)”**, në fund të vitit 2020 paraqitet në vlerën 20,319,740 lekë dhe kuadron me Llogarinë 7206 òFinancim i pritshëm nga buxhetiò të Pasqyrës së Performancës Financiare e cila paraqitet në shumën 20,319,740 lekë. Vlera prej 20,319,740 lekë përfaqëson llogaritë e Klasës së 4 të Pasivit të Pasqyrës Financiare të Pozicionit Financiar, si dhe përbëhet nga:

<b>Lëvizjet e llogarisë</b>	<b>Vlera në lekë</b>
-----------------------------	----------------------



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport auditimi mbi auditimin e ushtruar në Bashkinë Mirditë me objekt "Auditim financiar"

Gjendja në 01.01.2020	100,123,692
Shtesa gjatë vitit 2020 (D)	471,643,151
Pakësime gjatë vitit 2020 (K)	551,447,103
<b>Gjendja në 31.12.2020</b>	<b>20,319,740</b>

Burimi: Bashkia Mirditë

#### Në mënyrë analitike paraqitet:

401-408	Furnitorë e llogari të lidhura me to	598,789
42	Detyrime ndaj personelit	14,199,094
431	Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa	939,220
435	Sigurime Shoqërore	4,030,027
436	Sigurime Shëndetësore	552,610
437,438,	Organizma të tjerë shtetërore	0
<b>TOTALI</b>		<b>20,319,740</b>

Burimi: Bashkia Mirditë

- **Llogaria 486 "Shpenzime të periudhave të ardhshme"** në fund të vitit 2020 paraqitet në vlerën 66,194,216 lekë.

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendja në 01.01.2020	33,489,055
Shtesa gjatë vitit 2020 (D)	131,974,742
Pakësime gjatë vitit 2020 (K)	99,269,581
<b>Gjendja në 31.12.2020</b>	<b>66,194,216</b>

Burimi: Bashkia Mirditë

Vlera e kësaj llogarie në shumën **66,194,216 lekë**, përfaqëson detyrime për shpenzime të kryera, por të pa financuara në vitin ushtrimor. Gjatë vitit 2020 ka patur një shtim (në vlerë absolute) të kësaj llogarie, pasi janë likuiduar një pjesë e konsiderueshme e këtyre detyrimeve. Në vlerë relative llogaria 486 ÷shpenzime të periudhave të ardhshmeö është pakësuar dhe për një kontabilizim të sistemuar si shkak i një gabimi në vitin 2019 në llogarinë 467 dhe 401, shuma prej 33,489,055 lekë është sistemuar në pasiv të llogarisë 466 dhe aktiv të llogarisë 486.

Emërtimi i llogarive	Vlera
Shenzime gjyqësore	0
Shpenzime operative	135,325,000
Shpenzime për investime	60,380,000
<b>Totali</b>	<b>195,705,000</b>

Burimi: Bashkia Mirditë

Evidentimi i tyre në Pasqyrat Financiare të vitit 2020, është kryer veçmas në përputhje me Udhëzimin nr 8, datë 09.03.2019, pika 42 ku cilësohet: "Të gjitha Njësitë e qeverisjes së përgjithshme duhet të evidentojnë veçmas detyrimet e prapambetura të tyre ndaj të tretëve për shpenzime, shërbime apo investime të kryera por të pafinancuara".

Llogaritë e klasës 4, **kanë funksionuar** duke u debituar për njohjen e të drejtave për t'u arkëtuar në kredi të llogarive të klasës 7 dhe duke u kredituar për arkëtimin e të drejtave në debi të llogarive financiare të klasës 5.



## KONTROLLI I LARTË I SHETIT

### Raport auditimi mbi auditimin e ushtruar në Bashkinë Mirditë me objekt “Auditim financiar”

#### 1.2 Aktivet afatgjata

##### Mbi Aktivet Afatgjata jomateriale (AAJM)

Llogaritë e Klasës 20 ÷Aktivet Afatgjata Jo materiale në vlerën prej **6,230,914 lekë** përbëhen nga:

- Llog.202 ÷Studime dhe kërkime, në vlerën 6,230,914 lekë.

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendja në 01.01.2020	6,230,914
Shtesa gjatë vitit 2020 (D)	0
Pakësime gjatë vitit 2020 (K)	0
<b>Gjendja në 31.12.2020 (D)</b>	<b>6,230,914</b>

Burimi: Bashkia Mirditë

##### Testi substancial

Aktive Afatgjata jo materiale në fund të vitit 2020 rezulton në vlerën neto 6,230,914 lekë dhe përbëhet nga Llogaria 202 ÷Studime e kërkime e cila është dhënë në mënyrë analitike.

Nga verifikimi i analitikëve, konstatohet se vlera e studimeve dhe projekteve i përkasin objekteve **ende të papërfunduara, duke siguruar vlerësimin real të llogarisë 202 dhe AAJM.**

Analitikisht llogaria 202 ÷Studime dhe kërkime paraqitet si më poshtë;

Nr.	E M E R T I M I	Viti i Ndertimit	Vlera fillestare	Vite ne Perdorim	Amortiz	Vlera Mbetur
1	Plani urban I qytetit Rreshen	2011	3,492,600			3,492,600
2	Studime e projekte rruge te brendeshme qytetit rreshen	2012	776,325			776,325
3	Studim projektim rruga Ura e Pazarit-Varreza	2013	599,990			599,990
4	Studim projektim rruga Rreshen -Nderfushaz	2011	452,000			452,000
5	Projekte ish Komuna Kthelle	2015	539,999			539,999
6	Projekte ish Komuna Fane	2015	370,000			370,000
	<b>Shuma</b>		<b>6,230,914</b>			<b>6,230,914</b>

Burimi: Bashkia Mirditë

Kjo paraqitje e llogarisë 202 ÷Studime e kërkime është bërë në përputhje me;

- ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 ÷Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare në neni 6,9 dhe 10
- UKM nr. 2, datë 08.05.2003 ÷Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit, i ndryshuar, pika 6, nën pika 6b.

##### Mbi Aktive afatgjata financiare

##### Testet substanciale



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport auditimi mbi auditimin e ushtruar në Bashkinë Mirditë me objekt “Auditim financiar”

Aktive Afatgjata Financiare rezultojnë në fund të viti 2019 me vlerën 0 lekë dhe në fund të vitit 2020 në vlerën 0 lekë Ky seksion i bilancit kontabël për vitet 2019 dhe 2020 është paraqitur në vlerën 0 lekë siç shihet në Pasqyrën e Pozicionit Financiar të paraqitur më poshtë:

Nr. Reshti	Referenca e Llogarive	EMERTIMI	Ushtrimi i Mbyllur	Ushtrimi Paraardhes
59	25-26	<b>3.Aktive Afatgjata Financiare</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
60	25	Huadhenie e Nenhuadhenie	0	0
61	26	Pjesmarrje në kapitalin e vet	0	0

Burimi: Bashkia Mirditë

Bashkia Mirditë, në Qendrën Kombëtare të Biznesit, paraqitet si pjesëmarrëse me 100 % të Ujësjetllës Kanalizime Mirditë Sh.a me NUIS përkatëse J.....L.

Vlera aksionare që Bashkia Mirditë zotëron në Ujësjetllës Kanalizime Mirditë Sh.a prej vitit 2016 është 70,867,000.00 lekë e cila është shoqëri aksionere me objekt òShërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm i konsumatoreve dhe shitja e tij. Mirëmbajtja e sistemit/eve të furnizimit me ujë të pijshëm. Prodhimi dhe/ose blerja e ujit për plotësimin e kërkesës së konsumatorëve. Shërbimi i grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujrave të ndotura, shitja e tij. Mirëmbajtja e sistemeve të ujrave të ndotura, si dhe të impianteve të pastrimit të tyre.

Kjo vlerë e kapitalit me 100% aksione në pjesëmarrje të Bashkisë Mirditë në òUjësjetllës Kanalizime Mirditë Sh.a ò paraqitet në aktivet afatgjata financiare të Bilancit kontabël 2020, më konkretisht në llogarinë 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta” në zbatim të urdhrorit të ministrit nr.64 datë 22.07.2014 òPër shpallje të Standarteve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuar ò me Standartin Kombëtar të Kontabilitetit nr.5 òAktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatgjata Jomateriale ò pika 55, 56, 57 si dhe me Standartin Ndërkombëtar të Kontabilitetit nr.28 òInvestime në Pjesëmarrje ò pika 35 ku citohet “Një investim në një pjesëmarrje kontabilizohet në pasqyrat financiare individuale të investorit në përputhje me paragrafet 37-42 të SNK 27 e cila thotë:

*Kur përgatiten pasqyra financiare individuale, investimet në filiale, në njësitë ekonomike të kontrolluara bashkarisht dhe në sipërmarrjet që nuk janë klasifikuar si të mbajtura për shitje (ose të përfshira në grupin e nxjerrjes jashtë përdorimit që është klasifikuar si i mbajtur për shitje) në përputhje me SNRF 5 do të llogariten ose:*

*(a) me kosto, ose*

*(b) në përputhje me SNK 39.*

#### **Titulli i gjetjes 8:** Mbi kontabilizimin e llogarisë 26 òAktivet Afatgjata Financiare.

**Situata:** Kapitalit me 100% aksione në pjesëmarrje të Bashkisë Mirditë në òUjësjetllës Kanalizime Mirditë Sh.a përbën investim me vlerë kontabël (kosto) 70,867,000.00 lekë dhe investori është Bashkia Mirditë, për të cilën nuk janë reflektuar në gjendjen e llogarisë 26 fitim humbjet nga pjesa e aksioneve për vitet 2016-2020. Kjo procedurë mospasqyrimi në Aktivet Afatgjata Financiare të Bilancit Kontabël të vlerës së aksioneve të cilat janë investime në pjesëmarrje me vlerë kontabël 70,867,000.00 lekë përbën shtrembërim të informacionit financiar.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport auditimi mbi auditimin e ushtruar në Bashkinë Mirditë me objekt "Auditim financiar"

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimi nr.8/2018 për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të PF vjetore në NJQPöpika 2.1..

**Kriteri:**UMF nr.64 datë 22.07.2014 për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuarës me Standartin Kombëtar të Kontabilitetit nr.5 Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatgjata Jomateriale pika 55, 56, 57 si dhe me Standartin Ndërkombëtar të Kontabilitetit nr.28 Investime në Pjesëmarrje pika 35

**Ndikimi/Efekti:**Mos regjistrimi në kontabilitet dhe deformim i informacionit financiar për sa i përket gjendjes kontabël të paraqitur në Pasqyrat e Pozicionit Financiar për vitet 2018-2020 të llogarisë 26 Pjesëmarrje në kapitalin e vetë, gjendje kjo e nën vlerësuar.

**Shkaku:** Mos njohja dhe mos zbatim i ligjit nr. 9228 datë 29.04.2004 për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, urdhrit nr. 64 datë 22.07.2014 për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuarës, Standardit Kombëtar të Kontabilitetit nr.5 Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatgjata Jo materiale dhe Standardit Ndërkombëtar të Kontabilitetit nr. 28 Investime në Pjesëmarrje.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandimi:**Nëpunësi Zbatues, Drejtorja e Financës dhe Buxhetit të marrë masa për të bërë sistemimet në kontabilitet dhe regjistrimin e pjesëmarrjes 100% në kapitalin aksionar të Ujësjetës Kanalizime Mirditë Sha me vlerë kontabël **70,867,000.00 lekë** në debi të llogarisë 26 Pjesëmarrje në kapitalin e vetë dhe kredi të llogarive financiare të klasës 5, për pjesëmarrjen me kapitalin e vetë.

*Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi: Drejtorja e Menaxhimit Financiar dhe Buxhetit znj. F. F., Përgjegjëse e zyrës së Financës znj. V. Gj.*

### Mbi Aktivet e afatgjata materiale (AAM)

**Titulli i gjetjes 9:** Mbi kontabilizimin e Aktiveve afatgjata materiale, pa titull pronësie.

- **Llogaritë e Klasës 21 "Aktivet Afatgjata Materiale"**, AAM sipas të dhënave të pasqyruara për vitin ushtrimor 2020, paraqiten në shumën 122,136,920,466 lekë. Në vitin paraardhës 2019, vlera totale e AAM-ve paraqitet në shumën 122,048,817,605 lekë, me një shtesë të AAM-ve në shumën 233,201,713 lekë, si dhe të pakësimeve të AAM-ve për 2,938,214 lekë që kanë ardhur kryesisht si rezultat i nxjerrjes jashtë përdorimit të AQT në Bashkinë Mirditë dhe amortizimi i tyre në vlerën 142,160,637 lekë.

Duke analizuar veprimet e shtesave dhe pakësimeve të AAM-ve sipas të dhënave të siguruar nga zyra e financës paraqiten si në tabelën më poshtë:

Nr.	Llogaria	Emërtimi	Gjendja me 31.12.2019	SHTESA	PAKSIME	Gjendja me 31.12.2020
1	210	Toka,troje,Terene	9,962,953	0	0	9,962,953
2	211	Pyje,Kullota Plantacione	119,419,757,580	0	0	119,419,757,580
3	212	Ndertime e Konstruksione	1,327,893,632	123,169,780	52,030,588	1,399,032,824
4	213	Rruge,rrjete,vepra ujore	1,185,508,215	87,295,811	69,336,498	1,203,467,528
5	214	Instalime teknike, makineri,paisje,vegla pune	39,884,030	18,527,216	10,969,277	47,441,969

**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT****Raport auditimi mbi auditimin e ushtruar në Bashkinë Mirditë me objekt “Auditim financiar”**

6	215	Mjete transporti	15,748,042	2,827,200	10,046,348	8,528,894
7	218	Inventar ekonomik	50,063,153	1,381,706	2,716,141	48,728,718
		<b>TOTALI</b>	<b>122,048,817,605</b>	<b>233,201,713</b>	<b>145,098,851</b>	<b>122,136,920,466</b>

Burimi: Bashkia Mirditë

- **Llogaria. 210 “Toka, Troje, Terrene”** është në vlerën 9,962,953 lekë e pandryshuar dhe në 2020 njëlloj si vitet e mëparshme, për të cilën **nuk ka inventar kontabël dhe as inventar fizik.**

Pershkrimi i aktivitet	Cope	Data e hyrjes, viti	Vlera e shpenz. Kapitale	Vlera e blerjes	Vendndodhja	Personi përgjegjes	Vlera e ak.e amortizimit
<b>TERRENE</b>							
Fusha e sportit Rrëshen	1			9,962,953			
<b>SHUMA TOTALE 210</b>				<b>9,962,953</b>			

- **Llogaria 211 “Pyje, Plantacione”** paraqitet e pandryshuar prej 119,419,757,580 lekë e pandryshuar dhe në 2020 njëlloj si vitet e mëparshme, **për të cilën nuk ka inventar kontabël, dhe as inventar fizik, por vetëm VKM nr.433, datë 8.6.2016 e transferimit të administrimit të pyjeve dhe kullotave nga MM në administrim të NJQV.**

- **Llogaria e aktivitet 212 “Ndërtesa dhe konstruksione”** e cila pasqyron gjendjen e asetëve për llogari të Bashkisë Mirditë, në fund të vitit 2019 rezulton me një kosto historike 1,327,893,632 lekë dhe në fund të vitit 2020 rezulton me një kosto historike 1,399,032,824 lekë. Lista me kosto historike e ndërtesave dhe konstruksioneve sëbashku me përllogaritjen e amortizimit total dhe vjetor për vitin 2020 paraqitet në aneks 3.1;

Kontabilizimi i tyre në librat e kontabilitetit dhe pasqyrat financiare është kryhet pa u mbështetur në një dokumentacion vërtetues, siç është titulli i pronësisë, ku gjatë auditimit në terren u evidentua se Bashkia Mirditë nuk ka inicuar procesin për rregjistrimin e tyre. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimi nr.8/2018 për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të PF vjetore në NJQPöpika 16,18.

Këto veprime janë bërë në kundërshtim me VKM nr. 510, datë 10.06.2015 për inventarizimin dhe hipotekimin e të gjitha pronave të paluajtshme dhe të luajtshme, Kreu VI për transferimin i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme

**Kriteri:** VKM nr. 510, datë 10.06.2015 për inventarizimin dhe hipotekimin e të gjitha pronave të paluajtshme dhe të luajtshme, Kreu VI për transferimin i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme, ku cilësohet:

01. Bashkia është subjekti juridik që trashëgon të drejtat e pronësisë, të luajtshme dhe të paluajtshme të Njësisë që Shkrihen (NJSH). Nga momenti i konstituimit të organeve përfaqësuese dhe ekzekutive ajo ushtrinë të drejtën e pronësisë si dhe të drejta të tjera sipas mënyrës të përcaktuar me ligj.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport auditimi mbi auditimin e ushtruar në Bashkinë Mirditë me objekt “Auditim financiar”

2. NJSH-të duhet të plotësojnë dhe depozitojnë pranë bashkisë inventarin e të gjitha pronave të paluajtshme dhe të luajtshme në pronësi. Për pronat e paluajtshme inventari duhet të përmbajë edhe informacionin për fazën e regjistrimit në të cilën ndodhen.

VKM nr.433, datë 8.6.2016 òPër transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe të Kullotave Publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/Bashkive.

**Ndikimi/Efekti:**Mungesa e inventarizimit dhe regjistrimit në ASHK të pasurive të njësive vendore, si toka, troje,terrene, pyje, kullota, plantacione, ka sjellë mos pasqyrimin në pasqyrat financiare të njësive vendore për vitin 2019 dhe 2020, duke bërë që këto pasqyra të mos paraqesin vlerën e saktë të këtyre aseteve të njësive vendore.

Nga ballafaqimi problematikës gjatë procesit të auditimit në terren, ndërmjet evdientimit të objekteve ndërtesa e kontratime që pasqyrojnë DPZHT me ato që pasqyrojnë në kontabilitet nga Drejtoria e Financës ka rezultuar se nuk janë ndërmarrë procedurat të mëtejshme për rivlerësim për shkak të kostos që kërkon kryerja e këtij shërbimi.

**Rëndësia:** e lartë

**Rekomandimi:**Kryetari i Bashkisë Mirditë në bashkëpunim me sektorin e buxhetit dhe financës, të nxisin procedurat për sigurimin e dokumentacionit vërtetues siç është titulli i pronësisë për pronat òToka, Troje, Terrene, Pyje, Plantacione, Ndërtesa dhe Konstruksione, vlerësimin e tyre sipas inventarit dhe paraqitjen e vlerës në Pasqyrën e Pozicionit Financiar.

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi: Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe Buxhetit znj. F. F., Përgjegjëse e zyrës së Financës znj. V. Gj.**

#### Titulli i gjetjes 10: Mbi kontabilizimin e Llogarisë 215 òMjete transporti

- **Llogaria 215 “Mjete transporti”** paraqet vlerën e mjeteve të transportit në pronësi të Bashkisë Mirditë më datë 31.12.2020 në shumën 8,528,894 lekë. Krahasuar me vitin e mëparshëm 2019 në vlerën 15,748,042 lekë. Që do të thotë se gjatë vitit 2020 ka patur paksime në Llogarinë 215 òMjete transporti për vlerën (-7,219,148 lekë). Mirëpo ky pakësim nuk vjen i saktë duke qenë se është llogaritur gabim vlera e amortizimit të kësaj llogarie. Referuar normës së amortizimit kjo vlerë duhet të jetë 1,613,817 lekë dhe si rezultat vlera e Llogarisë 215 òMjete transporti më 31.12.2020 në pasqyrat financiare duhet të jetë 14,134,225 lekë.

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendja në 01.01.2020	15,748,042
Shtesa gjatë vitit 2020 (D)	2,827,200
Pakësime gjatë vitit 2020 (K)	10,046,348
<b>Gjendja në 31.12.2020 (D)</b>	<b>8,528,894</b>

Burimi: Bashkia Mirditë

Sistemimi i llogarisë duhet të bëhet për vlerën e amortizimit 1,613,817 lekë si mëposhtë:

Artikulli	Amortizimi për	Vlera në bilanc	Si duhet të jetë	Diferenca
215	Mjete transporti	10,046,348	1,613,817	8,432,531

Burimi: Bashkia Mirditë

**Kriteri:**UMF nr. nr.8 datë 09.03.2018 òPër Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore, pika 36. Ligji nr. 10296 òPër menaxhimin financiar dhe





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport auditimi mbi auditimin e ushtruar në Bashkinë Mirditë me objekt “Auditim financiar”

kontrollinö neni 6, udhëzimi nr. 30 datë 27.12.2011 për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikë pikat nga 26-30, 74, 96-101, 102 dhe 103

**Ndikimi/Efekti:** Paraqitja jo e saktë në pasqyrat financiare e vlerave përkatëse të Llogarisë 215 ÷Mjete transporti., keq informon subjektin mbi gjendjen reale si dhe përdoruesit e pasqyrave financiare të Bashkisë Mirditë.

**Shkak:** Mosnjohje e legjislacionit të fushës.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandimi:** Nëpunësi zbatues, të marrë masa për sistemimin e llogarisë 215 ÷Mjete transporti, për vlerën **6,915,077lekë** duke korrigjuar normën e amortizimit të llogaritur gabim në pasqyrat financiare të vitit 2020.

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi: Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe Buxhetit znj. F. F., Përgjegjëse e zyrës së Financës znj. V. Gj.**

- **Llogaria kontabël 218 “Inventar ekonomik”** përfaqëson inventarin ekonomik në përdorim nga shkollat, kopshtet, çerdhet, njësitë administrative, institucionet e Bashkisë Mirditë. Sipas pasqyrave financiare të Bashkisë Mirditë gjendja e llogarisë 218 më datë 31.12.2020 paraqitet në vlerën 48,728,718 lekë. Krahasuar me vitin 2019 llogaria 218 ÷Inventari ekonomik është rritur për vlerën 50,063,153 lekë, rezultati i së cilës paraqitet si në tabelën mëposhtë:

Levizjet Llog. 218 “Inventar ekonomik” për vitin 2020, vlera	
Çelje me 01.01.2020	50,063,153
Blerje me pagesë (D)	813,600
Shtesa pa pagesë donacione dhurata	568,106
Dalje (K)	806,289
Amortizimi i vitit i akumuluar 2020	1,909,852
Gjendja me 31.12.2020 (D) Teprica Neto	48,728,718

Burimi: Bashkia Mirditë

Llogaria 218 ÷Inventar ekonomik amortizimin e akumuluar vjetor sipas amortizimit të kontabilitetit dhe analizës në regjistrin e aktivitetit paraqitet 14,338,235 lekë duke përdorur normë amortizimi 20%, në përputhje me UMF nr. nr.8 datë 09.03.2018 “Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore, pika 36 ku specifikohet “ Në lidhje me amortizimin e aktiveve afatgjata për sektorin publik, amortizimi i këtyre aktiveve duhet të llogaritet sipas normave të përcaktuara ”.

- **Llogaria 219 “Amortizimi i AAGJM & AAJM:** Kjo llogari sipas pasqyrave financiare të Bashkisë Mirditë në fund të vitit 2020, paraqitet në vlerën 1,209,494,447 lekë, rezultati i së cilës ka ardhur i pasqyruar si në tabelën mëposhtë:

### Pasqyra statistikore nr. 7.b “Akivet afatgjata me vlerë neto”

Nr.	EMERTIMI	Teprica ne fillim	Shtesat gjate vitit		Paksimet gjate vitit		Teprica ne Fund		
		Teprica	Kosto	Amortizim	Kosto	Amortizim	Kosto	Amortizim	Teprica



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport auditimi mbi auditimin e ushtruar në Bashkinë Mirditë me objekt "Auditim financiar"

Reference Llogarije		Neto	Historike		Historike		Historike	Akumuluar	Neto
b	c	3	4	5	6	7	8	9	10
<b>20</b>	<b>I. AAGJ/JO MATERIALE</b>	<b>6,230,914</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>6,230,914</b>	<b>0</b>	<b>6,230,914</b>
201	Prime te emisionit dhe rimbursimit te huave	0					0	0	0
202	Studime dhe kerkime	6,230,914					6,230,914	0	6,230,914
203	Koncesione, patenta,licenca e tjera ngjashme	0					0	0	0
<b>21- 28</b>	<b>II. AAGJ/ MATERIALE</b>	<b>122,048,817,604</b>	<b>233,201,713</b>	<b>142,160,637</b>	<b>2,938,214</b>	<b>0</b>	<b>123,346,414,913</b>	<b>1,209,494,447</b>	<b>122,136,920,466</b>
210	Toka,troje,Terene	9,962,953					9,962,953	0	9,962,953
211	Pyje,Kullota Plantacione	119,419,757,580					119,419,757,580	0	119,419,757,580
212	Ndertime e Konstruksione	1,327,893,632	123,169,780	52,030,588			1,643,514,156	244,481,332	1,399,032,824
213	Rruge,rrjete,vepra ujore	1,185,508,215	87,295,811	69,336,498			2,091,938,955	888,471,427	1,203,467,528
214	Instalime teknike,makineri,pajsje,vegla pune	39,884,029	18,527,216	8,837,351	2,131,925		73,511,728	26,069,759	47,441,969
215	Mjete transporti	15,748,042	2,827,200	10,046,348			44,662,588	36,133,694	8,528,894
216	Rezerva shtetore	0					0	0	0
217	Kafshe pune e prodhimi	0					0	0	0
218	Inventar ekonomik	50,063,153	1,381,706	1,909,852	806,289		63,066,953	14,338,235	48,728,718
24	Aktive te Qend.te trupezuara te demtuara	0					0	0	0
28	Caktime	0					0	0	0
	<b>T O T A L I (I + II)</b>	<b>122,055,048,518</b>	<b>233,201,713</b>	<b>142,160,637</b>	<b>2,938,214</b>	<b>0</b>	<b>123,352,645,827</b>	<b>1,209,494,447</b>	<b>122,143,151,380</b>

Burimi: Bashkia Mirditë

Përlllogaritja e amortizimit të AAGJM-ve është bërë në përputhje me normat e amortizimit sipas llojit të aktivit të përcaktuar në Udhëzimin nr.8, datë 09.03.2019 për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore, në njësitë e qeverisjes së përgjithshme, pika 36.

Normat e amortizimit sipas llojit të aktivit të llogaritura nga Bashkia Mirditë, janë si më poshtë:

- ndërtesat dhe konstruksionet, linja teknologjike, makineri e pajisje 5 %
- inventarin ekonomik (aktive të tjera afatgjata materiale mbi baze grupimi) 20 %
- për pajisjet kompjuterike, informatike (mbi bazë grupimi) 25%
- për mjetet e transportit 20%
- për aktivet afatgjata jomateriale (metoda lineare) 15 %

#### Mbi Investimet

- **Llogaria 230 dhe 231 "Investime"** për aktive afatgjata jo materiale dhe materiale sipas të dhënave të paraqitura në Pasqyrën e Pozicionit Financiar për vitin 2020, paraqiten në vlerën 0 lekë. Ky vlerësim financiar përkon me tabelën analitike të AAGJ materiale dhe jomateriale sipas tabelës mëposhtë. Në Pasqyrën statistikore nr. 6 "Investimet dhe burimi i financimit" shpenzimet për investime paraqiten në shumën 123,346,414,913 lekë ndërkohë që **kjo vlerë nuk del ne aktivin e bilancit sepse është mbyllur me klasen 2, aktivet afatgjata materiale**

Nr.	Emërtimi i investimit	Vlera
1	Aktive Afatgjata jomateriale	0
2	Aktive Aftagjata materiale	0



## KONTROLLI I LARTË I SHETIT

### Raport auditimi mbi auditimin e ushtruar në Bashkinë Mirditë me objekt "Auditim financiar"

3	<b>Totali</b>	0
---	---------------	---

Burimi: Bashkia Mirditë

Për investimet e kryera gjatë vitit 2020, nuk është debituar saktë llogarinë 231 dhe kredituar llogaritë e klasës 4. Në fund të vitit, me kapitalizimin e tyre është kredituar llogaria 231 dhe është debituar llogaria 20 dhe 21 "Aktive afatgjata". Në mënyra analitike aktivet afatgjata materiale dhe jomateriale paraqiten në aneksin 3.2.

### 1.3 PASIVET (DETYRIMET)

#### Pasivet Afatshkurtra

- **Llogaritë e klasës 4**, në pasiv të Pasqyrës së Pozicionit Financiar, janë llogari të pagueshme ato paraqesin detyrimet e Bashkisë Mirditë më 31.12.2020, kundrejt furnitorëve, pagat e punonjësve të muajit dhjetor 2020, detyrimet kundrejt tatimeve, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të muajit dhjetor 2020, kreditorë për mjete në ruajtje të cilat kryesisht kanë të bëjnë me garancitë e kontratave, kreditorë të ndryshëm etj., si më poshtë:

Llogaritë		Viti 2020	Viti 2019	Diferenca/ndryshimi
401-408	Furnitore e llogari te lidhura me to	598,789	11,288,467	10,689,678
42	Detyrime ndaj personelit	14,199,094	15,590,744	1,391,650
431	Detyrime ndaj shtetit per tatim taksa	939,220	954,712	15,492
435	Sigurime Shoqerore	4,030,027	4,031,086	1,059
436	Sigurime Shendetesore	552,610	551,448	-1,162
437,438,	Organizma te tjere shteterore	0	0	0
466	Kreditore per mjete ne ruajtje	23,568,322	33,489,055	9,920,733
467	Kreditore te ndryshem	66,194,216	67,707,235	1,513,019
4341	Operacione me shtetin( detyrime	54,409,038	49,451,782	-4,957,256
	<b>Gjendja më fund të periudhës</b>	<b>164,491,316</b>	<b>183,064,529</b>	<b>18,573,213</b>

Burimi: Bashkia Mirditë

- **Llogaria 401-408 "Furnitorë e llogari të lidhura me to"**, në fund të vitit 2020 është në vlerën 598,789 lekë, paraqet gjendjen e faturave të pa likuiduara nga Bashkia Mirditë më 31.12.2020. Lëvizja e llogarise 401-408 òFurnitorë e llogari të lidhura me toò, paraqitet në tabelën si më poshtë:

<b>Llog. 401-408 "Furnitorë e llogari te lidhura me</b>	
Celje e vitit 2020	27,806,962
Shtesa (K)	232,239,374
Pakësime (D)	242,929,052
<b>Gjendja në 31.12.2020 (K)</b>	<b>78,975,778</b>

Burimi: Bashkia Mirditë

Gjendja e llogarisë 401-408 në shumën **598,789** lekë përbëhet nga fatura të palikuiduara për detyrime të muajit dhjetor, por që likuidohen në vitin pasardhës.

- **Llogaria 42, "Detyrime ndaj personelit"**, sipas pasqyrave financiare të paraqitura pranë Bashkisë Mirditë, paraqitet në vlerën 14,199,094 lekë dhe përfaqëson vlerën e pagave të muajit Dhjetor për t'u paguar në muajin Janar të vitit pasardhës.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport auditimi mbi auditimin e ushtruar në Bashkinë Mirditë me objekt “Auditim financiar”

- **Llogaria 431, “Detyrime ndaj shteti për tatim taksa”**, paraqitet në vlerën 939,220 lekë dhe përfaqëson vlerën për t'u paguar për taksa e tatime ndaj shtetit për periudhat e kaluara si dhe detyrimet e muajit Dhjetor 2020 të cilat do të paguhen në periudhën pasardhëse.
- **Llogaria 435, “Sigurime shoqërore” dhe llogaria 436 “Sigurime shëndetësore”** paraqet vlerën e pa paguar për sigurime shoqërore e shëndetësore për pagat e muajit Dhjetor 2020 si dhe detyrimet e viteve të kaluara përkatësisht në vlerat 4,030,027 lekë dhe 552,610 lekë.

#### **Titulli i gjetjes 11:** Nënvlërësim i llogarisë 466 Kreditorë për mjete nën ruajtje

**Situata :** Sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Bashkisë Mirditë, në fund të vitit 2020 llogaria 466 òKreditorë për mjete nën ruajtjeòparaqitet në vlerën 23,568,322 lekë dhe përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masën 5%, ose shumën 23,568,322 lekë.

<b>Llog. 466 "Kreditorë për mjete në ruajtje"</b>	
Celje e vitit 2020	<b>33,489,055</b>
Shtesa	7,646,989
Pakësime	17,567,722
<b>Gjendja në 31.12.2020</b>	<b>23,568,322</b>

*Burimi: Bashkia Mirditë*

Kjo shumë **nuk është e njëjtë** me terpicën për të cilën Bashkia Mirditë ka rakorduar me degën e thesarit për llogarinë 520.

Një kopje të raporteve të llogarisë 466 dhe nënllogarive përkatëse jepet në aneks 3.3

Nga analiza e kësaj llogarie rezultoi se vlera në fund të vitit 2020, ka pasur në përbërje të llogarisë detyrime për garanci punimesh të bashkisë ndaj subjekteve privatë, garanci këto të cilave u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratat përkatëse të investimit dhe përsëri janë akoma gjendje në llogarinë 466 si shkak i ish Komunave dhe mungesës së informacionit. Në këtë rast garanci të cilave u ka kaluar afati sipas kontratës së lidhur, janë në vlerën 1,169,275 lekë.

**Kriteri:** Ligjin nr. 28/2018 datë 10.05.2018 òPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiareò neni 5, 6, 7, 9 dhe 10ò ; ligjin 10296 datë 08.07.2010 òPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò neni 6, udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 òPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshmeò seksioni òFunksionimi kontabël i llogarive të tjera të klasës 4., Llogaria 466 òKreditorë për mjete në ruajtjeò.

**Ndikimi/Efekti:** Mos regjistrimi në kontabilitet dhe deformim i informacionit financiar për sa i përket gjendjes kontabël të paraqitur në Pasqyrat e Pozicionit Financiar për vitin 2020 të llogarisë 466 òKreditorë për mjete nën ruajtjeò, gjendje kjo e mbi vlerësuar për 1,169,275 lekë

**Shkaku:** Mos njohja dhe mos zbatim i ligjit 9228 datë 29.04.2004 òPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiareò, urdhrit nr.64 datë 22.07.2014 òPër shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuarò, Standardit Kombëtar të Kontabilitetit nr.1 òKuadri i përgjithshëm për përgatitjen e pasqyrave financiareò

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandimi:**Drejtorja e Financës dhe Buxhetit të kryejë njoftimin e subjekteve sipas kontratave përkatëse të investimeve për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për kryerjen e veprimeve të likuidimit të garancisë së punimeve në masën 5% me një vlerë totale **1,169,275 lekë** dhe të kryejë sistemimet përkatëse në llogarinë 466 òKreditorë për mjete nën ruajtjeò.



## KONTROLI I LARTË I SHETIT

### Raport auditimi mbi auditimin e ushtruar në Bashkinë Mirditë me objekt “Auditim financiar”

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi: Drejtorja e Menaxhimit Financiar dhe Buxhetit znj. F. F., Përgjegjëse e zyrës së Financës znj. V. Gj.

- Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm”, paraqiten faturat e palikuiduara, vendime gjyqësore (nëse ka), investime dhe shërbime të cilat nuk bëhen hyrje dhe për vitin 2020 paraqiten në shumën 66,194,216 lekë. Lëvizja e kësaj llogarie gjatë vitit 2020 paraqitet si më poshtë:

Lëvizjet e llogarisë	
Gjendja në 01.01.2020	67,707,235
Shtesa gjatë vitit 2020 (d)	152,868,116
Pakësime gjatë vitit 2020 (k)	154,381,135
<b>Gjendja në 31.12.2020</b>	<b>66,194,216</b>

Burimi: Bashkia Mirditë

Nga auditimi dhe kontrolli i pagesave për investimet e Bashkisë Mirditë nga sistemi SIFQ i thesarit, kemi identifikuar pagesa faturash të cilat paraqiten të likuiduara në 2021, por të parregjistruara në detyrimet e prapambetura të vitit 2020, si mëposhtë:

### Faturat e parregjistruara për vitin 2020

EMR I INS TITUCIONI T	EC_ACCOUNT_DESCRI PTION	KODI PR OJECT	PROJECT_DE SCRIPTION	SHUMA	DATA_FU RNITORIT	DATA_UR DHER_SH PENZIMIT	GL_DATE	DATA_RE GJISTRMI T	DATA_EK ZEKUTIMIT
Bashkia Rre	Shpenz. per rritjen e AQT - nder	I330104	Godina e s herbin	10,271,786	26-Nov-20	08-Apr-21	08-Apr-21	08/04/2021	09/04/2021
Bashkia Rre	Shpenz. per rritjen e AQT - nder	I330104	Godina e s herbin	5,000,000	26-Nov-20	18-Mar-21	18-Mar-21	18/03/2021	19/03/2021
Bashkia Rre	Shpenz. per rritjen e AQT - kons	I8BQ385	Ndërtim i ujës jell	4,923,462	16-Nov-20	23-Feb-21	23-Feb-21	23/02/2021	24/02/2021
Bashkia Rre	Shpenz. per rritjen e AQT - nder	I330135	Rik I ambjenteve	3,980,542	06-May-20	10-Feb-21	10-Feb-21	10/02/2021	11/02/2021
Bashkia Rre	Shpenz. per rritjen e AQT - nder	I330134	Rik I plot god I.2.	3,837,764	28-Apr-20	10-Feb-21	10-Feb-21	10/02/2021	11/02/2021
Bashkia Rre	Shpenz. per rritjen e AQT - nder	I330116	Zyrat Rrubik	3,209,346	31-Dec-20	10-Feb-21	10-Feb-21	10/02/2021	11/02/2021
Bashkia Rre	Shpenz. per rritjen e AQT - nder	I330134	Rik I plot god I.2.	2,857,725	12-Jun-20	10-Feb-21	10-Feb-21	10/02/2021	11/02/2021
Bashkia Rre	Shpenz. per rritjen e AQT - kons	I330113	Furnizim me ene	2,233,549	03-Dec-20	08-Apr-21	08-Apr-21	08/04/2021	09/04/2021
Bashkia Rre	Shpenz. per rritjen e AQT - kons	I330128	Rehabilitim i Kan	973,028	23-Dec-20	18-Mar-21	18-Mar-21	18/03/2021	19/03/2021
Bashkia Rre	Shpenz. per rritjen e AQT - nder	I330107	10% shtese kont	822,608	08-Apr-19	10-Feb-21	10-Feb-21	10/02/2021	11/02/2021
Bashkia Rre	Shpenz. per rritjen e AQT - kons	I330055	Pro jekte s upervi	810,948	22-May-19	18-Mar-21	18-Mar-21	18/03/2021	19/03/2021
Bashkia Rre	Shpenz. per rritjen e AQT - nder	I330108	10% shtese kont	539,279	10-Dec-19	10-Feb-21	10-Feb-21	10/02/2021	11/02/2021
Bashkia Rre	Shpenz. per rritjen e AQT - nder	I330134	Rik I plot god I.2.	396,990	28-Apr-20	10-Feb-21	10-Feb-21	10/02/2021	11/02/2021
Bashkia Rre	Shpenz. per rritjen e AQT - te tje	I330109	10% shtese kont	314,480	30-Oct-19	10-Feb-21	10-Feb-21	10/02/2021	11/02/2021
Bashkia Rre	Shpenz. per rritjen e AQT - kons	I330055	Pro jekte s upervi	270,261	31-Dec-20	18-Mar-21	18-Mar-21	18/03/2021	19/03/2021
Bashkia Rre	Shpenz. per rritjen e AQT - te tje	I330109	10% shtese kont	261,619	30-Oct-19	10-Feb-21	10-Feb-21	10/02/2021	11/02/2021
Bashkia Rre	Shpenz. per rritjen e AQT - te tje	I330109	10% shtese kont	156,813	30-Oct-19	10-Feb-21	10-Feb-21	10/02/2021	11/02/2021
Bashkia Rre	Shpenz. per rritjen e AQT - nder	I330116	Zyrat Rrubik	70,654	13-Oct-20	16-Feb-21	16-Feb-21	16/02/2021	17/02/2021
Bashkia Rre	Shpenz. per rritjen e AQT - kons	I8BQ386	Supervizio n puni	49,521	21-Nov-20	23-Feb-21	23-Feb-21	23/02/2021	24/02/2021
				<b>40,980,375</b>					

Burimi : Sistemi SIFQ

Për këtë veprim ato janë njohur dhe regjistruar në aktiv të llogarinë 486 dhe në pasiv të llogarinë 467 për vlerën **40,980,376 lekë** për vitin 2020

**Titulli i gjetjes 12: Nënvlërim i llogarisë 85 òRezultati i ushtrimtò**



## KONTROLLI I LARTË I SHETIT

### Raport auditimi mbi auditimin e ushtruar në Bashkinë Mirditë me objekt “Auditim financiar”

**Situata : Llogaria 85 “Rezultati i ushtrimit”,** paraqitet me tepricë kreditore në vlerën 0 lekë dhe paraqet rezultatin nga funksionimi. Ajo është e barabartë me vlerën e të ardhurave që Bashkia Mirditë trashëgon për t’u përdorur në vitin pasardhës sipas dispozitave ligjore në fuqi dhe në përputhje me akt-rakordimin e mbajtur me degën e thesarit mbi fondet që trashëgohen. Ky veprim është paraqitur gabim dhe duhet të jetë në shumën 25,996,510 lekë si tek (F2) tabela e rakordimit të ardhurave , shpenzimeve dhe rezultati.

**Kriteri:**UMF nr. nr.8 datë 09.03.2018 òPër Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore, pika 36. Ligji nr. 10296 òPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò neni 6, udhëzimi nr. 30 datë 27.12.2011 òPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò pikat nga 26-30, 74, 96-101, 102 dhe103

**Ndikimi/Efekti:** Paraqitja jo e saktë në pasqyrat financiare e vlerave përkatëse të disponibilitetit në thesar, keq informon subjektin mbi gjendjen reali si dhe përdoruesit e pasqyrave financiare të Bashkisë Mirditë.

**Shkak:** Mosnjohje e legjislacionit të fushës.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandimi:** NËpunësi Zbatues, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të marrin masa për sistemimin e llogarisë 85 òRezultati i ushtrimitò për vlerën **25,996,510 lekë**.

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi: Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe Buxhetit znj. F. F., Përgjegjëse e zyrës së Financës znj. V. Gj.**

## 2. Pasqyra e Performancës financiare (F2)

-**Të ardhurat dhe shpenzimet**, e paraqitura në Pasqyrën e Performancës Financiare të Bashkisë Mirditë më datë 31.12.2020 janë të kuadruara me Degën e Thesarit Mirditë, konkretisht:

### Rakordimi të ardhurave

Emërtimi	Vlera sipas Pasqyrës së Performancës	Dokumentimi	Vlera	Dif
Të ardhurat e krijuara gjatë vitit	55,659,031	Akt rakordimi me Degën e Thesarit	55,659,031	0
Granti nga buxheti	624,871,661	Sipas çeljes së buxhetit nga MFE	624,871,661	0
Financim i pritshëm nga buxheti	20,319,740	Sipas llogarisë 7206	20,319,740	0
<b>Totali të ardhurave</b>	<b>700,850,432</b>	<b>Totali të ardhura</b>	700,850,432	<b>0</b>

Burimi: Bashkia Mirditë

### Rakordimi i Shpenzimeve

Emërtimi	Sipas Situacionit	Detyrimet e vitit 2019	Detyrime të vitit 2020	Sipas Pasqyrës së Performancës
600	197,198,030	16,545,456	15,138,314	15,138,314
601	32,205,166	4,582,534	4,582,637	4,582,637
602	111,525,552	49,021,144	26,395,294	26,395,294



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport auditimi mbi auditimin e ushtruar në Bashkinë Mirditë me objekt "Auditim financiar"

604	15,000	0	0	0
606	333,928,000	0	0	0
63		1,626,444	-2,333,370	-2,333,370
<b>Totali</b>	<b>674 871 748</b>	<b>71775578</b>	<b>43,782,875</b>	<b>43,782,875</b>

Burimi: Bashkia Mirditë

-Diferenca në shumën 2,333,370 lekë midis shpenzimeve të paraqitura në Pasqyrën e Performancës Financiare dhe sipas Situacionit përbëhet nga diferenca e vlerës prej 2,333,370 lekë "Ndryshimi i gjendjes së inventarit".

-Në fund të vitit ushtrimor të dy llogaritë e klasës 6 ÷shpenzimetö dhe klasës 7 ÷të ardhuratö, janë mbyllur duke debituar dhe kredituar respektivisht llogarinë 85 ÷Rezultati i veprimtarisë ushtrimoreö, konkretisht:

#### Rakordimi të ardhura, shpenzime dhe rezultati

	Emërtimi Burimi	Pasqyra	Situacioni	Diferenca
I	Totali të ardhura	700,850,432	700,850,432	0
II	Shpenzime	674,871,748	674,871,748	0
III	Rezultati i vitit ushtrimor	25,996,510	25,996,510	0
IV	<b>Rezultati i vitit ushtrimor</b>	<b>700,850,432</b>	<b>700,850,432</b>	<b>0</b>

Burimi: Bashkia Mirditë

-Në Pasqyrën e Pozicionit Financiar, llogaria 85 "Rezultati nga veprimtaria" paraqitet në shumën **25,996,510 lekë**, e njëjtë me Pasqyrën e Performancës Financiare.

### 3. Pasqyra e flukseve monetare (F3)

Pasqyra e Flukseve Monetare, paraqet rrjedhën e likuiditeteve dhe gjendjen më datë 31.12.2020.

Nr. Rubrike	PERMBAJTJA	Periudha Raportuese	Periudha Paraardhëse
(b)	(c)	(1)	(2)
I	Veprimtaritë e shfrytëzimit	230,365,692	295,686,584
II	Veprimtaritë e investimeve	-214,814,192	-294,689,084
III	Transferta e të tjera	-14,554,000	0
IV	Teprica në fillim të vitit ushtrimor	24,999,010	24,754,293
<b>V</b>	<b>Teprica e Likuiditeteve ne fund te vitit ushtrimor</b>	<b>25,996,510</b>	<b>25,751,791</b>

Burimi: Bashkia Mirditë

-Nga kontrollat e kryera rezultoi se teprica e llogarisë së likuiditeteve më datë 31.12.2020, e paraqitur në këtë pasqyrë rezulton në shumën **25,996,510 lekë** dhe kuadron me tepricën e likuiditeteve të paraqitur në Pasqyrën e Pozicionit Financiar, në Aktiv "Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre" e cila paraqitet në shumën **25,996,510 lekë**.

Plotësimi i Pasqyrës së Flukseve monetare është bërë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2019, Kapitulli III, pika 3.6 ÷Rregullat e plotësimit të pasqyrës financiare individuale të flukseve monetareö.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport auditimi mbi auditimin e ushtruar në Bashkinë Mirditë me objekt "Auditim financiar"

#### Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto (F4)

Referenc	EMËRTIMI	Fonde bazë dhe Grante	Fonde të tjera të veta	Rezultatet e Mbartura Teprioc/Deficit	Rezultatet e Ushtrimit Teprioc/Deficit	GJITHËSEJ Aktive/neto
		Kapitale				Fonde/ Neto
101	LAKTIVET NETO/FONDET NETO	122,063,967,803				122,063,967,803
	II.NDRYSHIMET NE AKTIVET/ FONDET NETO(1+2)		0	-145,098,851	235,577,639	90,478,788
	I.NGA BURIME TE BRENDSHME		0	-145,098,851	235,577,639	90,478,788
105,	Nga grantet e brendshme kapitale(+)	122,063,967,803	0	0	217,190,118	1217,190,118
1016, 1059	Nga Transfertat e brendshme te AAGJ, Dhurata ne natyre, (+,-)				18,387,521	18,387,521
12	Nga Rezultatet e mbartura(+,-)					
85	Nga Rezultatet e vitit ushtrimor(+,-)	0	0			
1013	Nga konsumi i AAGJ(-)			-142,160,637		-142,160,637
1015	Nga nxjerrjet jashtepedorimit dhe demtimet(-)			-2,938,214		-2,938,214
	<b>TOTALI</b>	<b>122,063,967,803</b>	<b>0</b>	<b>-145,098,851</b>	<b>235,577,639</b>	<b>122,154,446,591</b>

Burimi: Bashkia Mirditë

-Nga verifikimi i kryer rezultoi se vlera totale e Aktiveve neto/fonde neto të paraqitura në "Pasqyrën e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto", është e barabartë me vlerën e tyre të paraqitur në pasqyrën e "Pozicionit financiar", në shumën **122,154,446,591 lekë**. Në këtë pasqyrë janë paraqitur saktë grantet bazë (çelja e vitit), rezultati i vitit të mëparshëm si dhe rezultatet e ushtrimit.

-Vlera prej 235,577,639 lekë, përfaqëson gjithë shtesat e aktiveve neto/fonde neto gjatë vitit ushtrimor, të pasqyruara në të njëjtën vlerë edhe në Librin e madh në kredi të llogarisë 101 "Fonde bazë".

-Vlera prej 142,160,637 lekë, përfaqëson amortizimin vjetor.

-Vlera prej 2,938,214 lekë, përfaqëson nxjerrjet jashte përdorimit.

-Nga auditimi rezultoi se fondet neto të pasqyruara në Pasqyrën "Ndryshimi në fondet neto/aktivet neto" në shumën **90,478,788 lekë** kuadron me pasqyrimin e tyre në pasqyrën e "Pozicionit financiar".

Plotësimi i Pasqyrës së Aktiveve neto/Fonde neto është bërë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2019, Kapitulli III, pika 3.5 të Rregullat e plotësimit të pasqyrës financiare individuale të ndryshimeve në Aktivet neto/Fondet neto.

**Shënim :** Gjatë shqyrtimit të veprimeve financiare për llogari të programit të rindërtimit, grupi i auditimit vuri re se fondet për zërin të Grandet e rindërtimit çelen si fonde nga ministria e rindërtimit, në të njëjtin grup me transfertën e pakushtëzuar dhe transfertën specifike. Ky veprim vështirëson veprimet e zyrës së financës së NJQV për të identifikuar qartësisht veprimet që lidhen me këtë grup buxheti, si e tillë duke qenë se janë fonde të ministrisë së rindërtimit duhet të çelen me grupin respektiv të kësaj ministrie.

**Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:**





## KONTROLLI I LARTË I SHETIT

### Raport auditimi mbi auditimin e ushtruar në Bashkinë Mirditë me objekt “Auditim financiar”

- Ligjin 9228 datë 29.04.2004 ÷Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare÷ neni 6, 7, 9 dhe 10 dhe ligji 10296 datë 08.07.2010 ÷Për menaxhimin financiar dhe kontrollin÷ neni 6, udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 ÷Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme÷ pika 42.
- Ligji nr. 28/2018 datë 10.05.2018 ÷Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare÷ neni 5, 6, 7, 9 dhe 10÷ ; ligjin 10296 datë 08.07.2010 ÷Për menaxhimin financiar dhe kontrollin÷ neni 6, udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 ÷Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme÷ seksioni ÷Funksionimi kontabël i llogarive të tjera të klasës 4., Llogaria 466 ÷ Kreditorë për mjete në ruajtje÷.
- UMF nr. nr.8 datë 09.03.2018 ÷Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore, pika 36 ku specifikohet ÷ Në lidhje me amortizimin e aktiveve afatgjata për sektorin publik, amortizimi i këtyre aktiveve duhet të llogaritet sipas normave të përcaktuara÷.
- VKM nr.1174, datë 24.12.2020 ÷Për Procedurat e Regjistrimit të AMTP-ve, Saktësimin e Kufijve e Sipërfaqeve, si dhe Normat për Sipërfaqet Shtetërore Shtesë e Pronat Shërbyese÷, ku cilësohet:
  - ÷1.Bashkia është subjekti juridik që trashëgon të drejtat e pronësisë, të luajtshme dhe të paluajtshme të Njërive që Shkrihen (NJSH). Nga momenti i konstituimit të organeve përfaqësuese dhe ekzekutive ajo ushtrin të drejtën e pronësisë si dhe të drejta të tjera sipas mënyrës të përcaktuar me ligj.
  - 2. NJSH-të duhet të plotësojnë dhe depozitojnë pranë bashkisë inventarin e të gjitha pronave të paluajtshme dhe të luajtshme në pronësi. Për pronat e paluajtshme inventari duhet të përmbajë edhe informacionin për fazën e regjistrimit në të cilën ndodhen÷.
- VKM nr.433, datë 8.6.2016 ÷Për transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe të Kullotave Publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/Bashkive÷.

#### 2.4 Të ndryshme të dala gjatë auditimit

##### 2.4.1. “Mbi menaxhimin dhe administrimin e fondeve buxhetore të alokuara për rikuperimin e pasojave të tërmetit të 26 Nëntorit 2019”.

##### Për auditimin e kësaj pike të Programit të Auditimit, Grupi i auditimit është bazuar në:

- Ligjin nr. 97/2019 ÷Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, ÷Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore÷;
- Ligjin nr. 96/2019 ÷Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 8, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, ÷Për përdorimin e procedurës së përsheptuar për subvencionimin e pagesës së qirasë së banesës për familjet e mbetura të pastreha, si pasojë e fatkeqësisë natyrore, tërmetit të datës 26.11.2019÷;
- VKM nr. 26, datë 15.01.2020 ÷Për kryerjen e aktekspertizës së thelluar në ndërtesat e dëmtuara÷;
- VKM nr. 904, datë 24.12.2019 ÷Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit÷;



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport auditimi mbi auditimin e ushtruar në Bashkinë Mirditë me objekt “Auditim financiar”

- VKM nr. 329, datë 16.05.2012 òPër kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimet njerëzore;
- VKM nr. 5, datë 06.01.2020 òPër përcaktimin e rregullave dhe procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet modelò, me ndryshime;
- VKM nr. 282, datë 09.01.2020 òPër disa ndryshime në vendimin nr.5, datë 06.01.2020 të Këshillit të Ministrave për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet modelò, me ndryshime;
- VKM nr. 401, datë 19.05.2020 òPër përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet modelò, etj.

#### Dokumentacioni i vënë në dispozicion nga subjekti:

- Urdhri i brendshëm i ish. Kryetarit të Bashkisë z. N. D., nr. 348, datë 02.12.2019 òPër ngritjen e komisionit teknik për verifikimin në terren të subjekteve të dëmtuara nga tërmeti i datës 26.11.2019 në bashkinë Mirditë, dalë në zbatim të VKM nr. 329, datë 16.05.2012, pika 1, ku cilësohet: ò a) *Evidentimi i subjekteve të dëmtuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimet njerëzore bëhet nga grupi i konstatimit, i cili ngrihet me urdhër të kryetarit të njësisë së qeverisjes vendore të dëmtuar.*

#### Komisioni teknik me përbërje:

1. A. D., Kryetar;
  2. M. P., Anëtar;
  3. B. D., Anëtar.
- Urdhri i brendshëm i ish. Kryetarit të Bashkisë z. N. D., nr. 43, datë 24.02.2020 òPër ngritjen dhe funksionimin e komisionit të posaçëm për procesin e rindërtimitò dalë në zbatim të VKM nr. 904, datë 24.12.2019, pika 16, ku cilësohet: “ *Për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga programet e procesit të rindërtimit, në bazë të kriterëve të përcaktuara në këtë vendim dhe listës së objekteve të vëna në dispozicion nga organi përgjegjës shtetëror, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore, ku është shpallur gjendja e fatkeqësisë natyrore, krijon një komision të posaçëm, i cili vlerëson kërkesat e subjekteve që përfitojnë nga programet e procesit të rindërtimit, në bazë të dokumentacionit përkatës dhe parashikimeve të këtij vendimi, si dhe harton listën e subjekteve që përfitojnë nga programet e procesit të rindërtimit*”.

#### Komisioni i posaçëm me përbërje:

1. A. D., Kryetar;
  2. P. B., Anëtar;
  3. V. B., Anëtar;
  4. E. P., Anëtar;
  5. M. K., Anëtar.
- Urdhri i brendshëm i ish. Kryetarit të Bashkisë z. N. D., nr. 59, datë 10.03.2020 òPër ngritjen e komisionit për rishqyrtimin e ankesave të subjekteve për procesin e rindërtimitò, dalë në zbatim të VKM nr. 5, datë 06.01.2020, pika 21, ku cilësohet: òPër vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga programi i granteve të rindërtimit, në bazë të kriterëve të përcaktuara në këtë vendim, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore ku është shpallur



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport auditimi mbi auditimin e ushtruar në Bashkinë Mirditë me objekt "Auditim financiar"

*gjendja e fatkeqësisë natyrore ose autoriteti përgjegjës krijon një komision të posaçëm, i cili vlerëson kërkesat në bazë të dokumentacionit të kërkuar, sipas këtij vendimi."*;

Komisioni i rishqyrtimit të ankesave me përbërje:

1. M.P. , Ing Gjeoded;
  2. P. P., Ing Konstruktor;
  3. P.P., Ing Konstruktor.
- VKB nr. 54, datë 02.06.2020 "Për miratimin e listave të subjekteve përfitues nga grantet e rikonstruksionit (DS1, DS2, DS3) dhe masës së vlerës për këto subjekte, sipas Aktkonstatimeve dhe Aktekspertizës nga Instituti i Ndërtimit, për Bashkinë Mirditë ";
  - VKB nr. 114, datë 23.12.2020 òPër miratimin e listave të subjekteve përfitues nga grantet e rikonstruksionit (DS1, DS2, DS3) dhe masës së vlerës për këto subjekte, sipas Aktkonstatimeve të konfirmuara nga Instituti i Ndërtimit, për Bashkinë Mirditë;
  - VKB nr.30, datë 30.03.2021 òPër miratimin e kontratës model, për kalimin e masës së grantit të rindërtimit nga Bashkia Mirditë, tek përfituesit, për banesat individuale të dëmtuara nga tërmeti i datës 26.11.2019 për subjektet të cilët kanë kërkuar vetë ndërtimin e banesës, në të njëjtin truall, sipas projektit model te miratuar;
  - VKB nr. 31, datë 30.03.2021 òPër miratimin e masës së përfitimit në vlerë monetare, sipas strukturës së banimit dhe vlerave të preventivit, të projekteve model, për subjektet përfitues të grantit të rindërtimit, të cilët kanë zgjedhur që ndërtimin e banesave ta realizojnë vetë;
  - VKB nr.18, datë 04.02.2020 òPër miratimin e platformës online të aplikimit për programet e rindërtimit dhe manualin e rindërtimit të platformës si dhe manualin e procedurave për përfitimin nga programet e rindërtimit;
  - VKB nr. 47-51, datë 01.06.2020 òMbi miratimin e pagesës së qirasë sipas vlerës së treguat të lirë për familjet e evakuuara nga banesat e tyre të dëmtuara nga tërmeti i datës 26.11.2019;
  - Raport nr. 3337 prot., datë 02.09.2021 òPër miratimin e listës së përfituesve që përfitojnë nga programi i procesit të rindërtimit për banesat individuale dhe kolektive të dëmtuara nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26.11.2019 në Bashkinë Mirditë;
  - Të dhënat e sistemit (database);
  - Shkresat e verifikimit të ligjshmërisë nga Këshilli i Qarkut;
  - Lista e përfituesve më të dhënat përkatëse, për kategorinë e dëmtimeve DS1; DS2 dhe DS3;
  - Dosje të praktikave të aplikantëve (me zgjedhje)

#### **1. Mbi aplikimin dhe hedhjen e të dhënave në aplikacionin "Shtëpia ime".**

Bashkia Mirditë, në zbatim të VKM nr. 5, datë 06.01.2020, me ndryshime, Kapitulli II, pika 13, ka kryer regjistrimin e kërkesave (aplikimeve) në sistemin elektronik (aplikacioni òShtëpia ime).

**Konkluzion:** Nga verifikimet e kryera, për fazën e parë të procesit (regjistrimi), ka rezultuar se, të gjitha dosjet e audituara ishin të regjistruara në sistem, si dhe regjistrimi i të dhënave ishte kryer sipas moduleve që kërkon aplikacioni.

- Lista e formularëve
- Të dhëna në rubrikën "Kërko pronën në ASHK"
- Të dhëna mbi aplikantët
- Të dhëna mbi aplikimin dhe nivelin e dëmtimit;



## KONTROLLI I LARTË I SHETIT

### Raport auditimi mbi auditimin e ushtruar në Bashkinë Mirditë me objekt “Auditim financiar”

- Të dhëna sipas hapave të përcaktuara:
- Gjendja familjare
- Kushtet për të përfituar
- Kushtet familjare
- Banesa në pronësi
- Akt konstatimi
- Dokumentacioni

#### **2. Mbi aplikimin e sistemit të pikëzimit:**

Sipas VKM nr. 5, datë 01.06.2020, pika 16, faza e dytë fillon në momentin e vënies në zbatim të programeve të procesit të rindërtimit.

Bashkia Mirditë ka ndjekur procedurat, si më poshtë vijon:

#### **Titulli i gjetjes 13: Mbi përcaktimin e sistemit të pikëzimit**

**Situata:** a. Bashkia Mirditë, ka miratuar sistemin e pikëzimit, si pjesë integrale e Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 438/1, datë 04.02.2020 për miratimin e platformës online të aplikimit për programet e rindërtimit dhe manualin e përdorimit të platformës si dhe manualin e procedurave për përfitimin nga programet e rindërtimit, sipas të cilit është vendosur sistemi i mëposhtëm i pikëzimit, jo në përputhje me renditjen e përcaktuar në VKM nr. 5, datë 06.01.2020, pika 17, konkretisht:

Nr.	Kriteret e pikëzimit	Pikët
1	Familje që ka humbur familjarët nga fatkeqësia natyrore;	-
2	Familje një prindërore që ka në ngarkim fëmijë, ku përfshihen edhe vajzat nëna;	6
3	Familje që ka në përbërje personat me aftësi të kufizuara;	10
4	Pensionist;	7
5	Familje në skemën e ndihmës ekonomike;	10
6	Familje me të rënë në krye të detyrës;	-

Referuar pikëzimit të mësipërm, të miratuar nga Bashkia Mirditë me nr. 438/1, datë 04.02.2020, rezulton se grupi ÷Pensionistë i listuar i katërti në radhën e prioriteteve është vlerësuar me më pak pikë se grupi e tjetër i pesti ÷Familje me skemën e ndihmës ekonomike dhe kjo e fundit është vlerësuar po njësoj sa kategoria e dytë ÷Familje që ka në përbërje personat me aftësi të kufizuara duke mos ndjekur rradhën e prioriteteve të përcaktuar në kuadrin ligjor.

**Kriteri :** VKM nr. 5, datë 06.01.2020, pika 17. Kriteret e përparësisë për renditjen e përfituesve janë, si më poshtë vijon:

- a) familjet që kanë humbur familjarët nga fatkeqësia natyrore;
- b) familjet njëprindërore që kanë në ngarkim fëmijë, ku përfshihen edhe vajzat nëna;
- c) familjet që kanë në përbërje personat me aftësi të kufizuara;
- ç) të moshuarit, të cilët kanë mbushur moshën e pensionit;
- d) familjet në skemën e ndihmës ekonomike;
- dh) të rënë në krye të detyrës.

**Ndikimi/Efekti :** Ndikon në klasifikimin, radhën e përfitimit të masës së shpërblimit.

**Shkaqet:** Nuk ka shkaqe të argumentuara. Nuk është respektuar listimi i prioriteteve të përcaktuara në VKM, për grupin ÷pensionistë.

**Rëndësia:** e ulët



## KONTROLLI I LARTË I SHËTETIT

### Raport auditimi mbi auditimin e ushtruar në Bashkinë Mirditë me objekt “Auditim financiar”

**Rekomandime:** Këshilli Bashkiak i Bashkisë Mirditë të kryej korrigjimet e nevojshme në Vendimin nr. 438/1, datë 04.02.2020, si të pabazuara në VKM nr. 5, datë 06.01.2020, duke vlerësuar drejt shtresat më në nevojë.

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi:** Grupi i posaçëm i ngritur me Urdhrin e Brendshëm nr. 43, datë 24.02.2020 për ngritjen dhe funksionimin e komisionit të posaçëm për procesin e rindërtimit: znj. A. D.; z. P. B.; znj. V. B.; znj. E. P.; znj. M. K.

**Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projekt Raportit të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 1062, datë 04.03.2022 nga znj. A.D. me detyrë Drejtoreshë e DPZHTSS, protokolluar në KLSH me nr.52/2 datë 15.03.2022 “Observacione”, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:**

#### **Pretendimi i subjektit:**

*1. Kriteret e përparësisë për renditjen e përfituesve janë përcaktuar sipas VKM nr.5 datë 06.01.2020 me pikët përkatëse të miratuara në “Manualin e Zbatimit të procedurave për përfitimin nga programet e rindërtimit” i miratuar me VKB nr.438/1, datë 04.02.2020, ku tregon kriteret mbi bazën e të cilave vlerësohet renditja e përfituesve dhe renditja e këtyre kriterëve nuk është e rëndësishme. Në këtë manual ka shënim: NQV-të mund të ndryshojnë sistemin e pikëzimit sipas nevojave. Për këtë nuk mund të mbajë përgjegjësi Komisioni i posaçëm pasi ky komision në momentin e miratimit të Manualit nuk ka ekzistuar. Komisioni është ngritur me Urdhër nr.43, datë 24.02.2020 “Për ngritjen dhe funksionimin e komisionit të posaçëm...” dhe mban përgjegjësi për zbatimin e Manualit dhe akteve ligjore.*

#### **Qëndrimi i Grupit të auditimit:**

Pretendimet e subjektit nuk qëndrojnë, pasi përmbushja e detyrave funksionale të Komisionit të posaçëm, i ngritur si afat kohor pas VKM nr.5/2020 dhe pas VKB 438/1/2020 ku në këtë të fundit është miratuar Manuali i zbatimit të procedurave për përfitimin nga programi i rindërtimit, është të zbatohet kronologjikisht dhe në thelb bazën ligjore e cila citon kriteret e përparësisë për renditjen e përfituesve. Këto kriteret ligjore nuk mund të ndryshohen. Shënimi që ju citoni i referohet sistemit të pikëzimit, pra vlerësimin më 10 apo 9 apo 8 etj, por jo rradhës së përparësisë e cila ndikon drejtëpërsëdrejti në klasifikimin e përfituesve.

**b. Bashkia Mirditë ka kryer klasifikimin e kërkesave për programet e procesit të rindërtimit, ku sipas sistemit të pikëzimit, të miratuar për 5 nivelet e dëmit, kanë rezultuar sa më poshtë;**

Nr.	Niveli i dëmit	Nr i përfituesve
1	DS1	109
2	DS2	37
3	DS3	45
4	DS4 & DS5	147

**Konkluzion:** Nga verifikimi me zgjedhje i disa praktikave në aplikacionin Shtëpia ime, si dhe nga dokumentacioni i ndodhur në dosjet e përfituesve, ka rezultuar se nga komisioni përgjithësisht janë zbatuar kriteret e pikëzimit, duke shmangur kategorinë e parë dhe të fundit të VKM nr. 5, datë 06.01.2020, për mos pasje të rasteve të tilla dhe është proceduar duke vlerësuar me pikët maksimale, grupimet sipas prioritetit të miratuar me VKB dhe shumatores së rasteve të paraqitura për aplikim. Nga verifikimi në sistem, por dhe dokumentacioni i ndodhur në dosje ka



## KONTROLI I LARTË I SHETIT

### Raport auditimi mbi auditimin e ushtruar në Bashkinë Mirditë me objekt “Auditim financiar”

rezultuar se në të gjitha rastet ishin pjesë e dokumentacionit në sistem dhe bashkëngjitur (vërtetimet e ndihmës ekonomike; raporte invaliditeti etj.),

#### **3. Mbi rregullshmërinë e dokumentacionit në dosjet e përfituesve:**

Nga grupi i auditimit, me qëllim dhënien e një konkluzioni përfaqësues për gjithë popullatën, si dhe bazuar në një analizë risku, u audituan 135 nga 298 praktika sipas tabelës anekse në lidhje me rregullshmërinë e dokumentacionit të paraqitur nga aplikuesit dhe të plotësuar nga Bashkia Mirditë, bazuar në VKM nr. 5, datë 06.01.2020 me ndryshime, Kapitulli II ÷ Procedura e miratimit të projekteve model, kushtet, kriteret dhe autoritet përgjegjëse për vlerësimin e aplikimeve pika 14, ku cilësohet: *“Në qoftë se aplikimi paraqet mangësi të të dhënave, sipas parashikimeve të këtij vendimi, struktura/t përgjegjëse të njësisë së vetëqeverisjes vendore ose autoriteti shtetëror përkatës, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e regjistrimit të aplikimit, i kërkon/jnë me shkrim aplikantit të korrigojë pasaktësitë, duke përcaktuar edhe afatin e nevojshëm për plotësimin e tyre. **Struktura/t përgjegjëse ofron/jnë ndihmë aktive për plotësimin e formularëve të aplikimit për përfitimin nga programi i granteve të rindërtimit për cilindo aplikues, duke u kujdesur që çdo individ/familje të marrë informacionin dhe ndihmën e nevojshme për këtë qëllim.**”*

Për verifikimin e dokumentacionit të ndodhur në dosjet e secilit aplikues, por dhe të regjistruar në sistem, u kërkuar dokumentacioni i cilësuar në pikën 13 të VKM nr. 5, datë 06.01.2020, konkretisht:

- a. emrin, atësinë, mbiemrin;
- b. numrin e kërkesës;
- c. datën e dorëzimit/paraqitjes së aplikimit;
- d. objektin e kërkesës, përfshirë edhe preferencën e paraqitur për programin e rindërtimit;
- e. adresën e kërkuarit;
- f. përbërjen familjare në momentin e aplikimit;
- g. Aktin e konstatimit/akt ekspertizën e thelluar, të lëshuar nga çdo person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës tregtare, i pajisur me lejen, licencën ose autorizimin përkatës nga autoritetet shtetërore për vërtetimin e gjendjes së rrezikut për jetën dhe shëndetin, në të cilin vërtetohen dëmet që ka pësuar ndërtesa apo që është shpallur si e pabanueshme;
- h. dokumentin e pronësisë ose çdo akt për fitimin e pronësisë së banesës së dëmtuar.

**Për të përmbushur kërkesat e mësipërme, praktikantët e audituar janë plotësuar me dokumentacionin e mëposhtëm:**

#### **Nr. Lista e dokumentacionit**

- 1 Fletë inventari i dosjes së përfituesit nga procesi i rindërtimit
- 2 Kërkesë për ndihmë
- 3 Formulari (DS1, DS2 ose DS3)
- 4 Akt Konstatimi (vizual) nga Grupi i inspektimit
- 5 Certifikatë familjare
- 6 Kartë identiteti
- 7 Vetë deklaram që posedon vetëm një shtëpi banimi



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport auditimi mbi auditimin e ushtruar në Bashkinë Mirditë me objekt “Auditim financiar”

- 8 Vendimi i Bashkisë për përfitimin nga Programi i rindërtimit
- 9 Kontratë për masën e përfitimit nga grandet e rindërtimit
- 10 Dokument pronësie
- 11 Dokumente që vërtetojnë paaftësinë apo çështje të tjera prioritare

**Nga verifikimi i këtij dokumentacioni kanë rezultuar këto mangësi:**

**Titulli i gjetjes 14:** Mbi rregullshmërinë e dokumentacionit në dosjet e aplikantëve, mbi vlerësimin e dëmit, përfitues nga fondet e rindërtimit.

**Situata nr.1:**Sipas VKM nr. 5, datë 06.01.2020 me ndryshime, Kreu IV òGrantet për rikonstruksionë, pika 2 është cilësuar se përveç sa parashikohet në pikën 13 të Kreut II, aplikimet për grante rikonstruksioni ose riparimi duhet të shoqërohen me:

a) “...**aktin e konstatimit ose ekspertizën e thelluar të lëshuar nga Instituti i Ndërtimit ose grupet përkatëse të inspektimit, njësitë e qeverisjes vendore, ose çdo person fizik juridik subjekt i së drejtës tregtare i pajisur më lejen licencën ose autorizimin përkatës nga autoritet shtetërore për vërtetimin e gjendjes së rrezikut për jetën dhe shëndetin, për të vërtetuar dëmet që ka pësuar** ò;

Sa më sipër, nga ana e Bashkisë Mirditë janë mbajtur;

Akte të konstatimi (vizual), si dhe Formularët e tipit B dhe C, të cilët kanë paraqitur mangësitë e mëposhtme:

- a. Në pothuajse të gjithë rastet e audituara, Aktkonstatimet apo Formularët Tip B apo C, nuk janë të plotësuar, në të gjitha rubrikat e parashikuara nga formati i miratuar;
- b. Në disa raste, Akt konstatimet vizuale, apo Formulari Tip B dhe C, të mbajtur për të vlerësuar dëmet e shkaktuara, nuk kanë të shënuar datën e mbajtjes së tyre;
- c. Në disa raste, inspektimi dhe vlerësimi i objekteve në terren është bërë nga 1 person, ndërkohë që në aktet nënligjore të dala për të rregulluar këtë proces, është kërkuar që verifikimet të kryhen nga grupe inspektimi.
- d. Për të gjitha rastet e vlerësimit të dëmit niveli DS3, i cili ka të bëjë me dëmtime thelbësore deri në të mëdha, që konsistojnë në çarje të moderuara në strukturë ose çarje të mëdha në mure ndarëse dhe mbushëse ose dëmtim i mureve ndarëse dhe perimetralë, **nuk ka vlerësim të përcaktuar nga aktekspertiza e thelluar**, me përjashtim të rasteve DS4 dhe DS5. Në pothuajse të gjitha rastet (sipas tabelës në aneks), në dosjet përkatëse, por dhe në të dhënat e hedhura në sistem, për të vërtetuar masën e dëmit (DS3) janë paraqitur Akt konstatime vizuale nga specialistët e Bashkisë Mirditë, ndërkohë që për këtë nivel dëmi (DS3), duhej të kryhej akt ekspertizë e thelluar.

**Situata nr.2:**“**projektin e rikonstruksionit ose listën e punimeve të riparimit hartuar nga Instituti i Ndërtimit, njësitë e qeverisjes vendore, apo projektuesit e licencuar së bashku me preventivin e punimeve që kërkohen të financohen nëpërmjet grantit**”;

- Në lidhje me këtë kërkesë, nga këqyrja e dosjeve është konstatuar se në asnjë rast nuk ka projekt rikonstruksioni apo listë punimesh. Nga ana e Bashkisë Mirditë, me vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 54, datë 02.06.2020 òPër miratimin e listave të subjekteve përfitues nga grantet e rikonstruksionit (DS1, DS2, DS3) dhe masës së vlerës për këto subjekte, si dhe preventivat tip (DS1, DS2 dhe DS3)ò janë miratuar 6 preventivë tip, për tre nivelet e dëmeve



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport auditimi mbi auditimin e ushtruar në Bashkinë Mirditë me objekt “Auditim financiar”

dhe kategorizimit të tyre (nën dhe mbi 100 m<sup>2</sup> ndërtim) të miratuar nga Bashkia Mirditë, si më poshtë, **preventiv**:

- ✓ Niveli DS1, deri 50 m<sup>2</sup>, 3 zëra punimesh në vlerën 72,425 lekë;
- ✓ Niveli DS1 nga 51 m<sup>2</sup> deri 100 m<sup>2</sup>, 3 zëra punimesh në vlerën 86,980 lekë;
- ✓ Niveli DS1 mbi 100 m<sup>2</sup>, 3 zëra punimesh në vlerën 101,694 lekë;
- ✓ Niveli DS2, deri 50 m<sup>2</sup>, 9 zëra punimesh në vlerën 201,800 lekë;
- ✓ Niveli DS2, nga 51 m<sup>2</sup> deri 100 m<sup>2</sup>, 9 zëra punimesh në vlerën 228,000 lekë;
- ✓ Niveli DS2, mbi 100 m<sup>2</sup>, 9 zëra punimesh në vlerën 262,713 lekë;
- ✓ Niveli DS3, deri 50 m<sup>2</sup>, 9 zëra punimesh në vlerën 400,952 lekë;
- ✓ Niveli DS3, nga 51 m<sup>2</sup> deri 100 m<sup>2</sup>, 12 zëra punimesh në vlerën 450,753 lekë;
- ✓ Niveli DS3, mbi 100 m<sup>2</sup>, 12 zëra punimesh në vlerën 501,426 lekë;

Bazuar në këtë vendim, në të gjitha dosjet e audituara, sipas nivelit të dëmit dhe sipërfaqes së objekteve deri në 50 m<sup>2</sup>, mbi ose nën 100 m<sup>2</sup>, ishin bashkëngjitur preventivat përkatës.

Pra, tre kanë qenë kriteret e përcaktimit të masës së përfitimit:

- Sipërfaqe e banesës (50 m<sup>2</sup>, 51 m<sup>2</sup>-100 m<sup>2</sup> dhe mbi 100 m<sup>2</sup>)
- Niveli i dëmit (DS1, DS2 dhe DS3)

Për rrjedhojë, në rastet e audituara përshkrimi i dëmeve (zërat) dhe sipërfaqet e dëmtuara, të cilësuar në Akt konstatimi vizual, apo Formularin Tip B, kanë përputhje me zërat e punimeve dhe sipërfaqet përkatëse të cilësuar në preventivin tip bashkëngjitur.

Përsa i përket nivelit të masës së përfitimit, është përcaktuar:

DS3 nga 400,000-500,000 lekë;

DS2 nga 200,000-250,000 lekë;

DS1 nga 70,000-100,000 lekë.

Nga Bashkia Mirditë, nuk është tejkaluar niveli maksimal i lejuar i masës së shpërblimit, përcaktuar me VKM nr. 5, datë 06.01.2020 me ndryshime, ku cilësohet se: "Masa e vlerës së rikonstruksionit ose riparimit mënyra e përdorimit dhe monitorimit, sipas pikës 4 të këtij vendimi përcaktohen me VKB, e cila në të gjitha rastet nuk mund të jetë më shumë se 500,000-DS3; 250,000-DS2 dhe 100,000 DS1", por në të gjitha rastet këto kuota janë aplikuar apriori, pa ju referuar dëmeve faktike të objekteve, por preventivave bashkëngjitur, pra është aplikuar kufiri maksimal i lejuar.

**Kriteret:** VKM nr. 5, datë 06.01.2020 ÷Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet modelë, me ndryshime;

- Kreu II ÷Procedura e miratimit të projekteve model, kushtet, kriteret dhe autoritetet përgjegjëse për vlerësimin e aplikimeve, pika 20, ku cilësohet:

*“Dosja e çdo aplikanti duhet të përmbajë dokumentacionin që vërteton deklaratimet e bëra në momentin e aplikimit...”*,

- Kreu IV ÷Grantet për rikonstruksionin”, pika 1 ku cilësohet:

*“Procedurat që parashikohen në këtë vendim zbatohen, për aq sa është e mundur, dhe për aplikimet, miratimin, zbatimin dhe mbikëqyrjen e granteve për rikonstruksionin e shtëpive individuale ose të banesave në ndërtesa (pallate), të cilat janë klasifikuar si objekte të pabanueshme ose të dëmtuara rëndë apo të dëmtuara lehtë dhe që nuk duhen rindërtuar nga e para por kanë nevojë për punime rikonstruksioni ose riparime”.*

- VKM 282, datë 09.04.2020 ÷Për disa ndryshime në VKM nr. 5, datë 01.06.2020, germa a:





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport auditimi mbi auditimin e ushtruar në Bashkinë Mirditë me objekt “Auditim financiar”

- Pika 4, ku cilësohet:  
*Përfitojnë nga grantet e rikonstruksionit edhe individët ose familjet: a) shtëpitë individuale ose banesat e të cilëve kanë pësuar dëmtime thelbësore deri në të mëdha, që konsistojnë në çarje të moderuara në strukturë ose çarje të mëdha në mure ndarëse dhe mbushëse ose dëmtim i mureve ndarëse dhe perimetralë, siç përcaktohet nga aktekspertiza e thelluar;*
- Pika 5, ku cilësohet:  
*Masa e vlerës së rikonstruksionit ose riparimit, mënyra e përdorimit dhe monitorimi, sipas pikës 4, të këtij vendimi, përcaktohen me vendim të këshillit bashkiak të njësisë së vetëqeverisjes vendore, e cila, në të gjitha rastet, nuk duhet të jetë më shumë se:*
  - a. 500 000 (pesëqind mijë) lekë, sipas parashikimeve të shkronjës “a”, të pikës 4, të kreut IV, të këtij vendimi;
  - b. 250 000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë, sipas parashikimeve të shkronjës “b”, të pikës 4, të kreut IV, të këtij vendimi;
  - c. 100 000 (njëqind mijë) lekë, sipas parashikimeve të shkronjës “c”, të pikës 4, të kreut IV, të këtij vendimi.

**Ndikimi/Efekti:** Ka ndikuar në sigurimin e transparencës së këtij procesi, në lidhje me dokumentimin dhe argumentimin e njërës prej kritereve të vlerësimit, niveli i dëmtimit.

**Shkaku nr.1:** Sipas ballafaqimit të kryer gjatë auditimit në terren, por dhe në përfundim të kësaj faze të auditimit, me tiullarin e institucionit dhe specialistët përkatës, shkak, për kryerjen e inspektimeve nga 1 person i vetëm ka qenë gjendja emergjente; volumi i punës dhe mungesa e personelit teknik, për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga tërmeti;

**Shkaku nr.2:** Mungesa e akt ekspertizës së thelluar, ka ardhur si rezultat i kostos së këtij shërbimi të ofruar nga Instituti i Ndërtimit (100,000 lekë për një objekt), numrit të lartë të objekteve, me nivel dëmtimi DS3, si dhe mungesës së fondeve për të përballuar këtë shpenzim, pra pamundësisë financiare.

**Rëndësia:** E mesme

**Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Mirditë të kryej një analizë të thelluar dhe të nxjerri përgjegjësitë për personat konkretë, të cilët gjatë procesit të vlerësimeve të dëmtimeve të shkaktuara nga tërmeti i 29 Nëntorit 2019, nuk kanë plotësuar saktë dokumentacionin e aplikimeve për grante rikonstruksioni ose riparimi, në mënyrë që këto anomalitë të eliminohen në vijim.

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi:**

1. Specialistët e Bashkisë Mirditë, pjesë e inspektimit të objekteve në terren, për mangësitë në plotësimin e Akt konstatimeve vizuale apo Formularëve të tipi B dhe C; znj. A. D.; z. P. B.; znj. V. B.; znj. E. P.; znj. M.K.
2. Ish Nën Kryetare e Bashkisë, në cilësinë e Titullarit të Institucionit, për mangësi në organizimin e këtij procesi, znj. K. P.

**Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projekt Raportit të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 1062, datë 04.03.2022 nga znj. A. D. me detyrë Drejtoreshë e DPZHTSS, protokolluar në KLSH me nr.52/2 datë 15.03.2022 “Observacione”, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:**

**Pretendimi i subjektit:**



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport auditimi mbi auditimin e ushtruar në Bashkinë Mirditë me objekt "Auditim financiar"

1. Disa objekte të vlerësuar nga komisioni i vlerësimit në terren me nivel DS2 dhe DS3, Instituti i Ndërtimit ka kryer Akt ekspertizë të thelluar dhe e ka kaluar në nivel dëmtimi DS4. Gjithashtu për objekte të vlerësuar nga komisioni i vlerësimit në terren me nivel DS4, Instituti i Ndërtimit ka kryer Akt ekspertizë të thelluar dhe e ka kaluar në nivel përforcim të strukturës. Për rastet e tjera që Instituti i Ndërtimit ka verifikuar dhe konfirmuar Akt Konstatimet e Komisionit të vlerësimit, është vlerësuar e panevojshme të bëhet akt ekspertizë e thelluar duke marrë parasysh edhe kostot e këtij shërbimi. Kjo nuk mund të jetë përgjegjësi as e titullarit të institucionit dhe as e Komisionit të Posaçëm.

2. Përfituesit e miratuar me VKB nr.54, datë 02.06.2020, me nivel dëmtimi DS3 kane aplikuar në sistemin e lejeve për Deklaratë Paraprake duke paraqitur Projektin dhe Preventivin e përforcimeve përkatëse. Ndërsa në mbështetje VKM nr. 5, datë 06.01.2020 me ndryshime (VKM nr 401, datë 19.05.2020, kreu IV, pika 2, (Aplikimet shoqërohen me...)

shkronja b; "projektin e rikonstruksionit ose listën e punimeve të riparimit dhe preventivin e punimeve që kërkohen të financohen nëpërmjet grantit per individet ose familjet që përfitojnë vlerën e plotë të rikonstruksionit, sipas pikës 3, të këtij kreu, hartuar nga Instituti i Ndërtimit, njësitë e qeverisjes vendore, apo projektuesit e licencuar";

pika 3.Përfitojnë vlerën e plotë të rikonstruksionit individet ose familjet;

a) shtëpitë individuale ose banesat e të cileve, kur nuk përbëjnë raste si ato të parashikuara në pikën 18, të kreut II të këtij vendimi (Banesat që do rindërtohen nga e para), dhe që janë shpallur të pabanueshme pasi janë demtuar në mbi 2/3 e tyre dhe/ose si pasojë e dëmtimeve të mëdha strukturore ose dëmtimeve shumë të rënda jostrukturore, janë rrezik

shembjeje, vërtetuar me Aktekspertizë të Thelluar. Për këto objekte është kërkuar hartimi I projekteve dhe preventivave nga Instituti I Ndertimit pasi bashkia nuk ka kapacitetet e mjaftueshme për ti hartuar. Kjo kërkon një kosto të konsiderueshme për të cilën Bashkia irditë ka paraqitur kërkesën Ministrisë së Rindërtimit për iratimin dhe akordimin e këtij fondi

#### **Qëndrimi i Grupit të auditimit:**

-Pretendimet e subjektit nuk qëndrojnë, pasi VKM 282, datë 09.04.2020 òPër disa ndryshime në VKM nr. 5, datë 01.06.2020, germa a, pika 4 citon: Përfitojnë nga grantet e rikonstruksionit edhe individët ose familjet: a) shtëpitë individuale ose banesat e të cilëve kanë pësuar dëmtime thelbësore deri në të mëdha, që konsistojnë në çarje të moderuara në strukturë ose çarje të mëdha në mure ndarëse dhe mbushëse ose dëmtim i mureve ndarëse dhe perimetralë, siç përcaktohet nga aktekspertiza e thelluar; Pra rastet e përcaktuara si DS3 që ju citoni, duhet të kalonin të gjitha sipas ciklit ligjor të cituar më sipër, panvarësisht kostove të procesit dhe kushteve emergjente. Baza ligjore është ngritur për këto situata emergjente dhe domosdoshmërisht bazuar në ligjin e buxhetit ju keni përfituar vlerën financiar për rastet e aplikuar pranë Institutit të Ndërtimit. Kjo pjesërisht dhe jo e tëra siç citohet në gjetjen e konstatuar nga grupi i auditimit.

-Pretendimi i subjektit është mot a motë shpjegimi i dhënë nga grupi i auditimit. Duke vlerësuar evidencën mbështetëse të preventivave tip, për secilën nga masat e shpërblimit, grupi i auditimit e ka vlerësuar plotësimin e VKM nr 401, datë 19.05.2020, kreu IV, pika 2, shkronja b



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport auditimi mbi auditimin e ushtruar në Bashkinë Mirditë me objekt “Auditim financiar”

**Titulli i gjetjes 15:** Mbi saktësinë Kontratave të masës së përfitimit, si dhe dokumentacionin (burimin e të dhënave të plotësuar).

**Situata:** Bazuar në VKM nr. 5, datë 06.01.2020, Kreu II ÷Procedura e miratimit të projekteve model, kushtet, kriteret dhe autoritetet përgjegjëse për vlerësimin e aplikimeve, pika 16 germa (dh), kërkohet që Njësia e vetëqeverisjes vendore të hartojë kontratën model të grantit që lidhet midis njësisë së vetëqeverisjes vendore ose autoritetit shtetëror dhe përfituesit sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për kontratat e granteve/dhurimeve apo të ngjashme me to. Në lidhje me këtë kërkesë Bashkia Mirditë ka miratuar Kontratën tip, me VKB nr. nr.30, datë 30.03.2021. Në këtë kontratë është përcaktuar plotësimi i sipërfaqeve të objekteve përfituese, si një prej kriterëve përcaktues të masës së përfitimit.

Nga auditimi ka rezultuar se (të detajuara në Tabelat anekse:

1. Nga 135 praktikat e audituara të përfituesve nga fondi i rindërtimit për pasojave të tërmetit të 26 Nëntorit 2019, vetëm në 25 raste, ose në 18.5 % të tyre, për të vërtetuar pronësinë mbi objektin, ishin paraqitur dokumente pronësie, të cilët kanë të specifikuar sipërfaqet e objekteve;

2. Nga 135 praktika të audituara në të gjitha rastet, nga inspektorët e verifikimit të dëmeve në terren, është specifikuar në aktet e mbajtura sipërfaqe e objektit, gjë e cila ka shërbyer si kriter për vendosjen e masës së përfitimit, referuar pragjeve nën dhe mbi 100 m<sup>2</sup>.

3. Nga 135 praktika të audituara në 18 raste, ose në 7.5 % të tyre, janë evidentuar diferenca në cilësimin e sipërfaqeve të objekteve, të cilësuara në Kontratën e masës së përfitimit dhe sipërfaqeve të cilësuara në Aktkostatime, Dokumente pronësie, apo deklarimi i tyre, nga ASHK.

**Kriteri:** VKM nr. 5, datë 06.01.2020, Kreu II ÷Procedura e miratimit të projekteve model, kushtet, kriteret dhe autoritetet përgjegjëse për vlerësimin e aplikimeve, pika 16 germa (dh); Kontrata tip, miratuar me VKB nr.30, datë 30.03.2021

**Ndikimi/Efekti:** Në dosjet e audituara, të cilat janë evidentuara me pasaktësi në cilësimin e sipërfaqeve, ka rezultuar se vetëm në 5 raste për shumën 450,000 lekë përcaktimi jo i saktë i sipërfaqeve ka ndikuar në masën e shpërblimit. Në këtë rast kemi të bëjmë me përdorim pa efektivitet, efikasitet dhe ekonomicitet të fondeve, të cilat janë nën kufirin e materialitetit të përlllogaritur prej 2,250,000 lekë ( $184,171,809 * 0.7 \% = 1,289,202$ lekë).

**Shkaqet:** Nivel i lartë i informalitetit të ndërtimeve në këtë zonë; Mungesë e stafit të brendshëm për të kryer inspektime të thelluara (matje të objekteve, skica shoqëruese, fotografime etj.); Mungesë fondesh për të kryer ekspertizë të thelluar, ofruar nga Instituti i Ndërtimit;

**Rëndësia:** e mesme

**Rekomandim:** Kryetari i Bashkisë Mirditë dhe GMS, të marrin masa për rishikim të vazhdueshëm të risqeve që vijnë nga situata të paparashikuara, si dhe të hartojnë aktivitete të kontrollit shtesë për minimizimin e tyre.

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi:** Ish Kryetare e Bashkisë, në cilësinë e Titullarit të Institucionit, si dhe palës përfaqësueses të Bashkisë Mirditë në lidhjen e këtyre kontratave, znj. K. P. dhe M. P.

**Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Projekt Raportit të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 1062, datë 04.03.2022 nga znj. A. D. me detyrë**



## KONTROLLI I LARTË I SHETIT

### Raport auditimi mbi auditimin e ushtruar në Bashkinë Mirditë me objekt "Auditim financiar"

**Drejtoreshë e DPZHTSS, protokolluar në KLSH me nr.52/2 datë 15.03.2022 "Observacione", ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:**

#### **Pretendimi i subjektit:**

*1. Paqartesi ne perllogaritjen e mesiperme;*

*Për faktin që pjesa më e madhe e ndërtesave individuale në fshatrat dhe Njësitë Administrative të Bashkisë nuk kanë certifikatë pronësie (Gjë që është marrë parasysht dhe gjatë procesit të Vetdeklarimit duke e hequr fare dokumentin që vërteton të drejtat pasurore), është marrë në përllogartje sipërfaqja faktike e cdo banese individuale.(Kjo dhe në rastet kur një pjesë e benesës ka qenë me certifikate pronësie dhe në fakt ka pasur shtesa mbi atë sipërfaqe). Për këtë arsye gjykoj se nuk ka përdorim pa efektivitet të fondeve.*

*Kjo nuk mund të jetë përgjegjësi e Titullarit të Institucionit dhe as e përfaqësuesve të Bashkisë në lidhjen e kontratave.*

#### **Qëndrimi i Grupit të auditimit:**

-Pretendimet e subjektit citojnë edhe njëherë çfarë ka analizuar dhe konstatuar grupi i auditimit, ku referuar informalitetit të zonës sa i përket elementeve të pronësisë , rastet e devijimeve në dosjet e përzgjedhura nuk përbëjnë shkak për dëm ekonomik në masën e shpërblimit, pasi aplikantët kanë element të tjerë vërtetues sipas citimeve ligjore.

**Titulli i gjetjes 16:** Mbi saktësinë e dokumentacionit vërtetues mbi pronësinë objekteve, të ndodhur në dosjet e aplikantëve, përfitues nga fondet e rindërtimit.

**Situata:** Përsa i përket dokumentacionit që vërteton pronësinë mbi objektin është kërkuar që të paraqitet, çdo lloj dokumentacioni që provon të drejtat e pronësisë mbi objektin e dëmtuar. Në lidhje me këtë kërkesë në aplikacionin "Shtëpia ime", është publikuar një listë me opsione si: (certifikatë pronësie; vërtetim hipotekor; vërtetim fakti; vendim gjykate; kontratë sipërmarrje; kontratë shitblerje; akt dhurimi; leje legalizimi), por nga ana e Bashkisë Mirditë si dokument (zëvendësues-justifikues-vërtetues), është mjaftuar dhënia e koordinatave të pronës si dhe vërtetimi i NJA për banorin aplikant. Këto të dhëna nuk mund të shërbejë për të vërtetuar pronësinë mbi objektin, prandaj nuk është pjesë e listës së dokumenteve që mund të pranohen për të vërtetuar pronësinë mbi objektin.

Nga 135 praktika të audituara, vetëm në 25 raste në dosje kishte dokumentacion që vërteton të drejtën e pronësisë mbi objektin, sipas listimit të tyre në aplikacion. Në të gjitha rastet e tjera, në dosje për të plotësuar këtë kërkesë është pranuar vërtetimi i Administratorit të NJA.

Gjithashtu, duhet të theksojmë se është një zonë me informalitet të lartë urban, ku një pjesë e objekteve janë në proces legalizimi. Për këtë arsye kërkuam dhe na u vu në dispozicion lista e objekteve të cilat janë pjesë e këtij procesi.

Nga verifikimet e kryera ka rezultuar se në...raste (sipas tabelave anekse) kanë rezultuar mospërputhje të sipërfaqeve të cilësuar në Akt-konstatime, Kontratat e masës së shpërblimit me sipërfaqet e objekteve sipas ASHK, por pa efekt financiar në masën e aplikuar të përfitimit

**Kriteri:** VKM nr. 5, datë 06.01.2020, Lista e dokumentacionit të publikuar në aplikacionin "Shtëpia ime", i miratuar si dokumentacion i cili do të shërbejë për të vërtetuar pronësinë mbi objektet.

**Ndikimi/Efekti:** i mesëm

**Shkaqet:**Zonë me nivel të lartë të informalitet urban.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport auditimi mbi auditimin e ushtruar në Bashkinë Mirditë me objekt “Auditim financiar”

**Rëndësia:** e mesme

**Rekomandim:** Kryetari i Bashkisë Mirditë të bashkëpunoj me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës për të ndjekur dhe verifikuar në vijimësi problematikën mbi pronësinë, për të nxjerrë dhe analizuar arsyet e mungesave të këtij dokumentacioni i cili mund të sjellë probleme sociale dhe ligjore në vijimësi.

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi:** Grupi i posaçëm i ngritur me Urdhrin e Brendshëm nr. 43, datë 24.02.2020 me përbërje: znj. A. D.; z. P. B.; znj. V. B.; znj. E. P.; znj. M. K.

#### **4. Mbi rregullshmërinë e transaksioneve financiare të kryera për pagesën e bonusit të qirasë, për familjet e evakuara nga banesat e tyre, për shkak të dëmtimeve nga tërmeti i 26 Nëntorit 2019.**

**Nga auditimi ka rezultuar se:**

Në zbatim të Urdhrit nr. 43, datë 24.02.2020, të Kryetarit të Bashkisë Mirditë, Komisioni i posaçëm për vlerësimin e dëmeve të tërmetit, bazuar në dokumentacionin e paraqitur nga aplikuesit, plotësimin e tyre me të dhëna referuar VKM nr. 5, datë 06.01.2020 me ndryshime, pika 16/b, si dhe dokumentacionin e paraqitur nga grupet e inspektimit, për vlerësimin në terren të dëmeve tërmetit, ka kryer procesin e pikëzimit (*trajtuar më lart*).

Lista pas vlerësimit, bazuar në sistemin e pikëzimit të miratuar me nr. 438/1, datë 04.02.2020 òPër miratimin e platformës online të aplikimit për programet e rindërtimit dhe manualin e përdorimit të platformës si dhe manualin e procedurave për përfitimin nga programet e rindërtimit, si dhe **pas vlerësimit nga ekspertë të institutit të ndërtimit**, është miratuar me VKB nr. 64, datë 30.12.2019; nr.11, datë 22.01.2020; nr.19, datë 26.02.2020; nr.66, datë 30.06.2020; nr.29, datë 30.03.2021; nr.87, datë 30.09.2021 òPër miratimin e pagesës së qirasë, sipas vlerës së tregut të lirë për familjet e evakuara nga banesat e tyre të dëmtuara nga tërmeti datës 26 Nëntor, 2019, si dhe lista e bonusit të qirasë për familjet e dëmtuara nga tërmeti, **në total 182 familje, të cilat kanë përfituar shumën 2,862,000 lekë.**

#### **Vlera e bonusit të qirasë sipas VKB**

Nr.	Sipërfaqe	Vlera e qirasë
1	1+1	12,600
2	2+1	15,400
3	3+1	20,400

#### **Konkluzion:**

1. Vlerësimi i rasteve të mësipërme, përfitues të bonusit të qirasë, është miratuar pasi është kryer verifikimi, ekspertiza e thelluar nga Instituti i Ndërtimit, ndërsa renditja e tyre është kryer referuar sistemit të pikëzimit të miratuar me nr. 438/1, datë 04.02.2020. Kjo procedurë është kryer në përputhje me Aktin Normativ nr. 9, datë 16.12.2019 òPër përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore, neni 34 òAkt ekspertiza e thelluar e ndërtesave të dëmtuara, ku cilësohet: òPër ndërtesat që kanë pësuar dëme dhe që janë shpallur të pabanueshme nga akt konstatimet apo akt vlerësimet paraprake të Institutit të Ndërtimit apo grupet përkatëse të inspektimit, njësitë e vetëqeverisjes vendore ose autoritetet përgjegjëse shtetërore me qëllim garantimin e jetës dhe shëndetit, mund të kryejnë akt ekspertizë të thelluar sipas procedurës të përcaktuar në këtë nen. Akt ekspertiza e thelluar kryhet dhe për të gjitha ato objekte kur sipas



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport auditimi mbi auditimin e ushtruar në Bashkinë Mirditë me objekt “Auditim financiar”

*akt konstatimeve ose akt vlerësimeve paraprake të Institutit të Ndërtimit apo grupeve përkatëse të inspektimit, kërkohet një rivlerësim më i thelluar”.*

2. Nga verifikimi i kryer referuar përfituesve sipas vlerësimit (DS4 dhe DS5), si dhe listë pagesave, ka rezultuar se, nuk kanë rezultuar parregullsi në lidhje me nivelin e qirasë së paguar.

Në të gjitha rastet, pagesa përkatëse, është kryer referuar dy kritereve:

- a. sipërfaqes së objektit të dëmtuar (1+1 ; 2+1 ; 3+1)

3. Nga auditimi, kryqëzimi i të dhënave midis oListët së pikëzimito për nivelin e dëmit DS4 dhe DS5, si dhe oListës së bonusit të qiraveo, nuk rezultuan diferenca, me përjashtim të rasteve të shtuara pas vlerësimit nga Instituti i Ndërtimit, ku për secilin rast është paraqitur Aktekspertiza e thelluar.

#### 5. Buxhetimi, alokimi i fondeve.

##### a. Alokimi i fondeve për rikonstruksionin apo riparimin e objekteve (niveli i dëmit DS1, DS2 dhe DS3).

- Bashkia Mirditëe, në zbatim të VKM nr. 5, datë 06.01.2020, Kapitulli II, pika 3, ku cilësohet: “ Njësia e vetëqeverisjes vendore ose autoriteti shtetëror përgjegjës harton listën e nevojave për grante rindërtimi në territorin në territorin përkatës dhe paraqet kërkesën për grante për rindërtimin e shtëpive individuale ose rikonstruksionin e shtëpive individuale dhe banesave në ndërtesa në bazë të akt ekspertizës së thelluar ose të akt konstatimeve përkatëse, pranë Komisionit Shtetëror të Rindërtimit, si autoriteti përgjegjës i cili shqyrton mundësinë për përdorimin e fondit të rindërtimit për këto qëllime”, i është drejtuar, Komisionit Shtetëror për Rindërtimin, për financimin e listës pjesore të objekteve përfitues, të miratuar me VKB nr. 54, datë 02.06.2020 dhe VKB nr. 114, datë 23.12.2020, si dhe të konfirmuar mbi ligjshmërinë nga Prefekti i Qarkut Lezhë.

Sa më sipër, për Bashkisë Mirditëe janë alokuar fonde në shumën 184,171,809 lekë për vitin 2020 dhe për vitin 2021.

Niveli i Dëmit	Numri i përfituesve (Popullata-2)	Numri i përfituesve		Vlera e kompensimit (lekë)	
		Nën	Mbi	Nën	Mbi
		100 m2, sip.	100 m2, sip.	100 m2, sip.	100 m2 sip.
DS1	109	72	37	6,075,000	3,700,000
DS2	37	21	16	4,725,000	4,000,000
DS3	45	22	23	9,700,000	11,500,000
<b>Totali</b>	<b>191</b>	<b>115</b>	<b>76</b>	<b>20,500,000</b>	<b>19,200,000</b>

- Fondet e vëna në dispozicion, referuar Akt-rakordimit të datës 25.01.2021, të mbajtur midis Bashkisë Mirditëe dhe Degën e Thesarit Mirditëe, rezultojnë se janë përdorur në masën 100 %:

**KONTROLLI I LARTË I SHETIT****Raport auditimi mbi auditimin e ushtruar në Bashkinë Mirditë me objekt “Auditim financiar”**

VKM 2021	Obj	Sh.miraturar	kod proj	shuma sipas kont	financimi 2021	ngurtesimi	obligimi sipas kont	fakti	fonde te trasheguara	fond I pa disbursuar	fonde te lira	fonde te perd 25.01.22	trashegim et 2022	
nr	date													
238	14.04.2021	3-obj bashk	108617578	94902AE	105178153	21723515	0	104992350	21723515	0	83454638	3439425	0	0
200	25.03.21	OBJ.ARS	102720089	94902AD	99620840	20544017	4771827	83848650	15772190	4771827	79076823	3099249	4771827	0
280	12.05.21	SHMB OBJ	43687591	94902AH	40998520	43687591	0	39587739	4099852	39587739	-2689071	2689071	0	39587739
131	03.03.21	MJED.PERB	50956860	94902AB	50956860	50956860	50956860	50956860	0	50956860	0	0	0	50956860
281	12.05.21	OBJ NE BASHKPR	326012468	94902AB	315524364	326012468	46661226	279351242	36173122	289839346	-10488104	10488104	34168692	255670654
334	02.06.21	rind banesave ind	73355206	94902AC	73355206	73355206	42820729	42820729	30534477	42820729	0	0	18262273	24558456
715	03.12.21	OBJ NE BASHKPR	196653682	94902AB	196653682	39330736	0	35718653	3612083	157322946	0	0	0	3612083
50	27.01.21	Njesit ind.banimi DS1,DS2,DS3	11150000	94902AB	11150000	11150000	0	0	10335000	815000	0	0	0	815000
		SHUMA	913153474		893437625	586760393	145210642	601557570	154356809	432403584		19715849	57202792	375200792
VKM 2020														
nr	date													
		Njesit ind.banimi DS1,DS2,DS3	29820000	9999999		29820000			29815000	5000				5000

- Për mënyrën dhe saktësinë e pagesave të masës së përfitimit, u verifikuan urdhër shpenzimet e mëposhtme dhe dokumentacioni bashkëngjitur tyre i cili rezultoi të jetë i saktë.

**Konkluzion:** Për vitin 2020 dhe 2021, objekt auditimi, janë dëmshpërblyer nga fondi i rindërtimit 191 familje, për vlerën 184,171,809 lekë lekë. Nga verifikimi i Urdhër shpenzimeve, rezultoi se plotësimi i tyre është kryer në mënyrë të saktë, si dhe secili prej tyre ka bashkëngjitur listë pagesën (borderonë) me emrat e përfituesve nga fondet e rindërtimit. Shuma totale e urdhër shpenzimeve është e barabartë me faktin e llogarisë 6060099, të rakorduar me Degën e Thesarit Mirditë. Shpërndarja e tyre është kryer nga shërbimi postar.

**b. Alokimi i fondeve për pagesat e qirave (niveli i dëmit DS4 dhe DS5).**

NR.	EMERTIMI	Nr i përfituesve			Vlera financiare		
		1+1	2+1	3+1	1+1	2+1	3+1
1	VKB NR. 64	22			277,200	-	-
2	VKB NR. 11	15	8	7	189,000	123,200	142,800
3	VKB NR. 19	11	2	8	138,600	30,800	163,200
4	VKB NR. 66	21	9	19	264,600	138,600	387,600
5	VKB NR. 29	1	4	4	12,600	61,600	81,600
6	VKB NR. 87	16	13	22	201,600	200,200	448,800
	<b>SHUMA</b>				<b>1,083,600</b>	<b>554,400</b>	<b>1,224,000</b>

Për buxhetimin e fondeve me qëllim likuidimin e bonusit të qirave janë alokuar fondet me shkresat e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për shumën totale 49,498,266 lekë.

**Likuidimet sipas borderove**

Sipas Aktrakordimit të shpenzimeve me Degën e Thesarit Mirditë për vitin buxhetor 2020 dhe 2021 ka rezultuar se nga buxheti i kushtëzuar janë planifikuar fonde në shumën 49,498,266 lekë, të cilat janë përdorur në masën 100 %. Në aneks paraqitet tabela e të dhënave mbi shpenzimet faktike të llogarisë 606.



## KONTROLI I LARTË I SHETIT

### Raport auditimi mbi auditimin e ushtruar në Bashkinë Mirditë me objekt “Auditim financiar”

Emri	Instit.	Kap.	Prog.	Llogaria Ekon.	Kodi Produk.	Emërtimi i Produktit	Plan	Fakt	Për tu trashëguar
Bashkia Mirditë	2119001	01	6190	606	910107AE	Bonusi i qirave	49,498,266	49,498,266	0

**Konkluzion:** Për vitin 2020 dhe 2021, objekt auditimi, janë dëshmshpërblyer nga fondi i rindërtimit 182 familje, që kanë përfituar bonus qiraje, për vlerën 49,498,266 lekë. Nga verifikimi i Urdhër shpenzimeve, rezultoi se plotësimi i tyre është kryer në mënyrë të saktë, si dhe secili prej tyre ka bashkëngjitur listë pagesën (borderonë) me emrat e përfituesve nga fondet e rindërtimit. Shuma totale e urdhër shpenzimeve është e barabartë me faktin e llogarisë 606, të rakorduar me Degën e Thesarit Mirditë. Shpërndarja e tyre është kryer nga shërbimi postar.

**Për sa është trajtuar më lart (pika 4, referuar Programit të auditimit “Të tjera”), është mbajtur Aktkonstatimi nr. 9 datë 25.02.2022, protokolluar në subjekt me nr. 356/9, datë 25.02.2022. Mbi këtë Aktkonstatimi nuk janë paraqitur observacione.**

## B. MASA ORGANIZATIVE

**1. Gjetje nga auditimi:** Në dosjen e auditimit të brendshëm për vitet 2020 dhe 2021, mungonin: Vlerësimi i Brendshëm i Cilësisë, Sigurimi i Cilësisë gjatë vetëvlerësimit periodik dhe Rishikimi i cilësisë.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.1. faqe 31 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**1.1 Rekomandimi:** Njësia e Auditit të Brendshëm në Bashkinë Mirditë të marrë masa që të hartojë dhe realizojë në mënyrë të detajuar, të gjitha dokumentet që kanë lidhje direkt me auditimin, me qëllim që të lejojnë vazhdimësi të procesit.

**Menjëherë dhe në vazhdimësi**

**2.Gjetje nga auditimi:** Nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Mirditë, nuk është aplikuar dhe arkëtuar tarifa e pastrimit, ndriçimit dhe gjelbërimit për subjektet e ndërtimit të cilat kanë kryer punime ndërtimi dhe janë shpallur fitues në procedurat e prokurimit publik, për periudhën e auditimit 2019-2021, në kundërshtim me parashikimet e bëra në paketën fiskale të Bashkisë Mirditë për periudhën e auditimit. Kjo anomali është konstatuar për 11 subjekte, sipas listës në aneksin nr.2.2/6/2 bashkëngjitur raportit të auditimit, duke shkaktuar të ardhura të munguara në vlerën totale **1,677,000 lekë**. Subjektet nuk janë pajisur me nipte sekondare për punimet e ndërtimit në kundërshtim të ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008 *“Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”* i ndryshuar, neni 43 pika 1/1 dhe Udhëzimit nr. 24, datë 02.09.2008 i ndryshuar, neni 43/1/1.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.6 faqe 59-61 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**2.1 Rekomandim:** Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Mirditë, të marrë masa të menjëhershme për arkëtimin e vlerës **1,677,000 lekë**, nga subjektet të cilat kanë zhvilluar aktivitetet dhe kanë lidhur kontratë me Bashkinë Mirditë, për arsye të shpalljes fitues në procedurat e prokurimit publik, sipa aneksit nr.2.2/6/2 bashkëngjitur raportit të auditimit

**Menjëherë**





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport auditimi mbi auditimin e ushtruar në Bashkinë Mirditë me objekt “Auditim financiar”

**3. Gjetje nga auditimi:** Llogaria 520 ÷Disponibiliteti në thesarö nuk paraqet gjendjen e saktë në bilanc. Kjo llogari duhet të sistemohet në vlerën 25,996,510 lekë për shtesën 997,500 lekë. Llogaritë e klasës 5, nuk kanë funksionuar duke u debituar për shtesat në kredi të llogarive përkatëse për të ardhurat dhe grante të ndryshme, si dhe duke u kredituar për pakësimet në debi të llogarive përkatëse të klasës 4. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimi nr.8, datë 09.03.2018 ÷Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të PF vjetore në NJQPö pika 46/a , 49, 50.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.3 faqe 71 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**3.1 Rekomandimi:** Nëpunësi Zbatues, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të marri masa për sistemimin e llogarisë 520 ÷Disponibiliteti në thesarö për shtesën **997,500 lekë**.

**Menjëherë**

**4. Gjetje nga auditimi:** Kapitalit me 100% aksione në pjesëmarrje të Bashkisë Mirditë në ÷Ujësjellës Kanalizime Mirditë Sh.a përbën investim me vlerë kontabël (kosto) 70,867,000.00 lekë dhe investitori është Bashkia Mirditë, për të cilën nuk janë reflektuar në gjendjen e llogarisë 26 fitim humbjet nga pjesa e aksioneve për vitet 2016-2020. Kjo procedurë mos pasqyrimi në Aktivet Afatgjata Financiare të Bilancit Kontabël të vlerës së aksioneve të cilat janë investime në pjesëmarrje me vlerë kontabël 70,867,000.00 lekë përbën shtrembërim të informacionit financiar. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me UMF nr. 8 datë 9.03.2018 ÷Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshmeö, pika 2.1.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.3 faqe 77-78 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**4.1 Rekomandimi:** Nëpunësi Zbatues, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të marrë masa për të bërë sistemimet në kontabilitet dhe regjistrimin e pjesëmarrjes 100% në kapitalin aksionar të ÷Ujësjellës Kanalizime Mirditë Sha me vlerë kontabël **70,867,000.00 lekë** në debi të llogarisë 26 ÷Pjesëmarrje në kapitalin e vetö dhe kredi të llogarive financiare të klasës 5, për pjesëmarrjen me kapitalin e vet.

**Menjëherë**

**5.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatuaseLlogaria. 210 ÷Toka, Troje, Terreneö është në vlerën 9,962,953 lekë e pandryshuar dhe në 2020 njëlloj si vitet e mëparshme, për të cilën nuk ka inventar kontabël dhe as inventar fizik, Llogaria 211 ÷Pyje, Plantacioneö paraqitet e pandryshuar prej 119,419,757,580 lekë e pandryshuar dhe në 2020 njëlloj si vitet e mëparshme, për të cilën nuk ka inventar kontabël, dhe as inventar fizik. Llogaria e aktivitetit 212 ÷ Ndërtesa dhe konstruksioneö e cila pasqyron gjendjen, në fund të vitit 2019, rezulton me një kosto historike 1,327,893,632 lekë dhe në fund të vitit 2020 rezulton me një kosto historike 1,399,032,824 lekë, ku kontabilizimi i tyre në librat e kontabilitetit dhe pasqyrat financiare është kryhet pa u mbështetur në një dokumentacion vërtetues, siç është titulli i pronësisë, ku gjatë auditimit në terren u evidentua se Bashkia Mirditë nuk ka iniciuar procesin për regjistrimin e tyre. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimin nr.8/2018 ÷Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në NJQPö, pika 16,18 dhe VKM nr. 510,



## KONTROLI I LARTË I SHTETIT

### Raport auditimi mbi auditimin e ushtruar në Bashkinë Mirditë me objekt “Auditim financiar”

datë 10.06.2015 òPër inventarizimin dhe hipotekimin e të gjitha pronave të paluajtshme dhe të luajtshmeò, Kreu VI òTransferimi i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshmeò.  
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.3 faqe 78-80 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**5.1 Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Mirditë në bashkëpunim me sektorin e buxhetit dhe financës, të nxisin procedurat për sigurimin e dokumentacionit vërtetues siç është titulli i pronësisë për pronat òToka, Troje, Terrene, Pyje, Plantacione, Ndërtesa dhe Konstruksione, vlerësimin e tyre sipas inventarit dhe paraqitjen e vlerës në Pasqyrën e Pozicionit Financiar.

**Menjëherë**

**6. Gjetje nga auditimi:** Llogaria 215 òMjete transportiò në datën 31.12.2019 ka vlerën 15,748,042 lekë, ndërsa më 31.12.2020 vlera e kësaj llogarie është 8,528,894 lekë. Ndryshime prej 7,219,148 lekë vjen si rezultat i pakësimit të kësaj llogarie prej amortizimit të mjeteve, por vlera e amortizimit llogaritur nga struktura e financës nuk është e saktë. Referuar normës së amortizimit kjo vlerë duhet të jetë 1,613,817 lekë dhe si rezultat vlera e Llogarisë 215 òMjete transportiò më 31.12.2020 në pasqyrat financiare duhet të jetë 14,134,225 lekë. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me UMF nr. 8 datë 9.03.2018 òPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshmeò, pika 36, ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 òPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò neni 6, udhëzimi nr. 30 datë 27.12.2011 òPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò pikat nga 26-30, 74, 96-101, 102 dhe 103.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.3 faqe 80-81 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**6.1 Rekomandimi:**Nëpunësi zbatues, të marrë masa për sistemimin e llogarisë 215 òMjete transportiò, për vlerën **6,915,077lekë** duke korrigjuar normën e amortizimit të llogaritur gabim në pasqyrat financiare të vitit 2020.

**Menjëherë në regjistrin e aktiveve dhe në vijim në pasqyrat financiare të vitit 2022**

**7. Gjetje nga auditimi:** Sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Bashkisë Mirditë, në fund të vitit 2020 llogaria 466 òKreditorë për mjete nën ruajtjeò paraqitet në vlerën 23,568,322 lekë dhe përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masën 5%. Nga analiza e kësaj llogarie rezultoi se vlera në fund të vitit 2020, ka pasur në përbërje të llogarisë detyrime për garanci punimesh të bashkisë ndaj subjekteve privatë, garanci këto të cilave u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratat përkatëse të investimit dhe përsëri janë akoma gjendje në llogarinë 466 si shkak i ish komunave dhe mungesës së informacionit. Në këtë rast garanci të cilave u ka kaluar afati sipas kontratës së lidhur, janë në vlerën 1,169,275 lekë. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me udhëzimin nr.8 datë 09.03.2018 òPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshmeò seksioni òFunksionimi kontabël i llogarive të tjera të klasës 4., Llogaria 466 òKreditorë për mjete në ruajtjeò.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.3 faqe 84-85 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**7.1 Rekomandimi:** Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të kryejë njoftimin e subjekteve sipas kontratave përkatëse të investimeve për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për kryerjen



## KONTROLLI I LARTË I SHETIT

### Raport auditimi mbi auditimin e ushtruar në Bashkinë Mirditë me objekt “Auditim financiar”

e veprimeve të likuidimit të garancisë së punimeve në masën 5% me një vlerë totale **1,169,275 lekë** dhe të kryeve sistemimet përkatëse në llogarinë 466 ÷Kreditore për mjete nën ruajtje.

**Deri në dhjetor 2022**

**8.Gjetje nga auditimi:** Llogaria 85 ÷Rezultati i ushtrimit, paraqitet me tepriçë kreditore në vlerën 0 lekë dhe paraqet rezultatit nga funksionimi. Ajo është e barabartë me vlerën e të ardhurave që Bashkia Mirditë trashëgon për t'u përdorur në vitin pasardhës sipas dispozitave ligjore në fuqi dhe në përputhje me akt-rakordimin e mbajtur me degën e thesarit mbi fondet që trashëgohen. Ky veprim është paraqitur gabim dhe duhet të jetë në shumën 25,996,510 lekë si tek (Pasqyra e Performancës Financiare) tabela e rakordimit të ardhurave, shpenzimeve dhe rezultati. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me UMF nr. nr.8 datë 09.03.2018 ÷Për Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore, pika 36 (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.3 faqe 86 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**8.1 Rekomandimi:** Nëpunësi Zbatues, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të marrin masa për sistemimin e llogarisë 85 ÷Rezultati i ushtrimit për vlerën **25,996,510 lekë**.

**Në vijim në pasqyrat financiare të vitit 2022**

**9.Gjetje nga auditimi:** Bashkia Mirditë, ka miratuar sistemin e pikëzimit, me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 438/1, datë 04.02.2020 ÷Për miratimin e platformës online të aplikimit për programet e rindërtimit dhe manualin e përdorimit të platformës si dhe manualin e procedurave për përfitimin nga programet e rindërtimit, sipas të cilit është vendosur sistemi i mëposhtëm i pikëzimit, jo në përputhje me renditjen e përcaktuar në VKM nr. 5, datë 06.01.2020, pika 17. Referuar pikëzimit të miratuar nga Bashkia Mirditë me 438/1, datë 04.02.2020, rezulton se grupi ÷Pensionistëo i listuar i katërti në radhën e prioriteteve është vlerësuar me më pak pikë se grupi e tjetër i pesti ÷Familje me skemën e ndihmës ekonomikeo dhe kjo e fundit është vlerësuar po njësoj sa kategoria e dytë ÷Familje që ka në përbërje personat me aftësi të kufizuarao, duke mos ndjekur radhën e prioriteteve të përcaktuar në VKM nr. 5, datë 06.01.2020, pika 17. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.4, faqe 92-93 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**9.1 Rekomandimi:** Këshilli Bashkiak i Bashkisë Mirditë të kryej korrigjimet e nevojshme në Vendimin nr.438/1, datë 04.02.2020, si të pabazuara në VKM nr. 5, datë 06.01.2020, duke vlerësuar drejt shtresat më në nevojë.

**Menjëherë**

**10. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i aplikimeve për grante rikonstruksioni ose riparimi rezulton se:

- Në pothuajse të gjitha rastet e audituara, Akt konstatimet vizuale, apo Formulari Tip B dhe C, të mbajtur për të vlerësuar dëmet e shkaktuara, nuk kanë të shënuar datën e mbajtjes së tyre; nuk janë të plotësuar, në të gjitha rubrikat e parashikuara nga formati i miratuar;
- Në shumë raste, inspektimi dhe vlerësimi i objekteve në terren është bërë nga 1 person (përgjegjës në Bashkinë Mirditë), ndërkohë që në aktet nënligjore të dala për të rregulluar këtë proces, është kërkuar që verifikimet të kryhen nga grupe inspektimi.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport auditimi mbi auditimin e ushtruar në Bashkinë Mirditë me objekt “Auditim financiar”

- Për të gjitha rastet e vlerësimit të dëmit niveli DS3, i cili ka të bëjë me dëmtime thelbësore deri në të mëdha, që konsistojnë në çarje të moderuara në strukturë ose çarje të mëdha në mure ndarëse dhe mbushëse ose dëmtim i mureve ndarëse dhe perimetralë, nuk ka vlerësim të përcaktuar nga akt ekspertiza e thelluar, me përjashtim të rasteve DS4 dhe DS5

- Në pothuajse të gjitha rastet (sipas tabelës anekse nr. II.3.1-1), në dosjet përkatëse, por dhe në të dhënat e hedhura në sistem, për të vërtetuar masën e dëmit (DS3) janë paraqitur Akt konstatime vizuale nga specialistët e Bashkisë Mirditë, ndërkohë që për këtë nivel dëmi (DS3), duhej të kryhej akt ekspertizë e thelluar.

- Në asnjë prej rasteve përshkrimi i dëmeve (zërat) dhe sipërfaqet e dëmtuara, të cilësuar në Akt konstatimi vizual, apo Formularin Tip B, nuk kanë përputhje me zërat e punimeve dhe sipërfaqet përkatëse të cilësuar në preventivin tip bashkëngjitur.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.4, faqe 95-98 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**10.1 Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Mirditë të kryej një analizë të thelluar dhe të nxjerri përgjegjësitë për personat konkretë, të cilët gjatë procesit të vlerësimeve të dëmtimeve të shkaktuar nga tërmeti i 29 Nëntorit 2019, nuk kanë plotësuar saktë dokumentacionin e aplikimeve për grante rikonstruksioni ose riparimi, në mënyrë që këto anomali të eliminohen në vijim.

#### Menjëherë

**11. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi ka rezultuar se nga 135 praktikat e audituara të përfituesve nga fondi i rindërtimit për pasojave të tërmetit të 26 Nëntorit 2019, vetëm në 25 raste, ose në 18.5 % të tyre, për të vërtetuar pronësinë mbi objektin, ishin paraqitur dokumente pronësie, të cilët kanë të specifikuar sipërfaqet e objekteve; nga 135 praktika të audituara në të gjitha rastet, nga inspektorët e verifikimit të dëmeve në terren, është specifikuar në aktet e mbajtura sipërfaqe e objektit, gjë e cila ka shërbyer si kriter për vendosjen e masës së përfitimit, referuar pragjeve nën dhe mbi 100 m<sup>2</sup>. Nga 102 praktika të audituara në 18 raste, ose në 7.5 % të tyre, janë evidentuar diferenca në cilësimin e sipërfaqeve të objekteve, të cilësuar në kontratën e masës së përfitimit dhe sipërfaqeve të cilësuar në Akt konstatime, Dokumente pronësie, apo deklarimi i tyre, nga ASHK. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.4, faqe 98-100 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**11.1 Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Mirditë dhe GMS, të marrin masa për rishikim të vazhdueshëm të risqeve që vijnë nga situata të paparashikuara, si dhe të hartojnë aktivitete të kontrollit shtesë për minimizimin e tyre.

#### Në vazhdimësi

**12. Gjetje nga auditimi:** Përsa i përket dokumentacionit që vërteton pronësinë mbi objektin është kërkuar që të paraqitet, çdo lloj dokumentacioni që provon të drejtat e pronësisë mbi objektin e dëmtuar. Në lidhje me këtë kërkesë në aplikacionin "Shtëpia ime", është publikuar një listë me opsione si: (certifikatë pronësie; vërtetim hipoteke ; vërtetim fakti; vendim gjykate; kontratë sipërmarrje; kontratë shitblerje; akt dhurimi; leje legalizimi), por nga ana e Bashkisë Mirditë si dokument (zëvendësues-justifikues-vërtetues), është mjaftuar dhënia e koordinatave të pronës si dhe vërtetimi i NJA për banorin aplikant. Këto të dhëna nuk mund të shërbejë për të



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport auditimi mbi auditimin e ushtruar në Bashkinë Mirditë me objekt “Auditim financiar”

vërtetuar pronësinë mbi objektin, prandaj nuk është pjesë e listës së dokumenteve që mund të pranohen për të vërtetuar pronësinë mbi objektin. Nga 135 praktika të audituara, vetëm në 25 raste në dosje kishte dokumentacion që vërteton të drejtën e pronësisë mbi objektin, sipas listimit të tyre në aplikacion. Në të gjitha rastet e tjera, në dosje për të plotësuar këtë kërkesë është pranuar vërtetimi i Administratorit të NJA. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.4, faqe 100-101 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**12.1 Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Mirditë të bashkëpunoj me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës për të ndjekur dhe verifikuar në vijimësi problematikën mbi pronësinë, për të nxjerrë dhe analizuar arsyet e mungesave të këtij dokumentacioni i cili mund të sjellë probleme sociale dhe ligjore në vijimësi.

#### Në vazhdimësi

**13.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua mos realizim në treguesit e buxhetit, veçanërisht për sa i përket të ardhurave vendore, mos realizim i cili ka krijuar detyrime të prapambetura ndaj të tretëve, duke paraqitur një risk për buxhetin e vitit në vazhdim të njësisë vendore.

*-Detyrime për investime, mallra e shërbime në datë 31.12.2018 në vlerë 98,847,012 lekë.*

*-Detyrime për investime, mallra e shërbime në datë 31.12.2019 në vlerë 77,027,330 lekë (shlyerje në vitin 2019, vlera 25,819,682 lekë);*

*-Detyrime për investime, mallra e shërbime në datë 31.12.2020 në vlerë 66,194,233 lekë (shlyerje në vitin 2020, vlera 10,833,097 lekë);*

*-Detyrime për investime, mallra e shërbime në datë 31.12.2021 në vlerë 48,633,621 lekë (shlyerje në vitin 2021, vlera 17,560,612 lekë);*

shlyerje të cilat kanë zvogëluar fondet në dispozicion në investime dhe shpenzime të tjera për periudhën raportuese viti 2021 në interes të komunitetit bashkia Mirditë, të pasqyruara në (aneksi nr. 1, pika 2/4: 2, pika 2/4) bashkëlidhur me raportin, veprime në mospërputhje me neni (50) ÷ *Angazhimet buxhetore*, neni (52) ÷ *Kryerja e shpenzimeve*, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 ÷ *Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë* i ndryshuar, neni 56, ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “*Për financat e vetëqeverisjes vendore*”, pika (62) UMFE nr.2, datë 06.02.2012 ÷ *Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*; UMF nr.5, datë 27.12.2014 ÷ *Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura*, UMFE (plotësues) nr.4, datë 25.01.2021 ÷ *Për buxhetin e vitit 2021*, pikat (115-125) ÷ *Detyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore*;

*(Më hollësisht është trajtuar në pika nr.2.2.2 faqe 53 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**13.1.Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Mirditë të analizojë krijimin e vlerës prej **48,633,621 lekë** si detyrime të faturave pa likuiduara në datë 31.12.2021, të nxjerrë përgjegjësitë, të ndërpresë krijimin e detyrimeve të prapambetura pa fonde në dispozicion dhe të mos kryejë angazhime të reja buxhetore.

#### Menjëherë

## C. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport auditimi mbi auditimin e ushtruar në Bashkinë Mirditë me objekt “Auditim financiar”

**1. Gjetje nga auditimi:** Në 11 kontrata të lidhura ndërmjet operatorë të ndryshëm me bashkinë Mirditë, sipas aneksit nr. II/2/6/1 bashkangjitur raportit përfundimtar të auditimit, nuk janë arkëtuar detyrimet e subjekteve sipas afateve të përcaktuara. Drejtoria e Taksave të të Ardhurave Vendore dhe Agjencia e Shërbimeve Pyjore Bashkia Mirditë nuk kanë bashkërenduar për të marrë të gjitha masat (administrative dhe gjyqësore), për të arkëtuar vlerën vjetore të kontratave të qirave në vit, si dhe nuk ka ushtruar të drejtën dhe detyrimet e qiradhënësit për zgjidhjen e njëanshme kur qiramarrësi nuk ka shlyer detyrimet dhe kamatë vonesë prej 0.1% për çdo ditë vonesë, por jo më shumë se 10% e vlerës totale të vlerës së pagesës përkatëse dhe e sanksionuar në kontratë, për periudhën e auditimit 2019-2021, veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 për disa ndryshime të vendimit nr. 391, datë 21.06.2006 të Këshillit të Ministrave *“Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave të ndryshuar, gjë që ka sjellë dëm ekonomik në vlerën 14,997,426 lekë.*

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 61-64 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**1.1.Rekomandimi:** Drejtoria e Taksave të të Ardhurave Vendore dhe Agjencia e Shërbimeve Pyjore Bashkia Mirditë të bashkërendojnë dhe të marrin të gjitha masat (administrative dhe gjyqësore), për arkëtimin e vlerës **14,997,426 lekë** e 11 kontratave të qirave të operatorëve sipas aneksit nr. II/2/6/1 bashkangjitur raportit përfundimtar të auditimit, gjë që ka sjellë dëm ekonomik.

**Menjëherë**

## C.2. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TAKSAT DHE TARIFAT VENDORE, ULJEN E BORXHIT TATIMOR DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET PËR TAKSAT DHE TARIFAT VENDORE.

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga puna e pa mjaftueshme e Drejtorisë së Planifikimit të të Ardhurave Vendore në Bashkinë Mirditë, janë krijuar debitorë, të cilët në datën 31.12..2021 kanë vlerën progresive **38,852,309 lekë**, e ardhur e munguar për buxhetin e njësisë vendore, nga të cilat:

-të trashëguara nga vitet 2010-2019	14,838,512 lekë
-subjekti òSh.ò 2020	10,569,197 lekë
-subjekte biznesi 2021	8,599,825 lekë
-1463 familje debitorë për taksën e tokës bujqësore në vlerën	188,474 lekë
-1374 familje debitorë për tarifatat vendore në vlerën	1,557,400 lekë
-1463 subjekte familjare për taksën e ndërtesës në vlerën	3,098,901 lekë

**Vlera e borxhit e vitit 2021 është në vlerën 13,444,600 lekë nga të cilat**

-129 subjekte të biznesit të madh dhe të vogël në vlerën	8,599,825 lekë
-1463 familje debitorë për taksën e tokës bujqësore në vlerën	188,474 lekë
-1374 familje debitorë për tarifatat vendore në vlerën	1,557,400 lekë
-1463 subjekte familjare për taksën e ndërtesës në vlerën	3,098,901 lekë

Mos arkëtimi i plotë i detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore, përveçse është mos përmbushje e detyrimeve ligjore, sipas detyrës funksionale të punonjësve të kësaj strukture, krijon mungesa financiare në buxhet dhe për pasojë ulë nivelin e investimeve dhe të shpenzimeve të tjera që



## KONTROLI I LARTË I SHPETIT

### Raport auditimi mbi auditimin e ushtruar në Bashkinë Mirditë me objekt “Auditim financiar”

njësia vendore ka parashikuar në favor të komunitetit. Mungesa e të ardhurave është ndikim i drejtpërdrejtë në mosrealizimin e buxhetit në zërin e shpenzimeve për periudhën 2019-2021.

Nga Bashkia Mirditë nuk janë ndjekur të gjithë procedurat e nevojshme ligjore në rend shteruese, për arkëtimin e debitorëve, veprim në kundërshtim me nenin 4, 26, 32, 34, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 òPër sistemin e taksave vendore, nenet 89, 90, 91, 93 të ligjit nr. 9920 òPër Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë i ndryshuar, dhe nenin 12 të Udhëzimit të Ministrisë Financave nr. 24, datë 02.09.2008, Kreu i XI-Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore.

-Drejtorja e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, nuk janë marrë plotësisht masa me arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për objektet ndërtimore që legalizohen nga ALUIZNI-Drejtorja Rajonale Lezhë për vlerën debitorë **1,071,877 lekë** në kundërshtim të Ligjit nr. 9482 datë 03.04.2016, òPër legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje ò i ndryshuar, neni 23, dhe Vendimin e Këshillit të Bashkisë VKB-në paketës fiskale me vendim nr. 135 datë 30.11.2018, vendimi nr. 40 datë 26.11.2019 dhe vendimi nr. 110 datë 20.11.2020 òPër Miratimin e Paketës Fiskale Vendore.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 64-67 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**1.1 Rekomandimi:** Drejtorja e Planifikimit të të Ardhurave Vendore të marrë masa për arkëtimin e detyrimeve në mënyrë progresive në vlerën **38,852,309 lekë**. Për këtë, bazuar në nenin 70 pika 3 òE drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 òPër Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, për të gjitha subjektet e private të nxjerrë njoftim vlerësimit tatimor dhe në vazhdim të marren masat për arkëtimin e këtij detyrimi, duke ndjekur rrugët e mëposhtme:

**a- Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit (ASHK) dhe Zyrën Vendore të e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZRVPP),** kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në (për pasuritë e paluajtshme), bazuar në nenin 91, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 òPër Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë.

**b- Për subjektet të cilët nuk kanë paguar detyrimet tatimore në afat, ndaj tyre të aplikohet Neni 93** të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 òPër Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë. **Sekuestrimi dhe konfiskimi i pasurisë 1.** Nëse tatimpaguesi nuk paguan detyrimin tatimor në datën e caktuar, në përputhje me nenin 89 të këtij ligji, për njoftimin dhe kërkesën për pagesë, administrata tatimore mund ta mbledhë detyrimin tatimor të papaguar nëpërmjet sekuestrimit, e më pas konfiskimit, të pasurisë së siguruar në favor të administratës tatimore, në pronësi të tatimpaguesit.

**c- Në rast se bizneset private edhe pas njoftimeve zyrtare** dhe dërgimit të urdhër bllokimeve në bankë nuk kryejnë pagesën e detyrimeve, pasi të merren masat administrative apo sekuestro, të **bëhet kallëzim penal**, bazuar në Kodin Penal i Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 me ndryshimet e mëvonshme, neni 181 òMospagimi i taksave dhe tatimeve.

**d- Për debitorët familjar,** në zbatim të udhëzimit plotësues të Ministrisë së Financave nr. 01, datë 17.01.2019 òPër zbatimin e buxhetit të vitit 2019, pika 98, të njoftojë nëpërmjet postës familjarët të cilët nuk kanë paguar detyrimet për taksën e tokës, të ndërtesave dhe tarifave familjare dhe të realizojë arkëtimin e detyrimit të miratuar nga Këshilli Bashkiak.



## KONTROLLI I LARTË I SHETIT

### Raport auditimi mbi auditimin e ushtruar në Bashkinë Mirditë me objekt “Auditim financiar”

-Drejtorja e Planifikimit, Zhvillimit dhe Kontrollit të Territorit në bashkëpunim me Drejtorinë e të Ardhurave Vendore dhe Policinë Bashkiake të marrë plotësisht masa me arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për objektet ndërtimore që legalizohen nga ALUIZNI-Drejtorja Rajonale Lezhë për vlerën debitorë **1,071,877 lekë** në mbështetje të Ligjit nr. 9482 datë 03.04.2016, òPër legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa lejeò i ndryshuar, neni 23, dhe Vendimin e Këshillit të Bashkisë me vendim nr. 135 datë 30.11.2018, vendimi nr. 40 datë 26.11.2019 dhe vendimi nr. 110 datë 20.11.2020 òPër *Miratimin e Paketës Fiskale Vendoreò*.

**Deri më datën 31.12.2022**

**2.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i kryer për arkëtimin e vlerës së taksës për lëshimin e Autorizimeve / Licencave për subjektet e tregtimit me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë, u konstatua se 13 subjekte që ushtrojnë këtë aktivitet në Bashkinë Mirditë, janë debitor për taksën e licencës në vlerën totale 10,000,000 lekë, e cila konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e njësisë vendore. Lista e subjekteve debitor dhe vlera përkatëse për secilin paraqitet në aneksin nr.2.2/6/2, bashkangjitur raportit të auditimit.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kërkesat e paketës fiskale të miratuar nga këshilli bashkiak, me VKM nr. 970, datë 2.12.2015 òPër përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të sajò i ndryshuar me VKM nr. 344, datë 19.04.2017, kapitulli II, pika 1; germa òbò dhe pika 9 të Bashkisë Mirditë, për periudhën 2019-2021. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 56-58 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**2.1 Rekomandim:** Drejtorja e Taksave dhe Tarifave Vendore e Bashkisë Mirditë, të marrë masa për arkëtimin e vlerës debitorë prej **10,000,000 lekë** krijuar nga 13 subjektet (sipas listës në aneksin nr.2.2/6/2, bashkangjitur raportit të auditimit) për mospagimin e taksës për licencën e tregtimit të naftës bruto dhe nënprodukteve të saj.

**Deri në dhjetor 2022**

## D. MASA DISIPLINORE

**I.** Në mbështetje të shkronjës (c) neni 15 -Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 òPër Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetitò, në zbatim të nenit 58, òllojet e masave disiplinoreò të ligjit nr. 152/2013 datë 30.05.2013 òPër nëpunësin civilò, i ndryshuar me ligjin nr. 178/2014, datë 18.12.2014, VKM nr. 115, datë 05.03.2014 òPër përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civilò dhe, nenin 64 shkronjën g, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 òPër vetëqeverisjen vendoreò, i rekomandojmë Kryetarit së Bashkisë Mirditë, që ti kërkojë Komisionit Disiplinor, të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore për punonjësit e konstatuar me përgjegjësi sipas çështjeve të trajtuara në raportin përfundimtar të auditimit.

**II.** Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 òPër organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetitò, shkronjat òeò dhe òçò, të nenit 1, kreun IV dhe nenet





## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### Raport auditimi mbi auditimin e ushtruar në Bashkinë Mirditë me objekt “Auditim financiar”

37 dhe 144 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 òKodi i Punës në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, Masat disiplinore, të kontratës individuale të punës, i rekomandojë Kryetarit të Bashkisë Mirditë, që të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore për punonjësit e konstatuar me përgjegjësi sipas çështjeve të trajtuara në raportin përfundimtar të auditimit.

#### **G. NJOFTIMI I DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË MBIKËQYRJES TË SHËRBIMIT CIVIL**

Për punonjësit të cilët janë rekomanduar masat disiplinore sa më sipër, Bashkia Mirditë pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, **të ndërmarrë veprimet si më poshtë:**

**a.** Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 òPër Nëpunësin Civil, i ndryshuar.

**b.** Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të ligjit nr. 152/2013 òPër Nëpunësin Civil, i ndryshuar.

## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT